

HEJZA

Ardita Jatru, poete

POEZIA DUHET TË TRONDIT

*Poezia është një tabelë qitje për dhimbjet e për vetminë.
Jo gjithmonë ia qëlloj në shenjë, e rëndësishme është që kam gjetur
një vend ku godas*

Nën thjerrë

DËSHMI PËR KULTURIM

Vetëm krijimi i financave vetanake të siguruar nga konsumatorët e vlerave kulturore është dëshmi se sa një popull e do kulturën e vet dhe, sa është i kulturuar

Nga Avni HALIMI

Një prej punëve më kombëtare që ka ndodhur për këto dy e ca dekada në Maqedoninë e Veriut është presioni politik dhe ndërjegjësimi i "shumicës" për një "diversitet administrativ" për nga kuptimi etnik. Falë kësaj këmbënguljeje shqiptare, sot administrata shtetërore përbëhet edhe nga një numër respektiv i shqiptarëve. Nëse Maqedonia e Veriut agoi në demokraci me një përqindje nën zero të përfshirjes së shqiptarëve në administratën shtetërore dhe në atë publike, sot kjo përqindje arrin diku prej 15-20 për qind, varësisht nga "fortifikimi politiko-etnik" i dikastereve qeveritare. Ka dikastere ku përfshirja e shqiptarëve në administratën përkatëse akoma llogaritet "tradhti kombëtare"!

Kategoria e vendimit

Megjithatë, situata në administratën publike edhe më tej lë për të dëshiruar. Janë shumë institucione nacionale, drejtori, agjenci, në të cilat punësimet e shqiptarëve llogariten si kapitullim nacional! Mbi të gjitha ky hermetizim politik maqedonas vërehet sidomos nëpër institucionet nacionale kulturore, ku përfaqësimi adekuat i shqiptarëve perceptohet si diçka e kotë dhe e panevojshme! Fatkeqësisht, këtij perceptimi antishqiptar po i nënshtrohen edhe funksionarët shqiptarë. Nuk është patriotizëm dhe, madje, kurrfarë zgjidhje kombëtare punësimi me kontratë në vepër i 400-500 shqiptarëve të ngratë në Higjienën Komunale! Nuk është kurrfarë rezultati i "platformës kombëtare" punësimi me kontratë në vepër i 200-300 punëtorëve në Ujësjellës - Kanalizim apo në Parqe dhe Gjelbërime! Nuk është

kurrfarë e arritur kombëtare nëse në Ministrinë e Kulturës merren poste të larta dhe aty ulen turlifareë dudukësh, të cilët nuk kanë lidhje me kulturën. Cila është iniciativa, puna dhe rezultati konkret, për shembull, i zëvendësministrit apo i sekretarit shtetëror (që të dy deri dje ishin shqiptarë) në këtë Ministri? Kapja e 25 përqindëshit nga buxheti i kësaj Ministrie nuk ishte meritë e as e njërit dhe as e tjetrit, porse ishte rrjedhojë tashmë e një tradite të arritur nga një marrëveshje politike e ngritur në LIGJ!

Këto vendime tashmë të betonizuara nuk mund të përvetësohen e të personalizohen nga asnjë funksionar! A është ndërmarrë, për shembull, ndonjë iniciativë për reagim dhe mospajtim përmes konferencave publike për të shprehur pakënaqësinë kombëtare lidhur me vendimet, qëndrimet dhe politikat retrograde të atyre prej të cilëve varen! Po, kemi pasur konstatime të tipit, "na e bëri me hile", "na premtoi, por nuk e mbajti fjalën", "u morëm vesh, por në fund na e luajti komisioni" etj.! Ku është këtu pesha e vendimeve dhe qëndrimeve të funksionarëve shqiptarë? A e njohin këta kategorizimin e vendimeve apo thjesht vendosin për zhvendosje! A kanë raport dhe pasqyrë të përfaqësimit adekuat të shqiptarëve nëpër institucionet nacionale kulturore? Pse edhe pas 30 viteve çlirim nga praktika e "administratës etnike" Biblioteka Kombëtare dhe Universitare "Shën Klimenti i Ohrid" edhe më tej është me përfaqësim nën-minimal! Aty së fundmi ishte edhe një drejtor shqiptar! Ai, sa drejtoi këtë institucion u sabotua të paktën nja tri herë në iniciativat e tij për punësimin e ndonjë shqiptari! Për këtë problem kurrë nuk patëm reagim as nga

drejtori, por as nga funksionarët shqiptarë në Ministrinë e Kulturës! Pati disa përgjigje negative (kryesisht për mosrespektim të afatit!) nga ana e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës! Së fundmi nga Biblioteka është shtruar një kërkesë formale deri në Ministri të kulturës për punësim të dy shqiptarëve, kërkesa është përcjellë në Ministrinë e Shoqërisë Informatike, e cila më tej e ka përcjellë deri në Ministri të Financave, prej nga përgjigja ka ardhur pozitivisht! Vendet e punës janë plotësuar nga dy maqedonas, të cilët, njëri është prezantuar si shqiptarë e tjetri si rom! Pse, a nuk e dinë këtë vendim antishqiptar funksionarët shqiptarë të Ministrisë për Kulturë! Fare në fund, në kërkesën për punësimin e nja 4-5 shqiptarëve, sa për ta rritur minimalisht përqindjen e shqiptarëve në këtë institucion nacional, Ministri i Financave është përgjigjur negativisht, me arsytim se nuk ka buxhet! Po si po krijohen buxhetet kur kjo ministri gjendet para presioneve të sindikatave, para protestave e grevave! Po nëse dalin në protestë frekuentuesit e këtij Institucioni që në shumicë absolute janë shqiptarë, pa dyshim që kjo ministri do të gjunjëzohet! Në zemrën e Shkupit shqiptar, me tri universitete në gjuhën shqipe, me shpërndarjen e administratorëve që mbi dhjetë vite "mrizun" nëpër shtëpitë e tyre, në këtë Bibliotekë përqindja e shqiptarëve të punësuar (nga rreth 150 të punësuarve) nuk shkon më shumë se 3-4 për qind! Së këndejmi, kush prej shqiptarëve, kush nga funksionarët shqiptarë të Ministrisë së Kulturës dhe ata që drejtuan me këtë Bibliotekë, di gjë të na thotë mbi fondin e librit shqip, mbi gjendjen dhe përkujdesjen ndaj këtij fondi? Asnjëri! Sepse për "funksionarët"

tanë mjafton kolltuku, fjala e fundit e celularëve, makina dhe sekretaresha! Për këtë lloj funksionarësh - vërtetë, çka është kultura?!

Politikat kulturore të shtetit dhe të institucioneve nacionale

Me politikat kulturore nënkuptojmë orientimin nacional, përcaktimin strategjik, angazhimin e shtetit si dhe financimin qeveritar për zhvillimin e jetës kulturore si dhe përkujdesin ndaj trashëgimisë së gjithmbarshme kulturore. Thënë shkurt, politikat kulturore janë rregullat e domosdoshme nacionale, të cilat, si një gravurë e bukur, pasqyrojnë identitetin kulturor të çdo populli! E tërë kjo, vështruar për nga aspekti nacional, ndërsa për nga aspekti ndërnacional, politikat kulturore sot shprehin angazhimin e çdo shteti, të çdo qyteti, të çdo qytetari botëror në ruajtjen e diversitetit kulturor si dhe në orientimin e botës së civilizuar drejt industrisë kulturore! Sot, vetëm në Britaninë e Madhe funksionojnë mbi 20 fakultete të industrisë kulturore. Kjo industri ka të punësuar mbi 300 mijë punëtorë, respektivisht dyfishin e atyre që punojnë nëpër miniera! Kjo flet se kultura, kreativiteti kulturor në industrinë nacionale po zë pozita të larta dhe po merr një rol të jashtëzakonshëm në krijimin e kushteve për një mirëqenie sa më të lumtur. Veglat, përmes të cilëve sendërtohen politikat kulturore, pa dyshim që janë institucionet nacionale të sferës së krijimtarisë kulturore. Natyrisht, duke qenë se këta institucione janë pjesë e industrisë kulturore, së këndejmi edhe institucionet nacionale duhet ta kenë politikën autonome kulturore, por që duhet të jetë në funksionim të përkryer me politikat kulturore.



Politikat kulturore nuk duhet që të ofrojnë vetëm orientime, por ato duhet edhe të kërkojnë obligime dhe përbushje të detyrimeve të cilët pastaj duhet të sigurojnë qëndrueshmëri dhe lëvizje të lehtë në shinat e industrisë kulturore. Politikat kulturore të institucioneve nacionale duhet të garantojnë kreativitet si dhe suksese të padiskutueshme në rrafshin përkatës kulturor. Pa dyshim që duhet të organizohen 2-3 ekspozita jashtëzakonisht të suksesshme se s'bën! Duhet të jepen 2-3 shfaqje spektakulare se s'bën! Duhet të bëhen 1-2 filma që do të kalojnë nëpër të gjitha festivalet botërore të filmit; duhet të botohen 50-100 tituj originalë, nja 20-30 tituj të përkthyer nga autorët më të lexuar të vitit; duhet të organizohen 3-4 festivale folklorike, nja 4-5 shfaqje të operës, 2-3 shfaqje nga baleti, nja dy koncerte të muzikës serioze, dy-tre ekspedita arkeologjike, manifestime poetike etj. Të gjitha këto të shënojnë suksesin e vitit për çdo institucion nacional përkatës! Pa dyshim, tërë ky aktivitet ngelë në obligimet e këtyre institucioneve që në njëfarë forme u diktohen nga politikat kulturore. Ndër detyrat kryesore të këtyre institucioneve ngelë që të sigurojnë sa më shumë publik, shitje sa më të madhe të biletave, por edhe të prodhimeve nga produksionet përkatëse dhe,

me këtë ta lehtësojnë detyrimin financiar nga buxheti shtetëror. Thjesht, të krijojnë një "pavarësi" financiare nga buxheti qendror! Burokratizimi i institucioneve nacionale, parazitizmi i tyre si pasojë e ushqyerjes së gatshme nga buxheti shtetëror, mosdhënia përgjegjësi para askujt për mungesë të publikut-konsumatorit, zhdukja e të gjitha kontakteve institucion nacional-publik - kjo po që duhet të ketë një përgjegjës! Teatrot dhe hapësirat e tyre të mbyllura apo jo mirë të shfrytëzuara, prezantimet e këqija të galerive dhe muzeve, repertorët demode, manifestimet poetike të mbyllur që, fatkeqësisht e degradojnë edhe boemizmin më të shëmtuar, vdekjen e botimeve poetike, të dramaturgjisë kombëtare etj., dëshmojnë për "politikën" që ngrënë strategji mes miqsh dhe nuk kanë asgjë të përbashkët me filozofinë bashkëkohore të politikave kulturore. Sot, vetëm krijimi i financave vetanake të siguruar nga konsumatorët e vlerave kulturore është dëshmi se sa një popull e do kulturën e vet dhe sa është i kulturuar.

Qëndrimi i politikave tona ndaj kulturës

Subjektet tona politike, sidomos ato që janë bartëse apo pjesë e qeverive, peshën e vet politike e

demonstrojnë përmes numrit të dikasterëve qeveritare që do t'i menaxhojnë derisa do të jenë në pushtet! Po aq të rëndësishëm do të ndjehen edhe për nga sasia e buxhetit që do ta kenë dikasteret. Natyrisht, ndër më të "pasurat" janë: financat, mbrojtja, diplomacia dhe siguri i brendshëm. Pastaj vinë edhe shëndetësia, arsimit, socialja e kështu me radhë. Nga ana tjetër, ndonëse kultura është segmenti më i rëndësishëm qeveritar, qëndrimi i politikave tona është pothuajse mospërfillës! Ministri për kulturë është në mënyrë të përhershëm në një situatë për t'u përgjigjur për çdo politikë jo të shëndetshme për identitetin kulturor, ndërsa në kabinetin qeveritar i nënshtrohet rolit që nuk ka kurrfarë ndikimi dhe as peshe politike! Nisur nga ky fakt që flet për qëndrimet mospërfillëse të politikave tona në raport me kulturën, pushtetet shqiptare apo partipientët shqiptarë nëpër pushtete të ndryshme, edhe më tej vazhdojnë ta trajtojnë kulturën si një pemë, frytet e së cilës më lehtë mbledhen duke ia thyer degët! Nëse identitetin kulturor nuk e kanë si prioritet të gjitha ministratë e një qeverie, kjo do të thotë se strategjia nacionale për të zhvilluar komb e për të ndërtuar shtet të qëndrueshëm është një ide pa ideal! Situata edhe më e trishtë na paraqitet qasja ndaj kulturës e subjekteve

tona që pranojnë të participojnë nëpër pushtete pa këmbëngulur që strategjitë nacionale për kulturë të jenë me rrotacion: angazhimin shtetëror për identitet kulturor ta ndjejnë çdo bashkësi etnike, duke i eliminuar të gjitha monopolet kulturore të njërës shumicë apo të tjetrës! Fatkeqësisht, subjektet tona partipientë në qeveritë e ndryshme, kulturën e kanë llogaritur si një grazil ku mund të hanë taxhi militantët partiakë apo si një mundësi për pasurim të buxhetit partiak! Kjo logjikë ka ndikuar që nëpër ministri të kulturës të kemi "partizanë" lojalistë të dyfishtë: ndaj pushtetit që imponon politika për kulturë shtetërore dhe, ndaj partisë që nuk i njeht dhe nuk i ka të qarta politikat që i bëjnë mirë identitetin kulturor. Vetëm kur partitë tona do ta kuptojnë rolin jetik të kulturës në ngjeshjen e identitetit kombëtar, vetëm atëherë do të kemi parti kreative, dinamike dhe të besueshme; do të kemi parti me një duzinë togjesh kulturore që duhet të menaxhojnë me këto vlera, të cilat, fatkeqësisht, sot partitë tona nuk i kanë! Ndaj dhe, për rrjedhojë, për "prijës kulture" na vënë turlifare tutkuni që nuk ia vlen të përdoren as për hunj gardhesh.

Antitezë

SHKRIMTARI

Shkrimtari duhet ta dijë po ashtu se Ballkani dhe shoqëritë shqiptare brenda tij duhet domosdo të qeverisen nga njerëzit e padobishëm, nga debilët, dhe nga njerëzit e llojit të kënetave

Shazim MEHMETI

Tashmë, shkrimtarin nuk duhet vrojtuar nga mrekullitë dhe mençuritë që i shkruan. Shkrimtarin duhet vrojtuar nga budallallëqet që i shkruan. Shkrimtari, tashmë, duhet të jetë i lig dhe jo i njerëzishëm. Shkrimtari nuk guxon të ndjejë. Ai duhet të shkruajë nga pandjesia, nga plasticiteti butak. Çastet e ligështimit ndjesor duhet të jenë të huaja për shkrimtarin. Aktualiteti e kërkon që shkrimtari të jetë i ushqyer e i motivuar ligësisht dhe egërsisht. Shkrimtari nuk duhet të shkruajë për njeriun e vogël, për njeriun e përvuajtur, për skamnorin e lënë e të harruar nga sistemi. Shkrimtari nuk duhet të shkruajë për jetimët e harruar nga shoqëria sistemore ose nga shteti, madje as për jetimët e të fljuarve për komb e për atdhe. Shkrimtari duhet t'i lëvdojë e t'ju bëjë qejf pandalur oligarkëve politike dhe elitave financiare. Shkrimtari duhet të jetë një pulaxhi i mirë. Kokëulur duhet të rrijë gjithëherë dhe me xhepat mbushur, dhe gjithnjë të ketë qëndrim gatitu para padronëve të politikës e padronëve të parave. Shkrimtari duhet ta dijë mirë se gjatë gjithë jetës së jetëve, luftërat janë bërë, jo për lirinë e fukarenjve, por për paratë dhe për gratë. Ai duhet ta dijë mirë se edhe sot e kësaj dite, luftërat bëhen vetëm për para dhe për gra. Një shkrimtar i mirë një luftë të tillë duhet ta proklamojë si luftë për liri nacionale dhe si luftë për moralin politik. Njësoj si baballarët e rremë të kombit që robërinë e modifikuar e proklamojnë si liri dhe si barabarësi.



Shkrimtari duhet ta dijë se letërsia është morali anadollak e anarkist, dhe kulti i kallaballëkut dhe i baltës duhet të jetë edhe kult i tij. Shkrimtari duhet ta dijë po ashtu se Ballkani dhe shoqëritë shqiptare brenda tij duhet domosdo të qeverisen nga njerëzit e padobishëm, nga debilët, dhe nga njerëzit e llojit të kënetave. Ai e ka të domosdoshme të shkruajë lavde për ta, domethënë për kënetat, dhe t'i shajë, në veprën e tij, ajrin e pastër malor dhe lumenjtë e kulluar. Aktualiteti e kërkon një gjë të tillë, dhe shkrimtari e ka hak lavdërimin e kënetës dhe të baltës, dhe sharjen e bilbilave të malit. Shkrimtari e ka hak lavdërimin e malarjes kënetore, dhe jo shëndetin e mirë ndjesor. Madje, madje, shkrimtari

duhet t'i këndojë baltës dhe të pretendojë të bëhet edhe vetë baltë. Misioni i shkrimtarit nuk është goditja e padrejtësisë, nuk është shenjëzimi i së keqes, as nuk është bërja me gisht kah hedhurinat. Misioni i shkrimtarit është heshtja freatike, e ngjashme me heshtjen e ujërave nëntokësorë. Ose edhe më mirë: misioni i shkrimtarit është të shkruajë himne për hedhurinat dhe për llumin politik. Në shpirtin e shkrimtarit duhet te funksionojë mekanizmi i dënimit të së mirës, dhe mekanizmi i lavdërimit të së keqes. Shkrimtari duhet të jetë purrolesh(a)tuk ose purrollopënjat. Ai domosdo duhet të jetë qind për qind dash, në jo edhe mëzat. Ai duhet domosdo të ketë ngjashmëri mentale me tokësorët

e llojit toksik e qeverisës kënetar. Mendoj po ashtu se zanati i shkrimtarisë duhet të jetë prodhim i veglës, dhe shkrimtari duhet të jetë vegël sistemore. Aktualisht, ai duhet të jetë i ngjashëm me shkrimtarët vegla të komunizmit. Ai duhet domosdo të sillet e të përngjasojë me shumë shkrimtarë që janë zhvilluar në komunizëm duke thurur himne për partitë dhe për baballarët e tyre ideologjikë e mentalë. Shkrimtari, aktualisht, duhet të vazhdojë me krijimin e letërsisë baritore dhe socrealiste, natyrisht duke pasur kujdes maksimal për parabishtin e saj "post". Shkrimtaria është punë serioze dhe shkrimtarët që s'janë të tillë duhen dënuar. Prandaj, plumbbbb!!!!....

Me Ardita Jatrun, poete

POEZIA DUHET TË TRONDIT

Poezia është një tabelë qitje për dhimbjet e për vetminë. Jo gjithmonë ia qëlloj në shenjë, e rëndësishme është që kam gjetur një vend ku godas.

Shkëlzen HALIMI

Ardita Jatra, poete, tashmë është një emër i njohur në letërsinë bashkëkohore shqipe. Ardita prej vitesh (më shumë se 34 vjet) jeton në Selanik, Greqi, por asnjëherë nuk u shkëput nga ambienti ynë letrar. Është autore e vëllimeve poetike "Jetës i falem", "Alter Ego", "60 kg. vetmi" (u botua edhe në gjuhën angleze në SHBA), "As terr, as dritë" etj. Së fundi një vëllim poetik iu botua edhe në greqisht. Poezitë e saja janë botuar në shumë antologji poetike, por edhe në revista ndërkombëtare.

HEJZA: As terr, as dritë! Cila është ajo vija e padukshme shpirtërore midis këtyre dy gjendjeve, që s'të lë qetë e të detyron t'i japësh dritë fjalës për ta bërë atë vijë si një tel të dikurshëm për tharje rrobash, në të cilën t'i i var fjalët plot dhembje, dashuri, shpresë, nga të cilat krijohet poezia?

A. JATRU: Ndoshta nuk kam asgjë interesante e të mençur për të thënë. Nga këndi im gjërat e bukura heshtin. Mërzia bërtet. Është çudi që një tru i freskët mëngjesor të shkruaj për mërzinë. Kjo duhej të ndodhte në fund të ditës. Do kish një farë kuptimi, por nënvetëdija punon kur ne flemë.

Ish një kohë dhe kjo jo shumë larg, që mendimi im pësoi një ndryshim radikal. Njëfarë zgjuesi brenda meje. Një udhëtim i brendshëm që duhej të ndodhte herët a vonë, e kërkoja medoemos, ishte çështje kohe dhe përjetova një gjendje të ngarkuara emocionale, midis pyetjeve dhe dyshimeve. Ndodh pra. Papritur ndesh një realitet që as e kishe parë e as e kishe nuhatur. Thjesht flije në zhurmën e përditshme e të lavdishme të rutinës dhe ngjarjeve që imponohen. Jam natyrë kurioze, hulumtuese, tendencioze, t'u shkoj gjërave deri në fund. Është fatkeqësi të ndjesh nevojën ta kthesh realitetin përmbys. Ekziston një naivitet milingone në gjithë këtë proces mundimi.

As terr e as dritë, është niveli i kapërcimit mendor dhe shpirtëror, i pasigurisë mes asaj që iku dhe do të vijë, mes meje dhe botës, një kundra vajtje domethënë dhe nuk mendoj që u jap dritë fjalëve, sepse drita nuk është trishtuese siç natyrshëm përshfaqem në poezi, thjesht rrekem të kuptojnë shtratin e poezisë, për mos t'u çmendur. Ndoshta vetvetiu nyjet ndjesore zgjidhen në një farë mënyre në këtë përhumbje, e unë nuk di nëse kjo nevojë është shpresë, dhimbje apo dashuri.

HEJZA: Botuesi Naim Zoto, në librin Tuaj, AS TERR, AS DRITË, veç tjerash, thotë se Ardita Jatra është poete, nuk bën poeten: ajo nuk thërret në ndihmë as atdheun, as shqiponjën, as qiellin dhe as lulet që ta bëjnë poete. Kjo do të thotë se Ju keni rrugën Tuaj, nëpër të cilën ecni, gjithnjë e shoqëruar me vetminë dhe fjalën e bukur. Në fakt, sa



është e vështirë ecja nëpër këtë rrugë?

A. JATRU: Në fakt, vështirësia gjendet tek të kuptuarit dhe jo tek ecja, se fundja ecja është një proces i natyrshëm. Botuesi së gjithash është vet një poet, ndaj s'ka qenë i vështirë fare për të perceptimi. Ndoshta përgjigja ime do jetë më e shkurtër se pyetja juaj, sepse rrekja për filozofizma të shpie gjatë e mua s'më pëlqen ky lloj protagonizmi ose ndjej njëfarë dembelizmi në këtë moment për t'u përshfaqur, por po citoj Pessoa-n si një përgjigje që mbulon tërësisht gjendjen time: për mua poezia është justifikimi për të qëndruar vetëm!

Bukuria jo domosdoshmërisht qëndron tek fjala, por te sinjeriteti. E bukura është e komplikuar për t'u shpjeguar, sepse duhen ca kriteret estetike që në fakt te njerëzit shëmbëllet sipas nivelit të intelektit. Fjala është e bukur nëse të josh dhe ngacmon ndjenjën e akumulimit, në të kundërt s'ka efekt. Ka qenë dhe do jetë e vështirë ecja në këtë rrugë përderisa guxoj e përballim. Ndonjëherë dua ta frenoj veten, por kam një farë vartësie ndaj gjykimimit. Ky është tregues i një karakteri dramatik. Ndoshta poezia i tërheq tipat si unë.

HEJZA: Kur mësuat se letërsia është ajo që të shtrëngon në shpirt. Si ishin fillimet e Juaja të para në botën magjike të fjalës artistike?

A. JATRU: Është një pyetje shabllon dhe po e anashkaloj me shpjegime detajesh që përveç se të lodhshme nuk ka asgjë të re për lexuesin. Di të them që letërsinë e kam në ADN dhe jam në kultivim e sipër. Kjo farë do shumë intuitë dhe kohë të lirë. Bëj sa mundem.

dhe është e bukur nëse shkruhet tronditshëm. Poezia duhet të të trondit, përndryshe nuk i qasësh dot gjendjes. Dhe tronditja është një ndjenjë spontane e singertë që nuk arrin të shtiret. Dhemb për gjithçka që lëndon njeriu dhe sa të ekzistojë kjo anë e monedhës, mendimet e mija do jenë plagët që do më lenë pa gjumë nga dhimbja.

HEJZA: Ambienti ynë letrar, fatkeqësisht që moti është kontaminuar me lloj - lloj mbeturina që dukshëm ia kanë zënë frymën letërsisë së mirëfilltë. Sot kemi më shumë botues se lexues, kemi mafi letrare, kemi epigonizëm, diletantizëm dhe çka jo tjetër? Pse ndodhi kjo dhe si ta dekontaminojmë këtë ambient letrar?

A. JATRU: Gjithë pyetja juaj është një kokluzion i këtij realiteti dhe unë nuk kam recetë dhe s'kam pse të mendoj për të ndaluar rrjedhën e lumit kur shtrati është krijuar. Çdo gjë ka një afat skadence. Është elementi kohë, me gjithë ndërhyrjet njerëzore. Lexoj, kuptoj pothuajse çdo ditë nga rrjetet sociale dhe kjo më ka distancuar ose më ka lodhur. Mungesa e identitetit agraron situata alarmante dhe ne si shoqëri e kemi shumë të theksuar. Një fëmijë jetim, ka nevojë të identifikohet me figurën e prindërve, ka nevojë një shembull, një pasqyrë ku të shihet. Ne jemi një shoqëri njerëzore dhe të identifikohesh me elementë të mangët nga ana shpirtërore dhe mendore, pasojat janë rrënuese dhe afatgjata. Është trishtuese ta lejosh intrigën dhe hipokrizinë në madhësinë e vetë. Është e papërballueshme forca diabolike e këtyre ambienteve. Ti qëndron larg sepse nuk komprometohesh dot dhe ata të thonë "je i padëshirueshëm". Thënë troç, nuk ma ndjen për asnjë institucion letrar dhe as më qahet për pak përkëdheli prej tyre. Jam e lirë.

HEJZA: A e ka thënë akoma fjalën e vet kritika letrare për krijimtarinë që po zhvillohet në diasporë. Apo, janë dy vlera që po ecin paralelisht dhe assesi të takohen diku sy më sy!

A. JATRU: Kush pyet për krijimtarinë e diasporës! Nuk mund t'i krijosh hapësirë një të harruari, është i vdekur. Dhe i vdekuri me të gjallin nuk mund të takohen sy më sy, sepse ky i fundit duhet të mbijetojë në habitatin e tij dhe të mbijetosh do të thotë "hiqmu sysh". Të tjerat janë refleksione të padëmshme dhe amatoreske. Lapidarë prej kashte që mund t'i shembnin me një prekje gishti.

HEJZA: A mjafton fakti se sot, meqë kemi shumë shkrimtarë që "po shkruajnë", mund të konstatojmë se po bëjmë letërsi?

A. JATRU: Le t'i lemë njerëzit në punë të vetë. Secili ka nevojë të shkruajë librin e tij. Nuk është fare shqetësuese për mua

që ka shumë shkrimtarë. Dikujt do t'i ndrisë ylli në orën e duhur, qoftë kjo dhe pas vdekjes. Ajo që më shqetëson është propaganda e antivlerave që na shitet me të gjitha mënyrat si mall i jashtëzakonshëm dhe ta ofendojnë inteligjencën. A ka më turp? Nga ata që e mbajnë ende emrin e tyre me thonj e me shpirt? Por, dhe hipokrizia e ka një cak. Ne nuk e duam tjetrin. Na mungon ndjenja e solidaritetit dhe na kaplon e pushtetshmja dhe kjo është fatale në çdo fushë. Letërsia në mëmëdheun tim është monopol i qarqeve që s'kanë nevojë për vlerat, por për të shtuar avokatët mbrojtës. Tek ne nuk është e rëndësishme të bësh letërsi, e rëndësishme është t'i përkasësh vijës ideologjike që të krijon favore. Nuk po them gjë që nuk dihet. Është praktikë që ndiqet në çdo fushë.

HEJZA: Një poet i mirë, a mendoni se është rezultat i perceptimit të veçantë të botës, njohjes së poezisë (letërsisë), njohjes së vetes apo duhet të gërshetohen të gjitha këto?

A. JATRU: Janë shumë elementë që është i nevojshëm gërshetimi. Dy botimet e mia të para i kam hedhur në koshin e ndërjegjes, sepse janë rezultat i një entuziazmi naiv, pa pikën e mendimit dhe të pjekurisë, thjesht vargëzime. Nuk duhet të nxitohesha, por rashë pre e karakterit tim atëherë naiv dhe spontan, mungesës së besimit dhe këshillave mediokre. Me kohën gjërat ndryshuan. Duhet të rritesha. I hyra me vullnet leximit dhe meditimit si një nevojë pjekurie për zbërthim dhe akumulim. Dhe kjo nevojë fillimisht lindi për të kuptuar natyrën njerëzore, gjë që më mban të angazhuar ende. Vetën vonë fillova ta mendoj, si gjithë gjërat që i lë për më vonë, si shmangie përgjegjësie. Një poet i mirë është produkt pjekurie dhe intelektit.

HEJZA: Ju prej vitesh jetoni në Selanik. Kohë më parë, poezia Juaj, pa dritën edhe në një vëllim të ri në gjuhën greke.



Si është pritur ky vëllim poetik dhe na e përshkruani me pak fjalë ambientin aktual poetik grek, aq më tepër kur dihet se janë shumë emra krijuesish grek që kanë lënë gjurmë të thella në letërsinë e përmasave botërore?

A. JATRU: Jetoj këtu e 34 vjet e ca në Selanik. Pas kaq vitesh, mora guximin për të botuar në gjuhën greke. Ishte një vendim që mund të qe një katastrofë ose për mirë dhe në mënyrë të vullnetshme iu shtrova punës së mundimshme të përkthimit të poezive të mia nga shqip në greqisht. Shumë prej tyre pësuan ndryshime thelbësore, një tjetër trup, një tjetër kokë, por gjendjet mbetën po ato. Në çdo gjuhë të përkthesh një shpirt, dhimbja ndihet njëjtë. Kjo ishte e rëndësishme si pjesë, të përshtatja shpirtin poetik vendas që nuk është fare e lehtë sikur dhe njëqind

vjet të tjera të jetosh diku.

Ishte një ogur i mirë dhe gjërat më erdhën mbarë, thjesht më duhej të prisja për aprovim. E gjithë procedura që nga botimi, promovimi, kritika e mbresa rreth librit kanë qenë një përmbushje e cila u krye me ndershmëri dhe njerëzisht nga ana e shtëpisë botuese, sepse besuan tek poezia ime. U pëlqye. M'u hapën ca dyer pa qenë e nevojshme të merrja përsipër rolin e nëpunësit të marrëdhënies publike, sepse nuk e zotëroj këtë aftësi. Gjërat po rrjedhin natyrshëm dhe mbarë dhe të mendosh që libri ka parë dritën e botimit në shkurt të këtij viti. E vërteta është që nuk e prisja, jam në mallëngjim e sipër. Institucioni i kritikës është i besueshëm në rrethet letrare, funksionon mendimi kritik, i të thënit troç, o bën o s'bën or mik. Nuk është e rastësishme lartësimi

i poezisë greke botërisht. Kalon nivele sipërore e kjo nuk lë vend për kompromise e qokagjij. Ka kanone që nuk duhen shkelur në emër të artit.

HEJZA: Poezia ofron një shpresë për ta kapur dritën në zonat e errëta dhe për të kuptuar se edhe në dhimbje mund të gjenden momente të bukura dhe të pasura emocionale. Si e keni përjetuar Ju këtë dritë në ato zona të errëta?

A. JATRU: Nuk mund të flasë ende për dritë për sa kohë njeriu rropatet rreth materialit. Unë përpiqem të gjej pak kohë për veten. Është e ujditur jeta në mënyrë të tillë që njeriu të mos ketë mundësi të meditojë. Të merresh me veten është luks i kohës, në fakt kështu ka qenë gjithmonë. Pikërisht sepse hyrja në zonat e errëta është rrezik për të kuptuar. Kur kupton, dhemb. Kur dhemb, indinjohesh. Indinjata është revolucion. Revolucionin e tim e nisa në poezi. Njëfarë kryengritje ndaj drojës time, ndaj asaj që më mbante të lidhur. Poezia është një tabelë qitje për dhimbjet e për vetminë. Jo gjithmonë ia qëlloj në shenjë, e rëndësishme është që kam gjetur një vend ku godas.

Ndonjëherë vetë-plagosem për të stimuluar dhimbje, duhet të jem e vërtetë në atë që rrëfej, por përvoja më ka bërë doktor të vetes ndaj dhe poezitë e bukura janë shumë të pakta. Nuk dhemb më si më parë, më është rafinuar dhimbja.

HEJZA: Çfarë punohet në punëtorinë krijuese të Arditës, përkatësisht cili është projekti Juaj i radhës?

A. JATRU: Asgjë. Jam gojë dhe mendje mbyllur këtë periudhë. Nuk projektoj, i lë gjërat të vijnë natyrshëm. Frymëzimi është perëndi e paparashikueshme. Një farë Persefoni, që po u vonua së shfaquri nga bota e nëndheshme, tokës do t'i mungojë lulëzimi dhe pjelloria.

Bashkimi kulturor, mision i (pa)mundshëm

VLERAT E MIRËFILLTA, PARARROJË E TË GJITHA ANOMALIVE

Shoqërisë sonë i duhet një kulturë tjetër zhvillimi permanent për të dalë nga kufizimet politike të kohës. Mundësia më e mirë për të dominuar vlerat e mirëfillta, është koordinimi i ekonomisë së përbashkët nëpër të gjitha trojet shqiptare

Ramiz SALIHU

Para së gjithash duhet ta sqarojmë se çka është termi apo kuptimi i sintagmës "kulturë nacionale", mbase ajo, si e tillë, në vete përfshinë një bashkësi komplekse njerëzore të veçantë, që dallohet me gjuhë, traditë, doke, zakone të trashëguara kulturore. Të gjitha këto lidhje të ngushta dhe karakteristikat dalluese të një etnie njerëzore formojnë një tërësi kulturore dhe kuptimore të një populli. Madje, gjatë kohës së zhvillimit dhe emancipimit të shoqërisë marrin edhe vepime të llojllojshme komunikative, sidomos nëpër rrethana e vështirësi të ndryshimeve sociale jetësore, ku brenda një shoqërie të ndarë, siç është kjo e jona, mund të shfaqen vështirësi dhe subkultura të ndryshme aktive, që veprojnë si pjesë modifikuese dhe imponuese në shoqëri. Këto grupe alternative veprojnë kundrejt kulturës së përgjithshme dhe nuk pranojnë integritet shoqëror global. Pra nuk është e rastësishme paraqitja e grupeve të caktuara në Kosovë, që trumbetojnë "kombin kosovar" apo edhe format e

të folmes gjuhësore të gegërishtes si alternativë kundërshtuese të standardit dhe normës ekzistuese. Ngandonjëherë përfaqësuesit e këtyre grupeve bëhen edhe agresiv, me tendencat dhe kërkesat e tyre radikale, regresive të subkulturës gjuhësore. Por, kultura institucionale i ka mekanizmat e veta mbrojtëse nga këto tendenca grupore denigruese të shoqërisë shqiptare. Kultura shqiptare ka forcën e vet bindëse në afirmimin e vlerave të mirëfillta kombëtare. Padyshim se institucionet përkatëse, tanimë e kanë për detyrë, të luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen e vlerave të mirëfillta kulturore.

Këto veçanti karakteristike të një populli betonohen në një shtet apo rajon etnik të përbashkët, ku dallohen si kombe me karakteristikat e veta prej të tjerëve. Kultura nacionale në kuptimin e plotë fjalës është një vlerë tërësore e trashëguar dhe reflektive e shoqërisë, e cila ka qëllimin e formës së bashkësisë që zhvillohet apo evoluon gradualisht gjatë qenësisë së saj nëpër shekuj. Ajo ka edhe kontinuitetin e vet të vlerave kulturore që trashëgohet

nga gjenerata në gjeneratë. Ajo nuk mund të mbetet statike, por zhvillohet gradualisht për të formuar e formësuar identitetin e plotë kolektiv dhe të dallueshëm me të gjitha karakteristikat e veta poseduese e reflektuese. Populli shqiptar i ka disa veçanti dhe vlera kulturore që popujt tjerë nuk i kanë. Një kohë të gjatë ka dominuar koncepti kulturor i "Besës", që është përcjellë si kod i fjalës së dhënë dhe bindjes së shenjtë, e cila bashkë me nderin dhe burrërinë e manifestuar, si qasje antropologjike kulturore, nuk ka guxuar të tjetërsohet apo anashkalohej nga vetëdija e njerëzve. Sipas këtij "kodit penal" të "Besës shqiptare" ndërtohet kulti i sintagmës së trashëguar dhe fjalës së dhënë për diçka të rëndësishme shoqërore e njerëzore. Kjo shprehje dhe vendim ka luajtur "ligjin" e posaçëm dhe bindës, vetëm të popullit shqiptar dhe si vlerë të tillë karakteristike, ka shërbyer për ta njohur tërë bota. Mbase kjo shprehje bazike i ka rrënjët e thella që nga lashtësia e periudha mitologjike apo edhe nga lidhja e hershme biblike që potencon shprehjen hyjnore dhe

vendimtare të fjalës: "Në fillim ishte fjala", dhe kjo, padyshim, mbeti si nismë e parë për të komunikuar e vepruar njerëzimi midis vetes. Sipas kësaj të vërtete mund të themi se kjo çështje sublime e ekzistencës së kulturës mund të lidhet edhe me ngjarjet mitologjike të popullit shqiptar, siç është legjenda e Rozafatit, që ndërlidhet fuqishëm me motivin e murimit, si dhe me motivin e ringjalljes së njeriut ashtu siç na e dëshmon edhe legjenda apo kënga tjetër karakteristike "Besa e Kostandinit", e cila padyshim ka të bëjë me personifikim e gjërave të vdekura dhe për fjalën e dhënë, apo të ligjit të koduar njerëzor të besnikërisë, që nuk mund ta harrojë këtë bindje morale, as vdekja dhe as gjërat ekzistuese përreth.

Tani pos dokeve, zakoneve dhe veshjeve kombëtare, gërshetohet edhe arti i trashëguar nga gjenerata në gjeneratë. Folklori autokton ka qenë gjeneza dhe baza e zhvillimit të artit në përgjithësi, ku aty hyjnë vlerat e veçanta, si karakteristikë dalluese të një etnie, veshjet, muzika dhe letërsia popullore, por tanimë edhe ajo e



shkruar, për të na përfaqësua si popull i veçantë në botë.

Me kalimin e kohës dhe sidomos me globalizimin e shoqërisë, shumë prej këtyre veçantive karakteristike, që i ka përdorur gjatë historisë popull ynë, janë duke evoluar dhe harruar si pasojë e ndikimeve të kulturave tjera të huaja. Kështu ndodh me të gjithë popujt e botës që integrohen në këtë sistem global jetësor. Tani këto marrëdhënie dhe ndikime kulturore ndodhin edhe me popullin tonë që gjendet e frymon në këtë kontinent evropian të përbashkët. Në skenë vijnë adete tjera manifestive të përgjithësuara dhe të ndikuara nga të tjerët. Harrohen ose nuk përdoren më pjata apo enë të mbushura me drithëra e bonbone që hidhen nga dhëndri mbi kalin apo veturën e nuses, kryesisht me besim dhe besëtytni në vete për ta begatuar shtëpinë dhe familjen. Edhe pse në kohën e sotme, moderne dhe postmoderne, dikush mund të bëhet nostalgjik për këto tradita e vlera dokesh e zakonesh ekzistuese të së kaluarës, por ja që ndikimet dhe standardi jetësor luan rolin e vet imponues të shoqërive dhe modave të ndryshme të zhvillimit jetësor. Shumë gjëra kanë ndryshuar dhe kanë marrë forma tjera të manifestimit shoqëror e kombëtar. Tani për shkak të zhvillimit teknologjik dhe industrial të popujve, vetëm gjuha ka mbetur dhe do të mbet si formë bazike e komunikimit tonë kulturor të përgjithshëm dhe si dëshmi bindëse e qenësisë sonë, për të na dalluar, si popull i veçantë prej të tjerëve. Edhe kur nuk ka ekzistuar shkrimi shqip, njerëzit kanë komunikuar me këtë gjuhë të trashëguar nga të parët tanë. Po që se fshihen kombet ndonjëherë, gjuhët e veçanta do të ekzistojnë më gjatë, derisa në skenë vepruese shoqërore nuk del diçka më e përsosur shkencërisht, që këto veçanti dalluese gjuhësore, mund t'i mbulojë ndonjë gjuhë dhe teknologji tjetër, e re, ku njerëzit e globalizuar të komunikojnë apo të merren vesh njëri me tjetrin.

Në sundimin e perandorive në gadishullin ballkanik, etnia shqiptare nuk ka pasur kufij politik të vetin, dyndjet dhe lëvizjet kanë qenë të mundshme sipas zbatimit të ligjeve të atëhershme. Njerëzit apo etnia jonë ka vepruar dhe zhvilluar veten në forma të ndryshme të mbijetesës deri në ditët e sotme. Formimi i kombeve dhe

shteteve merr kuptimin e vet vetëm atëherë pas Revolucionit Francez në fillim të shekullit 19, ku definohet kuptimi i popullit, duke pasur për bazë qëndrimin, një popull një shtet. Në këtë kohë u formuan kufijtë dhe shtetet nacionale. Këtë iniciativë e morën poetët, filozofët, zhurnalistët dhe shumë personalitete të njohura të kohës, me një vetëdije dhe emancipim zhvillimor shoqëror, ku do të bëhej kufizimi dhe distanca, bashkë me kulturën e gjuhës dhe historisë së vet, ndaj etnive tjera përreth.

Tani në kohën dhe politikën e sotme, bashkimi kombëtar, më duket se është bërë ushqim i përditshëm i njerëzve të preokupuar me këtë problematikë. Kjo çështje sot trajtohet edhe nëpër media e struktura të ndryshme politike nëpër trojet etnike shqiptare, prandaj edhe kultura si veçanti ekzistuese, tanimë, ka mundësinë më të mirë e më të lehtë për integrim spontan, posaçërisht duke stimuluar vetëdijen e njerëzve nëpër institucione dhe nëpër vende ku jetojnë e veprojnë të organizuar. Padyshim se këtë frymë integruese në demokraci, nuk mund ta pengojë askush, por nuk mund ta ndalin as edhe ata njerëz që janë gabimisht të vendosur nëpër pozicione ku mbrohet identiteti kulturor kombëtarë. Vetëm diktaturat e së kaluarës nuk kanë lejuar një bashkim apo integrim normal të njerëzve dhe artit në përgjithësi. Këto barriera sot janë lëçitur nga vetëdija e njerëzve dhe misionarëve profesionistë, sidomos ata profesionistë që kanë përgjigjësi kombëtare. Edhe pse brenda këtyre fërkimeve integruese apo bashkuese të kulturës, paraqiten klane dhe individë që bëjnë "sektarizmin kulturor", prapëseprapë fuqia tjetër e vlerave të mirëfillta duhet të dominojë në zhvillimin dhe kristalizimin e pastër të identitetit tonë kulturor institucional. Vlerat e mirëfillta të arteve bëhen pararojë e të gjitha anomalive kulturore vepruese në shoqëri, të cilat sot i kemi me shumicë. Kjo betejë arrihet gradualisht duke bërë dekriminalizimin e ndalesave kulturore shqiptare, para së gjithash, kjo është e mundshme të bëhet duke shqyrtuar politikën vepruese nëpër trojet shqiptare, të cilat edhe sot e kësaj dite shëmbëllojnë në forma të ndryshme organizative. Ndalesat politike të së kaluarës për të mos u integruar shqiptarët duhet të tejkalohehen dhe kjo arrihet

me përkushtim dhe investim serioz kulturor. Gjithsesi se barrierat politike dhe ideologjike, që kanë ekzistuar më parë, duhet të thyhen e të anashkalohehen njëherë e përgjithmonë, për t'u arritur ky homogjenitet i mundshëm kulturor kombëtar. Pa kualitete semantike të njerëzve të ditur dhe specialistëve të arteve përkatëse nëpër institucione dhe pa pluralizëm politik nuk do të besoja në këtë komunikim ndërlidhës të kulturës shqiptare.

Festivalet ekzistuese të letërsisë, muzikës, të filmit dhe teatrit nëpër të gjitha trojet shqiptare, kanë mundësuar që kultura shqiptare të jetë më e pranishme në perceptimin e vlerave të përgjithshme të qytetari. Tanimë talentet lëvizin të lirshëm, duke performuar kreativitetin e vet në çdo hapësirë ku frymon genia shqiptare. Sa për ilustrim, mund të përmendim Festivalin e muzikës bashkëkohore në Shqipëri e Kosovë, DokuFest i filmit dokumentar ndërkombëtar që mbahet në Prizren, Dom festival, i muzikantëve të rinj, Prishtina Jazz Festival, Festivali Sunni Hill, i Dua Lipës, Festivali i Teatrit Dibër, pastaj Festivalet letrare në Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut e gjetiu, janë mundësi të mëdha integrimi kombëtarë. Kurse tjetër punë është kriteri dhe niveli artistik që duhet ta bëjnë profesionistët e këtyre arteve kreative kulturore. Në këto mundësi të shumta ka edhe lëshime që duhet të tejkalohehen me kalimin e kohës.

Kongresi Manastirit është koordinimi më sublim i Rilindjes Kombëtare, që gërshetoi qëndrimin e studiuesve dhe atdhedashësve më të përkushtuar të kombit tonë, kryesisht, për të pasur një gjuhë dhe alfabet të përbashkët kombëtar. Ishte nevojë e kohës që Gadishulli Ilirik duhej të inkarnojë në vete një kulturë dhe politikë strategjike të njëjtë kombëtare, e cila pas shumë përpjekjeve dhe mosmarrëveshjeve, më në fund kjo nevojë e kohës u realizua me përkushtim serioz nga të gjithë pjesëmarrësit e konferencës në qytetin e Manastirit. Të pranishmit mes datave 14 dhe 22 nëntor, 1908, unanimisht vendosën që të bëhet standardizimi bazë i alfabetit të njësuar të gjuhës shqipe, për të gjithë shqiptarët kudo që jetojnë. Kongresi i Manastirit bëhet gurë-themeli fundamental për unifikimin e shkronjave shqipe, që do të përdorej si kod i njësuar dhe i përbashkët i letërsisë mbarë shqiptare.

Kjo datë dhe vendimet e marra në kongres nga pjesëmarrësit e të gjitha trojeve etnike shqiptare, bashkë me pjesëmarrësit e të gjitha përkatësive fetare, vendosën në mënyrë unanime se alfabeti shqip duhet të jetë me 36 shkronja dhe me shkrim latin. Aty u dhanë mendime që të shkrihen të dy dialekte toskë dhe gegë për një gjuhë të njësuar e të përbashkët standarde. Ka qenë një domosdoshmëri e kohës për t'u arritur qëllimet e këtij koordinimi rreth bashkimit kulturor kombëtar. Në vendimet e marra u dhanë përparësi të dy dialekteve ekzistuese, toskë dhe gegë, e folme që përdoret në veri dhe jug të territorit shqiptar. Tanimë në nisje të vitit të ri shkollor kemi edhe Abetaren e përbashkët e të unifikuar për të gjitha trevat shqiptare. Tani për tani është koordinuar puna e ekspertëve që Abetarja e re të jetë unike për Shqipëri dhe Kosovë. Kjo është një nismë e mbarë për kulture dhe integrim kombëtar.

Vet genia jonë është e lidhur në kompaktësi gjeostrategjike në territorin ballkanik, ndaj kjo kompaktësi kërkon një standard gjuhësor komunikimi, me veten dhe me të tjerët, që duan ta njohin dhe pranojnë këtë gjuhë si më të vjetër në Evropë. Edhe pse shqiptarët jetojnë etnikisht nëpër shumë shtete, (të ndarë e të kufizuar me kufij), ka ardhur koha që këto kufij "artificial" të anashkalohehen me projekte e strategji kulturore dhe ekonomike. Është mision i çdo shqiptari që t'i thyjë këto barriera penguese dhe dizintegruese. Të mos flasim tani për njerëzit e arsimit, të cilët e kanë për detyrë implemetimin dhe unifikimin e identitetit tonë kombëtar. Në kërkimin tonë nuk bëhet fjalë për kuantitet, por për kualitet të përgjithshëm shoqëror e kombëtar. Çdo kërkim i ka vështirësitë e veta në qoftë se i ka në mungesë informacionet e duhura. Shoqërisë sonë i duhet një kulturë tjetër zhvillimi permanent për të dalë nga kufizimet politike të kohës. Mundësia më e mirë për të dominuar vlerat e mirëfillta, është koordinimi i ekonomisë së përbashkët nëpër të gjitha trojet shqiptare. Duke investuar me mençuri strategjike dhe fonde të përbashkëta ekonomike të gjitha vështirësitë sociale mund të tejkalohehen. Njëherë e kam thënë se kur paga e punëtorit nëpër trojet etnike shqiptare do të bëhej njëqind euro më shumë se në Itali e Greqi, atëherë pa hamendje do të kemi shqiptari.

Për frymëzimin...

NË ART DËRIMI ËSHITË DHUNTI

Poezia është një tabelë qitje për dhimbjet e për vetminë. Jo gjithmonë ia qëlloj në shenjë, e rëndësishme është që kam gjetur një vend ku godas.

Bujar SALIHU

Pyetjes suaj do përpiqem t' i përgjigjem sa më shkurt, por kam bindjen se është paksa e vështirë të përmblihen me dy-tri fjali, aq më shumë që edhe pyetja si e tillë është shumë provokuese dhe frymëzuese njëkohësisht. Nëse më lejohet fillimisht doja të thoja diçka për frymëzimin, edhe si bukurri, si magji e si virtyt. Kam bindjen se frymëzimi është padyshim gjëja më e bukur që mund ta pushtoj një krijues, ani se frymëzimi është çast, vjen e shkon, shkon e vjen pa një mundësi të artë ta mbash «peng» e të nënshtruar, sepse, ai, si i tillë, ka trajektorën e vet të fluturimit. Po jetojmë në një kohë të vështirë për letërsinë përgjithësisht dhe shpesh rrethanat në të cilat jetojmë dinë të na e pushkatojnë pamëshirë frymëzimin tonë, në këtë «dyluftim» kam bindjen se ne shpesh shkruajmë edhe për inat



të këtij realiteti. Janë disa faktor, që e bëjnë të vështirë procesin krijues sot dhe plotë sfida të tjera që bëjnë të na ik frymëzimi, si thonë, pa shenjë, pa i përjashtuar këtu edhe disa dukuri të tjera, që nuk do i zëmë në gojë, sepse nuk e di ku mund të përfundojmë... Nejse, t' i kthehemi frymëzimit, frymë(zënjes), këtij procesi (do më pëlqente të thoja të përkryer) sa sublim, sa e sa magjik e kur e kur edhe tmerrues. Unë me librin tim të radhës po provoj të bëjë më të mirën, dhe në këtë plan jam i prirë që të mos bëjë as më të voglin kompromis. Nuk jam nga ata që suksesin e mat me libra të botuar, përkundrazi mendoj se librat e shumtë mund të bëhen barrë e rënd për një krijues. Figurativisht frymëzimin e shohë si një pemë, frytet e së cilës nuk piqen në çdo stinë. Liria për të shkruar i pafrymëzuar apo vetëm sa për të shkruar, vret. Në art durimi ashtu si edhe fluturimin janë gjithashtu

dhunti gati të barabarta. Atë që kam bërë me librin e fundit po provoj ta bëjë edhe me librin e radhës; të mos botoj nxitimthi. Ka kohë që kam shkruar një grusht poezish dhe atyre po ju kthehem si sistematikisht, duke punuar me përkushtimin më të madh. Procesin krijues jo vetëm se është i vështirë, por ai është edhe i dhimbshëm. Nobelistja polake, Szymborska, thoshte se pjesa më e madhe e krijimtarisë sime përfundon në koshin e letrave. Është mirë të mësojmë nga kjo, sepse jo të gjitha copëzat, idetë e frymëzimet meritojnë të botohen. Me këtë ritëm më duhen edhe disa vjet për të shkruar librin e radhës, por që besoj fuqishëm se artistikisht duhet të kaloj librin pararendës, dhe se në krejt librat që kam botuar, por edhe në ata që do mund t' i botoj në të ardhmen do jem shumë i lumtur nëse prej tyre nja 5-6 poezi do mund t' i rezistonin kohës dhe të mund të jetonin së paku edhe disa vjet më shumë se unë.

Në fokus

ALAIN BADIOU, METAFIZIKA E LUMTURISË REALE

Lumturia është e vështirë për t' u kuptuar dhe arsyet për këtë janë komplekse...

Metin IZETI

Badiou [bad-ju'], Alain, filozof dhe shkrimtar francez (Rabat, Marok, 17 janar 1937). Ai studioi në École normale supérieure (1956-61), nga viti 1969 ai jep mësim në Universitetin e Parisit VIII dhe që nga viti 1999 në École normale supérieure. Pas studimeve, ai u përfshi aktivisht në ngjarjet politike, veçanërisht rreth dekolonizimit të Algjerisë dhe mori pjesë në themelimin e Partisë së Bashkuar Socialiste (Parti socialiste unifié, shkurtim PSU). Gjatë lëvizjeve studentore në Paris në vitin 1968, ai u bashkua me lëvizjen radikale të majtë, pjesërisht militante, Unioni i Komunistëve Marksist-Leninistë të Francës (Union des communistes de France marksiste-léniniste - akronimi UCFml). Në kuptimin filozofik, Badiou u formua nën ndikimin e marksizmit shkencor të Althusser-it dhe qasjes psikoanalitike të Lacan-it. Në konsideratat e tij filozofike ai nisat nga konceptet e lëndës, së vërtetës dhe lirisë, të cilat i zbaton në fushën e politikës, matematikës, poezisë dhe psikanalizës. "Fundi i metafizikës", tek ai, reflekton në mënyrë logjiko-matematike. Në teorinë e grupeve, ai pa një mënyrë të mundshme për të kapërcyer kuptimin monist të së

vërtetës. Në frymën e konceptit të Hajdegerit për betejën si ngjarje, ai pohon se qenia ndodh (zhvillohet) përmes katër formave (poezi, matematikë, psikanalizë, politikë) dhe në të sheh vende dhe kushte në të cilat e vërteta shfaqet (ekziston). Qenia është shumësi e pastër (shumë, e cila mund të formulohet në mënyrë adekuate vetëm nga matematika), e cila shprehet e strukturuar sipas ligjit të paraqitjes. Për Badiou, koncepti i universalizimit është i rëndësishëm, i kuptueshëm në dritën e marrëdhënies midis strukturës universale të betejës dhe veçantisë së ngjarjes, që e përfaqëson atë në një situatë të caktuar. Duke u marrë me temën, ai shqyrtoi mënyrën se si njeriu kafshë mund të bëhet plotësisht subjekt: ai mund ta bëjë këtë vetëm duke transformuar rrënjësisht situatën në të cilën jeton, duke krijuar një të vërtetë të re.

Po, lumturia ekziston

Motoja e veprës së tij, "Métaphysique du bonheur réel" ose "Metafizika e lumturisë së vërtetë" është: "Dashuria duhet rishpikur, kjo dihet", që janë vargjet e poetit të kultit Arthur Rimbaud nga koleksioni "Stina në ferr". Dashuria, pra, duhet të rishpiket, sepse ajo është e rrethuar. Badiou

shton se ... dashuria duhet të rinovohet. Ne duhet të rishpikim rrezikun dhe aventurën kundër sigurisë dhe rehatisë. Tek "Metafizika e lumturisë reale", autori beson se filozofia është bërë një disiplinë mjaft e dobët, e pafuqishme dhe se edhe ajo duhet rigjallëruar, por edhe se koncepti i sotëm i lumturisë është i korruptuar dhe se duhet tejkaluar një sërë pengesash në rrugën drejt saj. Badiou thekson se është padyshim paradoksale t' i jepet një titull i tillë një libri që ka të bëjë kryesisht me përcaktimin e detyrave të filozofisë, por edhe një filozofi që trajton elemente në dukje mjaft të ndryshme që rrallë lidhen me lumturinë, si p.sh. teoria e grupeve ose revolucionin kinez. Gjithashtu, autori përdor shumë poezi që konsiderohen hermetike - vargjet e Mallarme, Pessoa dhe Celan. Kur i shtohen idhujt e Badiou si Dekarti, Paskali, Hegeli apo Kierkegardi të cilët ai i citon, kjo vepër e fundit e botuar e Badiou vështirë se mund të konsiderohet si një lexim i lumtur, siç pohon vetë autori. Nuk është e lehtë të shihet lidhja midis gjithë jetës së kënaqur të përmendur, punës interesante, pagës së përshtatshme, shëndetit të çelikut, makinës së rehatshme, kafshës shtëpiake besnike dhe të dashur, pasardhësve

të lezetshëm, me pak fjalë - ajo që tradicionalisht konsiderohet lumturi në të gjitha hapësirat. Shkurtimisht, me Platonin dhe në "Shtetin" e tij, lumturia është një shenjë e sigurt e aksesit të plotë në të vërtetën dhe përfaqëson qëllimin e vërtetë të një jete të denjë për këtë emër, dhe për këtë mund të thuhet se kjo rrugë dhe reflektimi i plotë i saj përbëjnë metafizikën e lumturisë. Për Spinozën, në "Etikën" e tij, lumturia (Spinoza përdor fjalën latine "beatitudo", që është edhe më e fortë) nuk është gjë tjetër veçse ushtrimi i mendimeve të vërteta, apo virtytit. Badiou arrin në përfundimin se çdo filozofi - veçanërisht nëse bazohet në njohuri komplekse shkencore, vepra inovative të artit, politika revolucionare, dashuri intensive - është një metafizikë e lumturisë, përndryshe nuk ia vlen një të durohet dhimbja. Si rrjedhojë, pse e gjithë kjo, nëse nuk ka jetë reale, ajo që thotë Rimbaud se mungon? Badiou është i bindur për ekzistencën e saj, për ekzistencën e lumturisë.

Lumturia e vërtetë kryengritje kundër botës

Badiou përgjithësisht përcakton se çfarë duhet të fshehë sot interesi për filozofinë, ose atë që Badiou e quan



"dëshira për filozofi" dhe si lidhen këto arsye me mundësinë e lumturisë së vërtetë. Ai flet për antifilozofinë, dhe Paskalin, Rusoin, Kierkegardin, Niçen, Wittgensteinin, Lakanin, sepse antifilozofët e përmendur janë të domosdoshëm që klasicizmi ynë të mos kthehet në akademikizëm, i cili është armiku kryesor i filozofisë, dhe për rrjedhojë e lumturisë tek e cila fshihet akademikizmi - mërzia.

Ai, gjithashtu, trajton çështjen e njeriut modern, dhe problemin e transformimit njerëzor, prandaj kërkon zgjidhjen e mëposhtme - si ta ndryshojmë botën? Ai, herë pas here, është subjektiv, dhe merret me lidhjen ndërmjet së vërtetës dhe lumturisë dhe në librin tjetër, "Imanenca e të vërtetave" ("L'immanence des vérités"), zëret në një dialektikë të re të fundësisë dhe pafundësisë. Në përkufizimin e parë të lumturisë, ai thotë: Lumturia është një përvojë pohuese e thyerjes së fundshmerisë. Qëllimi i këtyre thënieve të shkurtra është të hapin rrugën për të treguar rrugën më të shkurtër drejt jetës reale, e cila, kur jetohet, pasqyrohet në një ndjenjë lumturie të pakrahueshme. "Filozofia dhe dëshira e filozofisë" ("Philosophie et désir de philosophie"), për te, fillon me pohimin se filozofia është diçka e ngjashme me "revoltën logjike", që është fraza e Rimbaud. Është një kombinim i dëshirës për revolucion - lumturia e vërtetë kërkon një kryengritje kundër botës siç është diktatorës së opinioneve të ngulitura - dhe nevojës për racionalitet.

Dëshira filozofike është, në përgjithësi, një dëshirë për një revolucion të mendimit, por edhe një dëshirë për lumturi të vërtetë që ndryshon nga imagjinata e saj, që është kënaqësia. Filozofia e vërtetë nuk është një ushtrim abstrakt. Që nga Platoni, filozofia ka luftuar kundër padrejtësive në botë. Badiou kujton Mallarmé dhe hedhjen e tij të zarit (Hedhja e zarit nuk do ta eliminojë kurrë shansin) dhe i duket se një koncept i tillë i rastësisë përshkruan mirë edhe filozofinë, ku rastësia luan një rol të rëndësishëm, të pashlyeshëm në prodhimin e mendimit. Nga poezia ai nxjerr idenë se ekzistojnë katër dimensione themelore të dëshirës që përcaktojnë filozofinë: dimensionet e revoltës, logjikës, universalitetit dhe rrezikut.

A nuk është kjo formula e përgjithshme

e dëshirës për revolucion? Një revolucionar do që njerëzit të revoltohen për ta bërë atë në mënyrë efikase dhe racionale, dhe jo në barbarizëm dhe zemërim; dhe se kjo kryengritje ka një vlerë ndërkombëtare, universale dhe se nuk është e mbyllur në identitet kombëtar, racor apo fetar. Në fund, revolucionari pranon rrezikun: këto janë përbërësit e dëshirës për revolucion, këto janë përbërësit e dëshirës së filozofisë.

Gjuha shpëtimtare

Por, Badiou beson se bota jonë, bota perëndimore, ushtron presion mbi këto katër dimensione të dëshirës. Kjo botë standardizon dhe komercializon rolet tona në lirinë e caktuar, kështu që liria që ofron është liria e robëruar, sepse synohet për qarkullimin e mallrave në rrjetin tonë jetësor. Nuk nënkupton idenë e revoltës. Kur flasim për mundësinë e revoltës - kjo botë është e prirë ndaj shtypjes së saj. Ja pse edhe propozimi i revoltës, kur flasim për të në kontekstin e lumturisë, dyshohet për korrupsion latent në këtë botë. Badiou vijon me pohimin se edhe dimensionet e logjikës sabotohet, sepse i nënshtrohet dimensionit të palogjikshëm të komunikimit, jokohorent, i cili na siguron menjëherë atë që ai e quan spektakël pa kujtesë. Gjithashtu, kjo botë nuk është e përshtatshme për universalen, sepse forma e vërtetë materiale e universalitetit të saj është abstraksioni monetar. Në para qëndron e vetmja shenjë efektive e asaj që qarkullon dhe këmbëhet universalisht. Mjafton të thuhet se një "lumturi" e tillë u rezervohet grupeve të paracaktuara dhe individëve konkurrues që janë gati ta mbrojnë atë si një privilegj i trashëguar nga masat që nuk marrin pjesë fare në të. As rreziku nuk është i pajtueshëm me këtë botë, sepse pak njerëz kanë mjetet për t'ia lënë ekzistencën rastësisë. Është një botë në të cilën ekziston nevoja për të llogaritur sigurinë. Badiou vazhdon se edhe arsimimi ynë bazohet në nevojat e tregut të punës dhe se ndonëse synon sigurinë dhe punësimin e përhershëm, sërish rezulton i pasigurt. Është një siguri e dyshimtë, dhe përveç kësaj, askush nuk e di se sa e pallogaritshme është lumturia e vërtetë?

Badiou dëshiron të thotë se dëshira filozofike për një revolucion të jetës,

nëse e bazojmë në revoltën, logjikën, universalitetin dhe rrezikun, në botën reale has katër pengesa kryesore: sundimin e të mirave, rregullin e komunikimit, universalitetin monetar dhe specializim produktiv dhe teknik, të gjitha këto janë të lidhura me llogaritjen e sigurisë personale. Këto pengesa e reduktojnë idenë e jetës reale dhe lumturisë në një fantazi të quajtur kënaqësi konsumatore.

Ai pyet: si e shpëton filozofia një sfidë të tillë? A është e mundur kjo? A është ajo e aftë për të? Për të përshkruar përgjigjen, Badiou prezanton shkurtimisht tre rrymat kryesore të filozofisë bashkëkohore: fenomenologjinë dhe hermeneutikën (që rrjedhin nga romantizmi gjerman), filozofinë analitike dhe filozofia postmoderne dhe gjen tipare të përbashkëta mes tyre. Karakteristika e përbashkët negative është se asnjëri prej tyre nuk beson më në zbulimin e së vërtetës së madhe (kuptim, koncept universal). Karakteristika e përbashkët pozitive është befasuese për autorin: të tria rrymat i kushtojnë rëndësi qendrore gjuhës. Gjithashtu, si rezultat, filozofia bashkëkohore përmban dy aksioma në tendencat e saj kryesore:

- aksioma e parë: metafizika e së vërtetës është bërë e pamundur - aksioma e dytë: gjuha është vendi kyç i të menduarit, sepse aty zhvillohet loja e kuptimit

Në dy aksiomat e lartpërmendura, Badiou njeht një rrezik të madh - paaftësinë e filozofisë për të përmbajtur dëshirën e saj, mundësia e një humbje të plotë të dëshirës revolucionare, braktisja e motiveve të jetës dhe lumturisë së vërtetë - në favor të një doktrine individualiste dhe identitare të kënaqësisë.

Ai sheh një problem në vendin qendror të gjuhës - nëse filozofia është kryesisht një meditim mbi gjuhën, nëse vendoset në pluralitetin e lojërave gjuhësore dhe kodifikimin e tyre gramatikor, ajo nuk do të ngrihet mbi pengesën që bota i paraqet universalitetit, me specializimin, fragmentimin, dhe abstragimin. Një nga rreziqet që ai sheh në epërsinë e gjuhës është përpjekja për të shpallur një gjuhë si shpëtimtare. Dihet që Heidegger-i i dha privilegj gjuhës gjermane, sepse ajo kishte kapacitet për t'u hapur dhe në këtë drejtim ishte pasardhësi i gjuhës greke. Primati radikal i një gjuhe të

privilegjuar në asnjë mënyrë nuk e zgjidh çështjen e pengesës që bota moderne i paraqet thirrjes së filozofisë drejt universale. Badiou është i bindur për një gjë kyçe, por të vështirë për t'u provuar - se gjithçka në këtë botë rregullohet nga ligji i qarkullimit të sendeve, parave dhe imazheve. Dhe të ndërpritet një parim i tillë qarkullimi nuk është i mundur pa një ndërprerje radikale dhe të pakushtëzuar, pra një ide strategjike që do të ishte krejtësisht antagoniste me një qarkullim të tillë, dhe subjektivitet egoist dhe injorant, dhe që do të ishte kushti i parë për realizimin e rrugës së vërtetë të lumturisë.


Për të ruajtur katër dimensionet e dëshirës filozofike (revolta, logjika, universaliteti dhe rastësia) pavarësisht nga katër pengesat që bota moderne i kundërshton (tregtia, komunikimi, abstraksioni monetar, obsesioni me sigurinë) është e nevojshme të trajtohen tre orientimet filozofike mbizotëruese: hermeneutike, analitike dhe postmoderne. Badiou pretendon se ka diçka shumë të kësaj bote në to, diçka që pasqyron në mënyrë të ekzagjeruar fizionominë e vetë botës dhe që duhet të ndalet. Para së gjithash, gjuha nuk është një kufi absolut i mendimit. Badiou i referohet idesë së transmetueshmërisë universale (l'idée de transmissibilité universelle) të cilën Lacan e formuloi si idenë e matematikës (l'idée de mathème) - e cila i drejtohet të gjithëve dhe nuk privilegjon askënd, pranon pluralitetin dhe e ndërton universalitetin e vet brenda vetes.

Së dyti, sipas mendimit të Badiou, kategoria e së vërtetës duhet të rindërtohet filozofikisht, pa restaurim dhe pa arkaizma, me ndërjegjësimin e ngjarjeve moderne. Rrjedhimisht, kategoria e lëndës gjithashtu do të rindërtohet. Dhe kjo duhet bërë në atë mënyrë që të mos bëhet fjalë për rivendosjen e metafizikës, por për ripërcaktimin dhe rigrupimin e vetë filozofisë, në një element kategorik që autorizon të menduarit me një pikë fikse. Gjithashtu, filozofia duhet të ngadalësojë mendimet e saj, të përcaktojë kohën e saj dhe të mos ndjekë botën e përshpejtuar, dhe kështu të raskapitë veten. Sepse e gjithë lumturia e vërtetë presupozon lirinë nga koha. Filozofia është e sëmurë, pa dyshim, dhe goditjet që

i janë shkaktuar janë, si gjithmonë, të ndërlihdura me vështirësitë e brendshme. Por, shkruan Badiou, sado që vdes apo e vdekur, vetë bota që e shtyn për të shkatërruar dëshirën e saj - në mënyrë paradoksale i kërkon asaj të jetojë. Si zakonisht, kuptimi i botës është i dyfishtë. Në singularizmin e mendimit, Badiou gjen një zgjidhje të mundshme për filozofinë e rastësisë, një nga përbërësit e dëshirës filozofike, pikërisht sepse pikërisht në singularizëm, pra në çdo vendim të vetëm, fshihet shtëpia e çdo vendimi, i cili është gjithashtu i rastësishëm, por sigurisht - mund të jetë edhe i vërtetë.

Lumturia si ide e re në Evropë

Pikërisht në singularizëm, dhe nevoja që secili të vendosë vetë dhe të flasë në emër të vet, të reagojë kur të dalë e vërteta e re, Badiou zbulon mundësinë që të gjithë të gjykojnë se çfarë është e gabuar, çfarë është e vërtetë, çfarë është e keqe. Sipas Badiou, sipas kësaj çështjeje politike, nga ne kërkohet një filozofi e singularizmit dhe në këtë kuptim një filozofi e së vërtetës. Dhe sa i përket ekspansioneve bashkëkohore komunitare, fetare, raciste dhe nacionaliste - Badiou beson se filozofisë i kërkohet të gjejë kapacitetin për të propozuar një figurë të rinovuar, një figurë themeluese të racionalitetit që do të ishte homogjene në botën moderne. Ai flet gjithashtu për paradoksin që më e mira nga të gjitha botët e mundshme, e cila ka provuar dorën e saj në paradigmen e revolucionit dhe emancipimit, mund të dalë kriminale dhe e korruptuar. Ai është gjithashtu i prekshtëm, jo aspak i bazuar në stabilitetin e përhershëm të qenies së tij. Autori beson se filozofia duhet të jetë në gjendje të pranojë dhe të mendojë për ngjarje të tilla (dhunë, luftë, shtypje), edhe me çmimin e shkëputjes nga qasja analitike, hermeneutike apo postmoderne. Ajo që kërkohet nga filozofia është një propozim, diçka si një strehë ose një



zarf - dëshira e filozofisë, e asaj që mund të quhet një nyje racionale e singularizmit, ngjarjes dhe së vërtetës. Kjo nyje duhet të shpikë një figurë të racionalitetit, sepse të gjithë e dinë se si është të lidhësh singularizmin dhe një ngjarje me të vërtetën, si të tillë, në traditën klasike - një paradoks. Por Badiou vazhdon se është e nevojshme të vendoset një paradoks i tillë në qendër - nëse duam që filozofia bashkëkohore të mbrojë dëshirën e saj dhe artikulon edhe një herë në mënyrë konstruktive aforizmin e njohur të Saint-Just: lumturia është një ide e re në Evropë. Badiou beson se një nyje e tillë është një doktrinë e re e mundshme e temës. Në çdo rast, Badiou shkruan: Mbaro me atë fund tashmë! Sepse autori e di që filozofia është e sëmurë, ndoshta ajo tashmë është në rrugëdalje. Por bota i thotë atij njeriu që po vdes: "Ngrihu dhe ec nën imperativin e Idesë së së vërtetës që na premtton lumturi". Badiou konstaton se "lumturia" është një fjalë sintetike për ndikime të ndryshme që lidhen me procedura të ndryshme të vërteta. Ka një ndikim të ndryshëm për çdo lloj të vërtete dhe në këtë dhe ai përpigjet të flet për entuziazmin për veprim politik, lumturinë për zbulimin shkencor, kënaqësinë për krijimin artistik dhe

gëzimin për përpjekjet e dashurisë. Të vërtetat, si të gjitha gjërat, thotë ai, janë të shumëfishta. E vërteta, në fund të fundit, është gjithmonë një shumësi e unifikuar, e dominuar ose e organizuar nga diçka që e bën gjithçka në të jo domosdoshmërisht të përputhshme reciprokisht. Ajo integron format dhe ngjyrat, të cilat përndryshe janë të papajtueshme, në një mënyrë superiore. Ka një shprehje të Aristoteli që më pëlqen shumë dhe që me kënaqësi e adoptoj, thotë Badiou: "Të jetosh i pavdekshëm". Ka edhe emra të tjerë për këtë afekt: "lumturi" te Spinoza, "gëzim" te Pascal, "supernjeri" te Niçe, "shenjtëri" te Bergson, "nderim" te Kanti. Besoj se ka një afekt të jetës reale, të cilës i vë emrin më të thjeshtë, atë të lumturisë. Filozofia është tre gjëra. Është diagnoza e epokës: çfarë sugjeron epoka? Është një ndërtim modern i konceptit të së vërtetës. Në fund të fundit është një përvojë ekzistenciale që lidhet me jetën reale. Uniteti i këtyre tre gjërave është një filozofi. Kur shkruan për "Imanencën e të vërtetave", ai, realisht propozon unitetin e tre komponentëve të çdo filozofie. Badiou rendit të gjitha përkufizimet e propozuara të lumturisë dhe i ripërmbledh ato si më poshtë: Lumturia është një shenjë e sigurt e

aksesit të plotë ndaj të vërtetave. Lumturia nuk është një kompensim për virtutin, është vetë virtyti [Spinoza]. Lumturia është një përvojë afirmative e thyerjes së fundshmërisë. Lumturia është një ndikim i jetës reale. Lumturia e vërtetë është një figurë subjektive e të hapurës. Lumturia e vërtetë është ndikimi i demokracisë. Lumturia e vërtetë është kënaqësi në forma të reja të jetës. E gjithë lumturia e vërtetë presupozon lirinë nga koha. Vetëm ai që pranon të bëhet subjekt nga një person është i lumtur. Ecja nën imperativin e Idesë së vërtetë na drejton drejt lumturisë. E gjithë lumturia e vërtetë ndodh në një takim të rastësishëm, nuk ka nevojë të jesh i lumtur. Një sasi e caktuar dëshpërimi është një kusht për lumturinë e vërtetë. Afekti i efektit të subjektit, goftë ai të quhet entuziazëm politik, lumturi shkencore, kënaqësi estetike apo kënaqësi dashurie, është gjithmonë ajo që meriton, përtej çdo plotësimi të nevojave, emrin e lumturisë. Lumturia është gjithmonë kënaqësia e së pamundurës. E gjithë lumturia e vërtetë është besnikëri. Lumturia është ardhja, në një individ, e Subjektit që zbulon mundësinë e mbërritjes. Lumturia është po aq një ndikim i Subjektit sa një përjashtim imanent. Thelbi i vërtetë i lirisë, kushti themelor i lumturisë së vërtetë, është disiplina. E gjithë lumturia është një fitore mbi fundin. Çdo lumturi është një kënaqësi e kufizuar në pafundësinë. E gjithë lumturia arrihet, në një kuptim, nga vullneti.

Po, lumturia është e vështirë për t'u kuptuar dhe arsyet për këtë janë komplekse...

Reflekse

NJË SPROVË E SUKSESSHME

(Disa fjalë rreth librit të Alma Zenellarit, "Libri i yjeve")

Nga Agim BAJRAMI

Të shkruash për fëmijët dhe të jesh i suksesshëm me ta, duhet patjetër që të jesh edhe vet pak i tillë ose të rikthehesh me imagjinatë në moshën e tyre. Nuk di pse më kujtohet kjo sentencë e shkrimtarit të njohur për fëmijë Bedri Dedja, sa herë që më bien në dorë vepra të autorëve tanë të suksesshëm, si "Libri i yjeve". Alma Zenellari edhe përkundër pozitës shoqërore dhe statusit të saj si nënë, është dhe mbetet me krijimtarinë e saj një fëmijë i përjetshëm. Duke lexuar këtë libër me një titull metaforik, kupton se cilat janë preferencat dhe dëshirat e fëmijëve të sotëm shqiptarë, problematikat dhe zhvillimet që lidhen me jetët dhe rritjen e tyre. Banore e planetit të ëndrrave, kur ja do puna, por dhe e fantazive të pafundme, krijimet e saj marrin atributet e makinës së kohës, që të çon si pa kuptuar në magjinë e moshës së bukur të fëmijërisë sonë. Është një magji që mund ta bëjë vetëm një penë e frymëzuar dhe e përkushtuar si e Almës, larg trajtimeve të njohura dhe skemave të gatshme soc-realiste që janë ende të dukshme në këtë letërsi. Është ky shkaku që sapo e ke mbyllur këtë libër, ndien së brendshmi nevojën

për të qenë edhe njëherë fëmijë dhe të flakësh nga supet vitet e shumta të moshës. Personazhet e bukur që të shoqërojnë në këtë libër, kanë secili nga një ndodhi për të na treguar, por edhe për të na bërë nga një pyetje. Përgjigjet e qëlluara dhe gjuha e veçantë me të cilën komunikojnë ata me ne, flasin për një përvojë të gjatë njohëse dhe krijuese të autores në këtë fushë. Edhe pse ky është libri i parë në këtë zhanër, pjekuria artistike dhe niveli i lartë i të shkruarit, të krijojnë përshtypjen se ky mund të jetë libri i saj i dhjetë. Heronjtë e këtyre poezive janë vetvetja. Ata nuk e njohin ndrojtjen e moshës dhe pasigurinë që karakterizonte fëmijët e një brezi tjetër. Shumica e tyre karakterizohen nga etja për njohje, por edhe për të qenë protagonistë në të gjithë amplitudën e përditshmërive të tyre. Që nga poezia e parë që hap librin dhe gjer tek e fundit, autorja dhe heronjtë e saj ecin dorë për dorë me njeri tjetrin, jo vetëm për të mos humbur rrugën e rrëfimeve të tyre, por edhe për të qenë sa më pranë njeri tjetrit në çdo situatë. Duke qenë në kontakt përditësor me yjet e saj, fëmijët, vëmë re se mes autores dhe personazheve të saj kufijet ndarës të moshës janë zhdukur si me magji. Të dy palët duket se njihen mirë dhe nuk

kanë ndrojtje për t'i besuar njeri tjetrit sekretet dhe të pathënat e jetëve të tyre. Fëmijët e sotëm nuk janë më ata të dikurshmit, është pohimi parësor i këtij libri ndaj dhe gjuha me të cilën duhet folur me ta, duhet të jetë krejt e ndryshme. Ndryshimi i kushteve sociale dhe shoqërore, kanë sjellë një tjetër brez dhe një tjetër psikologji te ta. Ky është një fakt që i ka shpëtuar shumë autorëve të kësaj letërsie, që vazhdojnë të sillen në krijimtarinë e tyre njëllor si me fëmijët e viteve 80 -90, por jo i autores në fjalë. Aftësia e saj për të vjelë ndodhi, ngjarje dhe qëndrime nga jeta e tyre, i kanë sjellë asaj në tryezë, një shportë me material të bukur dhe të pasur jetësor. Në këtë kontekst, autores nuk i ka mbetur gjë tjetër përveç se të merret me artikullimin artistik të këtij materiali dhe të na i sugjerojë dhe neve për t'i lexuar. Është një botë shumëdimensionale dhe shumëngjyrëse që kur di, të trajtohet mirë, fiton vlera të mirëfillta artistike. Singjeriteti i rrëfimeve dhe natyrshmëria me të cilën përcillen, e bëjnë këtë libër të vogël nga fletët, por të madh nga mesazhet dhe pohimet, që merr përsipër të na transmetojë. Forca e vargut, ngarkuar me krahasime të gjetura dhe simbole, është

imponuese. Edhe pse autorja është e njohur në poezinë për lexuesit e rritur, ky libër i ri është treguesi i aftësive të rralla vëzhguese të saj në këtë fushë. Janë krijime ku nuk mungon entuziazmi, por edhe prirja për të folur me ta me gjuhën e tyre të veçantë. Heronjtë e këtij libri janë engjëj të zbritur nga qielli për ta bërë këtë botë më të bukur dhe më të singertë. Ata vijjnë mes nesh për ta na bërë edhe ne si vetja. Nisur nga ky fakt, autorja nuk kursehët t'i pikturojë ata me ngjyrat dhe figurat më të bukura që disponon arsenalin e saj poetik. Hulumton dhe mbledh nga lëndina e luleve të tyre nektarin dhe polenin më të mirë. Lexon poezinë hapëse të librit për mësuesen e parë dhe ndihesh befasisht i veshur edhe ti me fëmijëri dhe emocione: "S'harroj buzëqeshjen margaritar/ Dhe fjalën tënde të ngrohtë, të urtë/ Kur ti më fshive lotin e parë/ Mësuesja ime e ëmbël, shpirt butë./ Ti më mësove a,b,c -në /Me dashuri dhe përkushtim /Dhe shkronjat bashkë fjalë i bëmë/ Mes germash gjeta mrekullinë/ Është një poezi që të frymëzon dhe krijon brenda teje një atmosferë të cilën mund ta injektojë në gjak vetëm figura e shenjtë e kësaj mësueseje dhe plotëria e portretit të saj artistik. Poezia nuk


merr përsipër të tregojë histori, por të ndërtojë me mjetet e saj ndjenjën e mirënjohjes së përjetshme të brezave. Të njëjtat drita të ngrohta e shoqërojnë lexuesin e vogël edhe në poezinë kushtuar nënës. Ndonëse këtë herë me një tjetër strukturë vargëzimi, pyetja retorike që hedh në ajër poezia, e ka me vete përgjigjen: "A e dini cili është djepi im i parë/ Që ëmbëlsisht më nanurit dhe përkund?/ Është dora e butë e nënës sime /Krahët e saj me ëmbëlsi me mbështjellin pafund". Duke hyrë në brendinë e këtyre dy poezive për këta dy njerëz të shtrenjtë, krijimi poetik del si pa ndërje nga e zakonshmja, duke e veshur veten me një frymë dashurie hyjnore. Të njëjtin nivel artistik dhe të njëjtën elegancë vargjesh ndesh edhe në poezitë e tjera si "Fli Matin", "Pse u vrejti Drinalda", "Njolla mbi përparëse", "V - e patave të egra" etj etj. Shoqërimi i ideve me figura dhe simbolikë të perceptueshme nga mosha e lexuesve të vegjël ka qenë qëllimi parësor i kësaj autoreje të talentuar. Kjo e bën leximin e tyre të këndshëm dhe me shumë interes. Tek poezia " Samanta në bibliotekë", autoren e ngacmon loti i pastër i një vajze të vogël, që ka humbur librin. Futja e detajit artistik të engjëllit, që mund ta ketë marrë atë, i jep krijimit një kthesë të papritur dhe interesante.

Përse qan Samanta / Kërkoj të ma thotë /Tek syri i saj i bukur /Pikoka një pikë lot /Pikon loti i saj /Përmby syn e bukur/ I them shpirt mos qaj /Se libri s'ka humbur/ Edhe pse të natyrave të ndryshme heronjtë e këtij libri, frymorë dhe jo frymorë, janë të prirë për të fantazuar dhe për t'i zhbiruar me këmbëngulje viset dhe ambientet e tyre respektive. Si

të tillë shumë pyetje të tyre meritojnë nga një përgjigje nga autorja, të cilave ajo nuk ua përtun asnjëherë. Herë duke iu drejtuar imagjinatës së ndezur poetike dhe herë të tjera, duke përdorur dijet e saj të plota shkencore që zotëron bashkëbisedimi i saj me ta, vijon me intensitetin e duhur. Ndërsa lexoja poezinë "V - e patave të egra" me emocionoi fryma e ndërje lirike dhe aftësia që ka kjo autore për t'ia përcjellë atë sa më të plotë te kategoria e lexuesve që u drejtohet. Të njëjtat emocione provon edhe mbas leximit të poezisë "Lojë matematike". Kjo e fundit është një lloj, shumë pak e lëvruar në poezinë tonë dhe si e tillë meriton interes. Të tillë ndjesi të ngjall edhe poezia "Personazhet e përrallave në natën e Vitit të Ri", "Borëbardha" etj., ku penelatat e autores lëvizin gjithmonë të orientuara nga drita.

Kjo gjë jo vetëm u ka dhënë jetë portreteve, por edhe i ka nxjerrë ato nga velatura e njohur misterioze, me të cilat kanë qenë të mbuluara gjer më tash. Veprime të tilla artistike janë jo vetëm tregues mjeshtërie, por edhe tregues të kulturës së gjerë që zotëron ajo. Bota e kafshëve dhe sendeve është gjithmonë një objekt i preferuar i shumë autorëve të letërsisë për fëmijë. Ka që ia kanë dalë me sukses, ka që kanë mbetur ne mes të rrugës. Autorja jonë bën pjesë tek të parët.

Bleta, harabelat, gerrat O, F,B , bora etj. shquhen jo vetëm për trajtimet e tyre origjinale, por të befasonjë për humorin e këndshëm dhe frymën edukative që përcjellin tek fëmijët. E dukshme në këto lloj poezish është fakti që emocionin që ngjall veprimi i tyre shoqërohet ndërkaq edhe me atë të autores. Parë në këtë kontekst,



them se "Libri i yjeve", është një sprovë e suksesshme e kësaj autoreje dhe një thirrje për të mos u mjaftuar vetëm me kaq. Dalja në dritë e këtij libri, sa

të thjeshtë, të pasur dhe të bukur është një pasurim dinjitoz i letërsisë sonë për fëmijë.

Qasje

ETIKA INTEGRALE E HIVZI SULEJMANIT

Romani voluminoz "Njerëzit" është absolutisht një ndër krijimet e rëndësishme shqiptare/kosovare që e vë autorin në majat e prozës moderne shqipe

Bujar MEHOLLI

Sikur në tregime ashtu edhe në prozën e gjatë, Hivzi Sulejmani ka si pikënisje të itinerarit të tij letrar/artistik besimin në njeriun, gjegjësisht në virtytet e tij sociale. Ndaj, siç thotë profesor Qosja, ai, shtron kërkesa të mëdha në këtë pikëpamje sepse njeriun e sheh si krijesë me vetëdije dhe etikë, prej nga dhe duhet të vijë reflektimi i tij si pjesë e shoqërisë. Hivzi Sulejmani orvatet ta krijojë veprën si dëshmi e kohës të cilën e jeton, pra, gjallon mes saj. Bindjet e tij të majta priren vetvetiu kah trajtesa e problematikave delikate socio-politike por duke u shtyrë drejt një venerimi të hollësishëm të krijesës njeri që, për dallim nga kafsha, është i vetëdijshëm për privimin nga jeta.... siç shkruan Rilke në këto vargje emblematike: "Ne nuk kemi kurrë asnjë ditë të vetme hapësirën e kulluar para nesh në të cilën lulët çelin pambarimisht/Përherë është botë dhe asnjëherë askund pa jo: e kulluara, e paruajtura, e cila thithet dhe dihet pafundësisht dhe nuk dëshirohet/Kush na ka bërë pra kështu që çfarëdo që të bëjmë kemi qëndrimin e atij i cili merr rrugë?/Kështu jetojmë ne dhe ndahemi gjithmonë..."


Hivzi Sulejmani është i preokupuar, si artist, me idetë etike të njeriut, sepse mendon se ato mbrusen edhe me idealet shoqërore në përgjithësi. Por

analiza e hollësishme e njeriut çon drejt shkarjes etike e cila objektivizohet si problematikë e veprës së Sulejmanit – një çështje e vjetër dhe e trajtuar dendur në art. Hivzi Sulejmani – thotë Qosja – ka shtruar një problem bashkëkohor që në botë e shtrojnë shumica e shkrimtarëve, që s'iu reshtën dialogjeve më të ashpra me kohën dhe shoqërinë Sulejmani kërkon nga njeriu konsekuencë, kërkon njeriun parimor i cili do t'i mbrojë idealet e tij në çfarëdo mënyre duke u udhëhequr nga morali qoftë në paqe, qoftë në luftë – për ta arritur lumturinë; siç thotë Aristoteli "ne zgjedhim nderin, inteligjencën, kënaqësinë dhe çdo lloj virtyti për shkak të lumturisë duke supozuar se nëpërmjet tyre do të jemi të lumtur". Hivzi Sulejmani si shumë autorë, shqiptarë dhe të huaj, të pjesës së parë të shekullit XX u ngritën kundër regjimit nazi-fashist që gjithsesi s'e premtonte lumturinë. Përkundrazi. Penda e Sulejmanit mbronte fuqishëm njeriun kurdoherë, por jo pa i vënë në optikën kritike edhe të metat, devijimet, shkarjet, tradhtitë, servilizmin... shkurt, Hivziun e preokuponte, sikur dhe shumë krijues tjerë – dilema e kamotshme: si të bëhet njeriu, njeri?!

Qosja vazhdon: Rruga jetësore i ka dhënë mundësinë Hivzi Sulejmanit që të shohë se si njeriu di të jetë i fortë dhe i pakalueshëm, por në të njëjtën

kohë servil, karrierist dhe i pashpirt. Hivzi Sulejmani mban qëndrim kritik ndaj njeriut dhe jetës së tij, s'mund të qëndrojë indiferent karshi dukurive sociale e problemeve politike. Për Qosjen, ai, s'ka treguar kurrë gatishmëri të sakrifikojë të vërtetën për hir të oportunitetit dhe të dobisë individuale, si krijues nuk ka mundur e nuk ka dashur të shkruajë ndryshe përpos ashtu siç i përgjigjet natyrës së tij të vrojtimit dhe të pohimit, krijues që shkruan në pajtim me vetëdijen e tij morale dhe marksiste. Edhe në tregime, fjala vjen, te "Mjegulla", Hivzi Sulejmani parashtron idetë e tij etike-filozofike duke shtruar kërkesa të mëdha për krijesën njeri, e megjithatë ky problem është i vjetër sa bota, pra, përsosmëria etike, besimi te tjetri, kauzaliteti, sakrifica, përafrimi... të gjitha këto janë përdhosur e përdhosen vazhdimisht nga vet njeriu. Ndaj "Mjegulla" ndërtohet sipas një skpeticizmi etik që vjen me një stil shkrimi mjaft konciz, përmes dialogëve, personazheve që janë polet e kundërta në brendësinë e njeriut dhe nisin e çajnë aurën e humanitetit: "Edhe një herë nuk u ndanë. Vazhduen jetën si më parë. Dhe u zhagitën nëpër të gjithnji tue u përta. Në vështirsina, në sprovime... Shum vjet me radhë. Por... Nji ditë, Jaku e kapi Ajakun për fyti. E shtrëngoi me tanë fuqi që kishte. Ajaku u zverdh, u turr

me forcat e fundit. U bë rrokupujë... Në fund – nji dridhje e dobët dhe – Jaku e mbyti Ajakun. Edhe vehten me të. Sepse trupi ishte nji. E jeta vetëm nji. U çue, prap, tymi. Prej tymit – Jaku dhe Ajaku të rij. Filloi gëzimi. Jetuen, mandej, do vjet të kandshme. U rritën dhe prap u ndanë në: sot e nesër. Ma në fund edhe ky Jaku e mbyti Ajakun. Prap u çue tymi. Prej tij – Jaku dhe Ajaku. Edhe nji herë u bë gëzim. Mandej pikllim. Pastaj tym. Pikllim. Tym." (Hivzi Sulejmani, "Era dhe Kolona", Rilindja, Sipërmarrje gazetare-botuese, Prishtinë – 1959, fq. 27) Nëse jo iluminizmi dhe racionaliteti e etja për dije, nëse jo paqja nga zhvillimi i hovshëm teknik, nëse jo religjioni e besimi, atëherë çfarë do të duhej për humanizmin dhe universalitetin e njeriut? Dobësimin e ndërgjegjes së njeriut, mjerisht, – shkruan tutje Qosja – nuk e kanë penguar fare as dogmat e Krishtit dhe Muhamedit, por as doktrina më humaniste dhe universale në historinë e qytetërimit, e Karl Marksit. Të pamurit e njeriut kuantitativisht përbën një problem mjaft të madh sepse reduktohet në masë të madhe të pamurit kualitativisht i qenies njerëzore duke krijuar interesat vetiake, egoizmin, premisa të mjaftueshme për të realizuar të këqijat më të llahtarshme që çuan deri te Hitleri dhe autokratizmi i tij. Jo rrallë herë Hivzi



e sheh nga pikëpamja skepticiste gjallimin e njeriut, madje duke ngritur nivelin pesimit alla shopenhauerian a niçean. XX Hivzi Sulejmani hyri në prozën shqiptare si njeri konsekuent, shkrimtar i vetëdijshëm për misionin e tij - jokonformist, zë avangardist kundrejt konformizmit e burokratizmit, i brumosur me ide të majta, me ndikime nga autorë të spikatur antifashistë si Remarque e Hemingway, marksist idealist e humanist, autor që kërkojë shumë nga njeriu, por edhe u zhgënjye jo pak, kritikues i mirëfilltë i parimeve që shndërrohen në dogma, i njerëzve ambiciozë e karrieristë që "bëjnë amin për çdo gjë dhe e konsiderojnë ligjin si një dogmë para së cilës përkulen sikundër përkulen njerëzit e devotshëm para formulave të Kuranit apo të Ungjillit." I ndodhur mes modernizmit dhe realizmit tradicional, Sulejmani, adapton një stil disi më të thatë, të saktë e konkret, eviton lajleulet

e përshkrimet sipërfaqësore, të shprehurit e tij është diskursiv dhe absorbon një ironi të hollë e cila përputhet bukur me gjithë idealin parësor të autorit, moralin dhe etikën njerëzore në traditën e Gogolit i cili do të trajtonte probleme krciale shoqërore me prirje të rrallë për të krijuar skena humori e gazi përmes së cilave thumbohet aparati shtetëror i Carit dhe shkarjet e shumta socio-politike. Te "Njerëzit" hasim në pasazhe përsiatjesh mediativo-filozofike mbi jetën dhe qeniet humane që gjallojnë në të. Në kuvendimet që personazhi kryesor i bën me vete, Sulejmani shtron para idetë me të cilat qe brumosur karakteri i tij; pra jeta ia vlen të jetohej por njerëzit kanë përgjegjësi të mëdha për ta bërë botën të jetueshme... Fjala vjen, Hafizi (Hivzi) mendon për vetëvrasjen, burracakërinë... "kur dhembja fizike ose shpirtërore bëhet aq e tmerrshme dhe e padurueshme, sa vdekja duket se

është e vetmja rrugëdalje dhe i vetmi shpëtim. Atëherë njeriu, jo vetëm që ikën prej saj, por edhe e kërkon dhe e pranon. Atëherë ajo nuk është as e dhembshme, as e tmerrshme, ajo është e vetmja rrugëdalje. E vetmja zgjidhje... jo, jo. Për të ngrehur dorën kundër jetës sate nuk është dobësi. Kjo s'është dobësi. Ky është veprim që bëhet prej dashurisë tepër të madhe për jetën, jetën pa kompromis, jetën më të bukur, më të pastër dhe më njerëzore..." (Hivzi Sulejmani, "Njerëzit", Sh. B. Rilindja, Prishtinë, fq. 38) Një pasazh i mbrusur me filozofi ekzistenciale që tipizohet në personin e Hafizit - njeri me moral të fortë, mendimtar, herë-herë i zhgënjyer e mbërthyer nga tisi i pesimizmit por megjithatë vetëmohues e i vendosur... Romani voluminoz "Njerëzit" është absolutisht një ndër krijimet e rëndësishme shqiptare/kosovare që e vë autorin në majat e prozës moderne shqipe. "Njerëzit" përbën autobiografinë e Sulejmanit i cili përshkruan jetën revolucionare, angazhimin politik dhe luftën e vendosur kundër regjimit nazi-fashist. Odiseu i tij na jepet përmes një gjuhe të fuqishme dhe të gjallë, krahas shpalosjes së shumë ngjarjeve politike/sociale të kohës që përshkruhen me stilin zhurnalistik. Hafizi, personazhi kryesor, është djalosh i vullshëm, guximtar, luftëtar i vendosur kundër regjimit dhe padrejtësive; ai kalon nëpër shumë peripeci mes shëndetit të ligë e dëshpërimit. Azizi, vëllai, po ashtu antifashist i përbetuar, lufton por përfundon në duart e Gestapos të cilët e torturojnë gjersa e vrasin. Paraprakisht ky s'flet gjë për shokët dhe në roman ndonëse paksa skematik tipizon njeriun idealist dhe të vendosur e besnik në kauzë, qoftë dhe duke e paguar me jetë. Preferon të vdesë ndershmërisht mes torturave. (Vëllai i dytë që humb Hafizi). Dhe, natyrisht, Xhemilja, nëna. Një grua herkuliane shqiptare. Portretizimi i saj është fare i veçantë dhe i ndërtuar me mjeshtëri dhe kujdes. Kjo grua kalon nëpër shumë vështirësi tok me djemtë, përjeton dhimbje të mëdha por mbahet! Qëndrimi i saj stoik karshi stuhive shoqërore është i jashtëzakonshëm dhe ajo, Xhemilja, ngelet personazh i paharruar që tipizon shëmbëlltyrën morale të gruas shqiptare që me ndershmëri e forcë u bën ballë tallazeve jetësore pa u zbrapsur asnjëherë. Qyteti i Mitrovicës - me kafenetë, çajtoret, hotelet, çarshinë, Trepçën, urën e gurtë të Ibrit, Shticën, njerëzit e ndershmë, por edhe agjentët e Gestapos që ngarendin dhe mbjellin frikë dhe pasiguri - zë vend të rëndësishëm

në roman. Mitrovica përshkruhet si qytet mjaft funksional, me arkitekturë urbane e me ngrohtësi në secilën rrugë e rrugicë të saj. Hafizi dhe familja jetonin aty; në Mitrovicë përshkruhen gjithashtu vuajtjet, padrejtësitë sociale që i sillte regjimi i kohës, çizmet e armikut, por gjithsesi Hivzi ka shpresë se terrori do të kalojë dhe ditët e mira do të vijnë, e qyteti do të frymojë lirshëm... Hafizi brendh nëpër Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Prizren, Prishtinë... i burgosur dhe i persekutuar por asnjëherë i thyer! Kemi të bëjmë me një roman të guximshëm i cili të emocionon duke provuar se çfarë regjimi i llahtarshëm ishte fashizmi dhe ngarendja pas ideve, në thelb, të krisura. Humbja e vëllezërve dhe e shumë miqve, lamtumirat me duart e shtrënguara, sëmundja e Hafizit që gati sa i merr jetën, dëshpërimi i Xhemiles që s'i pa djemtë e martuar e s'pati nipër e mbesa, torturat që pëson Azizi para vdekjes, janë episodet më prekëse, thellësisht humaniste, të romanit që marrin nota melankolike dhe si mjeshtëri narrative mund të krahasohen me emrat e mëdhenj të prozës evropiane antifashiste e progresiste...

Rexhep Qosja në parathënien e librit shprehet se: "Hivzi Sulejmani është në gjendje, dhe i gatshëm, të besojë se prore do të ketë njerëz që nuk i tjetërsojnë virtytet. S'ka dyshim se Hivzi Sulejmani është shkrimtar që ka dalë me një përvojë të rëndë, specifike, nga lufta. Ai, vazhdon Qosja - padyshim manifeston në krijimtarinë e tij vetëdijen e qartë se ta duash njeriun pa ia vërejtur të metat dhe të mirat domethënë se nuk je në gjendje ta duash fare, se nuk je realist as ndaj të tanishmes, as ndaj ardhmërisë së tij". Hivzi Sulejmani shkruan si realist kritik, humanist, duke portretizuar tablonë e dhimbshme të popullit shqiptar në atë kohë të errët, duke besuar çdoherë te njeriu, etika e tij, dhe ndryshimi! Bashkë me Petro Markon (i cili romanin "Një emër në katër rrugë" e nis me "Rroftë jeta!") dhe disa autorë të tjerë përbën plejadën e prozës realiste shqipe dhe konsolidimin e romanit si zhanër. Ja një pasazh utopist nga fundi i romanit: - "E, ofshani Hafizi - sikur nënat dhe mësuesit ta sundonin botën, edhe jeta do të ishte tjetër. Nuk do të kishte as të këqia, as padrejtësi. Të gjithë do të ishin njerëz dhe do të jetohej njerëzisht. Të gjithë do ta ndihmonin dhe do ta nderonin njëri-tjetrin. Lotë do të kishte krejt pak, e lumturi me bollëk. Jeta do të ishte vetë lumturi."

Ana tjetër e medaljes

TA REFUZOSH VETVETEN, APO...

Dostojevski tregon në ditarin e tij se ditën e dënimit me vdekje, ai qëndroi para vendit të ekzekutimit dhe shikoi përreth. Sa e shkëlqyer ishte drita, sa i mrekullueshëm i dukej ajri që thithte, sa e bukur ishte bota përreth dhe sa i çmuar çdo moment i jetës së tij

Enida Sheshi HAXHI

Albert Camus në «Mitin e Sizifit» shkruan: "Ka vetëm një problem filozofik me të vërtetë serioz: vetëvrasja. Vetëvrasja nuk duhet trajtuar si një dukuri shoqërore. Vetëvrasja është një veprim që përgatitet në thellësi të shpirtit, ashtu si edhe veprat e mëdha. Shoqëria nuk luan ndonjë farë roli në fillim. Krimbi gjendet në shpirtin e njeriut. Të vrasësh veten, do të thotë të rrefehesh. Të tregosh se ke mbetur prapa nga jeta ose që nuk kupton. Njerëzit vazhdojnë të bëjnë veprime që ua imponon ekzistenca për shumë arsye, nga të cilat e para është zakoni. Të vdesësh me dashje parakupton që

e ke zbuluar, qoftë edhe instiktivisht, karakterin qesharak të këtij zakoni, mungesën e çdo lloj arsye të thellë për të jetuar". Për Arthur Schopenhauer, vetëvrasja është një akt vullneti që shpreh lirinë për të disponuar mbi veten në mënyrën më elementare dhe radikale. Nietzsche në «Kështu foli Zarathustra» bën protagonistin e librit të tij të thotë: "Kush i jep fund lirisht fatit të tij, vdes si fitues, i rrethuar nga ata që premtojnë dhe shpresojnë... Të lavdëroj vdekjen time, vdekjen e lirë, që vjen sepse dua". Për Jean Paul Sartre, vetëvrasja përfaqëson mundësinë ekstreme të lirisë. Karl Jaspers, e përkufizon vetëvrasjen si "operacioni i vetëm që çliron të gjitha veprimet tona të brendshme. Vdekja, e

cila është një situatë kufizuese me vlerë vendimtare për ekzistencën, - është një fakt që ndodh të shihet dhe nuk thirret. Vetëm njeriu, pasi di ta kuptojë vdekjen, përballet me mundësinë e vetëvrasjes. Jo vetëm që mund të rrezikojë jetën e tij me vetëdije, por mund të vendosë edhe nëse dëshiron apo jo të jetojë. Vdekja i takon sferës së lirisë së tij". E, megjithatë, ka diçka të frikshme në aktin e vetëvrasjes - unë lemerisem sa herë dëgjoj, qofshin të njohur o të panjohur. Vetëvrasjen, për më tepër, shpesh e kam parë edhe si një refuzim të dashurisë për veten, një mohim të aspiratës së natyrisht për jetë, një heqje dorë. Gjithmonë kam parë tek dhimbja dhe vuajtja njerëzore diçka madhështore, e cila shihet në aftësinë që

shfaqin qeniet njerëzore për t'i kapërcyer ato. Vetëm nëse ke njohur errësirën, mundet që të hysh në qenien tënde, brenda vetes tënde. Dostojevski tregon në ditarin e tij se ditën e dënimit me vdekje, ai qëndroi para vendit të ekzekutimit dhe shikoi përreth. Sa e shkëlqyer ishte drita, sa i mrekullueshëm i dukej ajri që thithte, sa e bukur ishte bota përreth dhe sa i çmuar çdo moment i jetës së tij. "Oh! - tha me vete në atë moment - po të më jepnin jetë, nuk do të humbisja asnjë moment!". Është pikërisht ky çast ndërgjegjeje tek i cili ekziston një përsosje e ndjenjës sonë të jetës, përvetësimi i një ndjeshmërie të veçantë ndaj dinamikës së jetës që na bën plotësisht njerëzorë.

Profile: Kostandin LELI


AUTORI I RRËFIMEVE TË SINQERTA PËR FËMIJË

Krahas reportazheve e radioreportazheve të vogla nga jeta e gjallë e fëmijëve, skicave dhe tregimeve, letërsisë dokumentare për fëmijë; Kostandin Leli u mor edhe me shënime letrare për librat për fëmijë, edhe me recensionet dhe kritikën letrare

Xhahid BUSHATI

Kostandin Leli, u lind në vitin 1938 në Tërbuq të Gjirokastrës. Hyri si krijues në letërsinë shqipe, me prioritet letërsinë për fëmijë e të rinj, në fillim të viteve '60. Hyri me botën e një mësuesi, me mbresat e historitë e nxënësve të tij mallakastriotë ku ishte mësues, me tregimet e reportazhet e para, të cilat ishin plot lëng jete. Ky lajtmotiv do të ndiqte pas gjithë krijimtarinë letrare të shkrimtarit Kostandin Leli deri në vitin 1990, kur ndërroi jetë.

Kostandini (ne, miqtë e thërrisnin: Kosta...) kishte mbaruar shkollën e mesme pedagogjike "Luigj Gurakuqi" në Elbasan. Në vitin 1964 nisi punën si redaktor i emisionit të fëmijëve në Radio Tirana. Jeta prej redaktori e gazetari të palodhur dhe këmbëngulës i shërbyen Kostës për të pasuruar përvojën jetësore e më pas artistike me materiale, mbresa, ngjarje e personazhe, që i skaliti aq bukur. Libri i tij i parë me titull "Përsëri me ne" (tregime, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë) u botua në vitin 1969. Më pas botoi përmbledhjet: "Gëzim për të gjithë" (skica e tregime, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1971), "Vështrim nga malet" (skica e tregime, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1974), "Fëmijët e një nëne" (novelë, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1975), "Punët e të gjithëve" (dramë, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1976), "Rrofshin partizanët" (tregime, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1979), "Zogjtë e shkëmbinjtë" (roman, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1979), "Trimëresha e maleve" (tregim i ilustruar, Sh. B. "Naim Frashëri", Tiranë, 1982). Shkroi disa monografi të shkurtra letrare për rreth 60 pionierë që ranë me armë në dorë për lirinë e Atdheut, në serinë me një titull të përbashkët "Trima e të vendosur" (në vëllimet 2, 3, 4 e 6, Sh. B. "Nëntori", Tiranë, 1981, 1984, 1986). Në kujtim të ikjes së Kostës, në moshën 52-vjeçare nga kjo botë, shkrimtari i shquar për fëmijë e të rinj, Odhise K. Grillo, do të shkruante: "Sa herë të hapen frontespicit e shumë e shumë librave për fëmijë, lexuesit e vegjël e studiuesit, do të gjejnë patjetër edhe këtë shënim: KOSTANDIN LELI. Dhe do ta kujtojnë me nderim. [...] Kostandini iku duke lënë pas kujtimin e mirë dhe 12 libra për lexuesit e vegjël, në një kohë që kishte ende për të thënë në fushën e letërsisë dhe të publicistikës për



fëmijë" (Grillo, Odhise: "U foli fëmijëve me dymbëdhjetë libra", gaz. Drita, 28.01.1990).

Kosta, për shumë vite punoi redaktor në redaksinë e letërsisë shqipe për fëmijë të Shtëpisë Botuese "Naim Frashëri". Këtu e njoha. Ishte një natyrë e heshtur, e sinqertë, fliste pak dhe ishte dashamirës. I pëlqenin miqësitë, ndaj dhe i dritësonin sytë. Nuk e lëshonte nga gishtërinjtë cigaren, po ashtu, dukej se cigarja kishte ndërtuar "folezë" në buzët e tij. Siç duket me duhanin kishte miqësi të ngushtë prej vitesh. Nuk mund të ndaheshin lehtë nga njëri-tjetri. Shumë herë u takuam edhe në Shkodër, kur vinte për promovime librash.

Krahas reportazheve e radioreportazheve të vogla nga jeta e gjallë e fëmijëve, skicave dhe tregimeve, letërsisë dokumentare për fëmijë; Kostandin Leli u mor edhe me shënime letrare për librat për fëmijë, edhe me recensionet dhe

kritikën letrare. Nga kërkimet dhe hulumtimet tona, shkrimet e Kostës i gjejmë të botuara në gazetata, si "Mësuesi", "Drita", "Zëri i rinisë" dhe revistën "Nëntori". Kosta lëvroi kryesisht shkrimin recensional, ku pasqyrimi i veprave kishte shpërfaqje të saktë, e shpesh me argumente të teorisë letrare.

Kosta me intuitën e tij dhe përvojën e pasur jetësore, pati disa shikime dhe raporte me veprën letrare që merrte në shqyrtim e, që përpiqej krahas informacionit që jepte për veprën, përpiqej ta zbrëthente e analizonte atë. Edhe unë, në këtë shkrim po përpiqem t'i grupoj këto shikime artistike të Kostës, me qëllimin për të plotësuar edhe këtë faqe të portretit të tij.

Tek romani "Jam bir i popullit tim" i shkrimtarit Ferhat Çakaj; Leli evidenton raportet dhe marrëdhëniet e veprës me kohën që lë shenjë në të, me problematikat përkatëse që trajtonte romani. (Leli, Kostandin,

shkrimi: "Jam bir i popullit tim", gaz. Drita, 13.12.1978). Ndërsa në shkrimin "Çufoja dhe Bubi Kaçurel" - një roman i bukur për fatosa, artikullshkruesi ndalet në këto "stacione": - tek individit si personazh, - tek rrezatimi i botës së tij, - tek trajtimi i së vërtetës artistike dhe asaj jetësore, etj. (Leli, Kostandin, shkrimi: "Çufoja dhe Bubi Kaçurel" - një roman i bukur për fatosa, gaz. Mësuesi, 29.03.1978). Ndërsa në dy shkrimet: "Legjenda dhe rrëfime për Skënderbeun" të Naum Priftit dhe "Poezi të frymëzuara nga jeta e të vegjëlve" (kjo trajtesë e zgjeruar është për librin "Të parën lule kë keni?" -poezi- të poetit Odhise Grillo; Kosta, kësaj radhe, na shfaqet më shumë si kritik letrar, duke iu shmangur tradicionalizmit të shkrimeve të veta. Zbrëthimi i koncepteve zhanrore "legjendë" dhe "rrëfim" prizmohet përmes analizës së tregimeve dhe mishërohet te figura e Skënderbeut, të raporteve të tij me popullin. Në këtë plan shfaqen dhe tiparet njerëzore dhe trimërore të këtij luftëtari të madh që bëri epokë në historinë e Shqipërisë. Ndërsa te libri poetik i Odhisesë, Kosta ndalet në origjinalitetin e poetit Grillo, në konceptimin e tij të freskët të motivit, në format lodërtare ku marrin pjesë dhe fëmijët, në mënyrat e larve poetike larg moralizimeve, në shfrytëzimin me efikasitet të folklorit, në rëndësinë e fabulës së vjershës, në rrjedhshmërinë e muzikalitetin e vargjeve, etj. Veçanërisht në këto dy shkrime shfaqet dukshëm dhe kulturologjia e Kostës. (Leli, Kostandin, shkrimi: "Legjenda dhe rrëfime për Skënderbeun", gaz. Mësuesi, 08.08.1979; shkrimi: "Poezi të frymëzuara nga jeta e të vegjëlve", gaz. Drita, 14.02.1982).

Kontributet e shkrimtarit për fëmijë e të rinj Kostandin Leli, krahas rrëfimeve të çiltra e të sinqerta të tregimeve për fëmijë, por edhe atë tufëz shkrimesh në fushën e mendimit kritik, janë të vlefshme e dëshmi të rrugëtimit të letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj në një periudhë kohore, të stadiit të zhvillimit të saj, të arritjeve dhe mangësive të saj. Një dokumentacion i tillë është i domosdoshëm të njihet, të vlerësohet dhe t'u referohesh; sepse e gjithë kjo arkivë është një ndihmesë e vyer për një rishkrim më të mirë e më të plotë të librit të Historisë së Letërsisë shqipe për fëmijë e të rinj.

Met Dervishi: "Korridoret e Sfinksit"

EKZOTERIZMI I BANALITETIT

Historia përsëritet dy herë; herën e parë shfaqet tragjikisht, herën e dytë si farsë. (K Marx)

(Hamdi) Erjon MUÇA

Me emrin Met Dervishi isha përballur disa herë dhe në të gjitha rastet, kisha ndjesinë e personazhit; disa e përmendnin me një respekt gati ekzotrik, ndërsa të tjerë me një distancë indiferente, por të një indiference të imponuar. Nuk e di a e keni parasysh se çdo të thotë kur indiferenca është e natyrshme? Do të thotë që diçka ekziston, por që ty nuk të bën as ftohtë dhe as ngrohtë, ndërsa kur ajo është e imponuar, nga inkonsho apo jo, do të thotë që një lloj tutje sundon ndjesitë e tua nga ky objekt apo personazh. E kështu, me këtë kërshëri vendosa të lidhesha me Met Dervishin. U ulëm te bar Sofia, në bulevardin e tregtarëve në Durrës. Për aq pak sa folëm, nuk arrita të njihesha mirë me Metin; në fakt është megalomane të pretendosh të njohësh dikë plotësisht, njeriu nganjëherë duhet të mjaftohet me impresionet. Meti më dha ndjesinë e ekscentrikut dhe kjo më pëlqeu; një njeri të cilën asgjë dhe askush nuk mund ta fusë brenda një strukture, sistemi apo vathe. Mund të jetojë nën një sistem, strukturë apo vathë, por kuptohet që nuk është pjesë integrale e saj. Koha e pushimeve përfundoi dhe u largove me një ndjenjë disfate, ndonëse të lehtë, brenda meje. Nuk kisha arritur të gjeja asnjë libër të Met Dervishit. Jo për gjë, por si ekscentrik, në kundërshtim me një personazh të Dashnor Kokonozit, nuk më dhuroi as edhe një libër. Nga ana tjetër, as unë nuk i dhurova ndonjë libër timin. Ditët e mia rimorën tonet e rutinës dhe ndjesia e disfatës thujse u zhduk. Mirëpo këtë vit kisha programuar të ndryshoja mobiljen e bibliotekës; ajo e vjetra nuk po arrinte të m'i mbante të gjithë librat. Biblioteka ime ka një ngërc; deri para pesë vitësh, përpara se të ndërrohte jetë im at, ishte e ndarë në tre pjesë; një pjesë në shtëpinë time, një tjetër në shtëpinë e tim eti po këtu në Itali, dhe një tjetër pjesë, kjo pak më e vogël, ngaqë herë pas here unë marr libra me vete kur kthehem nga pushimet, në shtëpinë në Durrës. Tani biblioteka është e ndarë në dy pjesë dhe kjo më bëri që të blej një mobilje më të madhe. Mobilja u montua dhe unë bashkë me vajzën nisëm të vendosnim librat; duke i ndarë në poezi, prozë, filozofi; autorët të ndarë sipas kombësisë dhe ja surpriza - "Korridoret e Sfinksit". Ndjeja një lloj disfate, ngaqë nuk kisha arritur të gjeja një libër të Met Dervishit dhe kjo ndjenjë kthehej në habi. Met Dervishi kishte vite që ndodhej në bibliotekën time, por pa dijeninë time. Korridoret e Sfinksit ishte aty mes të tjerëve, ndoshta i fshehur, duke pritur çastin e duhur për t'u shfaqur para meje; jo për të gjithë librat jemi të përgatitur në çdo kohë, ka libra që duan kohën e vet dhe gjendjen shpirtërore të duhur.

Ndokush edhe mund të ndihet i lodhur nga kjo premisë, mirëpo kjo është një nga mënyrat e panumërta për të shkruar mbi një libër. Madje, ndokush mund edhe të mos e gjejë me vend shprehje e Marx-it në hyrje, mirëpo nëse



lexoni "Korridoret e Sfinksit", kuptoni se kjo shprehje duhet të hyrje.

Korridoret e Sfinksit, nuk është libër i thjeshtë (tani ka dalë moda e të thënit se ai është libër i një letërsie tjetër lloj, shprehje të cilën unë nuk arrij ta kuptoj plotësisht, kjo ndoshta për mangësi timen ose ndoshta për mangësi të togfjalëshit), madje është tejet e koklavitur ndonëse nuk është voluminoz. Ajo ndjesia e ekscentrizmit që kisha për autorin, m'u pasqyrua tek libri. Jo vetëm për nga mënyra e rrëfimit, por edhe se si ky libër është ndarë, të jep ndjesinë e ekscentrikes, vetëm se kësaj here ajo të asaj psikologjike, por të fizikes; mundohuni të imagjinoni dy apo më shumë rrrathë, futur brenda njeri- tjetrit, por jo rreth një qendre. E pikërisht me këtë formë të imagjinuar lidhet ajo shprehja e Karl Marx-it, që libri i Met Dervishit më bëri ta kujtoj dhe ta analizoj, por jo në një kontekst global. "Korridoret e sfinksit" është ambientuar në periudhën e para post-diktaturës dhe para fillimit të demokracisë; i vendosur në vlerën zero, por pa dalë ende mirë nga vlera minus dhe me vështrimin te vlera plus. Kjo është sa tragjike aq edhe komike; subjekti nuk e percepton

rëndësinë e këtij intervali, ndihet si i lidhur ende në minus, por me një ngutje për t'u hedhur në plus. Më e keqja është, se përpos të gjithë fiksonit narrativ, kjo ndodhi realisht dhe nga kjo përvijon ai shoku termik, të cilin e pësoi shoqëria jonë.

Nga ky imazh rrjedh edhe paradoksi shqiptar i shprehjes së Marx-it. Nëse globalisht, historia, në fillim shfaqet tragjikisht, në Shqipëri ajo shfaqet në mënyrë tragjike-komike. Këtë tragjikomedi të realitetit e ndjemë fuqishëm brenda romanit; ai nis me psikozën e komplotit, duke u mbyllur me apoteozën e banalitetit. Fatkeqësisht, ky nuk është ekskluzivisht subjekti i romanit, kjo është rezymeja reale e thujse gjysmës së dytë të shekullit XX në Shqipëri. Në roman autori na paraqet korridore të pafund të një ndërtese fktive në formën e një sfinksit dhe dhoma pa numër, të njëjta. Ndërsa mua nuk e di se përse ato korridore më kujtuan vendstrehimet poshtë dhe mes pallateve dhe dhomat e njëjta, bunkerët e mbjellë anekënd vendit. Vendstrehimet dhe bunkerët, struktura të një psikoze komploti global, të madh, shumë të madh, që nga fundi u kthehen

në struktura të shkarkimeve fiziologjike njerëzore, të të gjitha llojeve. Ja pra se si psikoza e komplotit e komplotit përfundon në apoteozën e të rëndomtës. Personazhi i romanit ka dëshirë të ethshme për të zbuluar atë gjuhën ezoterike nga e cila thuhet se rrethohet, madje dhe është i përbërë sfinksit, por nuk e gjen. Ajo që zbulon është tejet banale, ose siç thonë italianët, "ovvia", që është edhe më tallëse se banale. Personazhi e kërkon me përdhunë këtë gjuhë (dosje) që në të ardhmen kjo tragjedi të mos ripërsëritet më, dhe këtu gabon në vlerësim; nuk kishim të bënim me një tragjedi të mirëfilltë, por me një tragjikomedi.

Sfinksit shembet, personazhi ka dalë jashtë tij, gjuhë ezoterike nuk gjeti, nuk kishte, nata përfundoi dhe agu po zbardh. Këtu përfundon shfaqja, por personazhi nuk e di (ndoshta e ndjen) që një tjetër shfaqje, një tjetër inskenim po përgatitet dhe ky personazh do të jetë sërish në skenë, me një tjetër veshje, një tjetër skenar, mbi një skenë të vjetër rinovuar disi. Nga tragjikomedia, do të hidhet në komediotragjedi. Ku qëndron ndryshimi mes të parës dhe të dytës? Në të parën, në tragjikomedi ke dëshirë, nevojë, por nuk ke mundësi, të detyrojnë, të tjerët, të bësh të kundërtën; ke dëshirë të qashë, por nuk ke mundësi për të qarë, je i detyruar të qeshësh dhe anasjelltas. Ndërsa tek e dyta ke mundësi, por të mungon dëshira, detyron veten të bësh të kundërtën; ke mundësi të qeshësh, por nga padëshira për të qeshur, qan.

Nëse globalisht është salla, spektatori, nën trysninë e shfaqjes (që qesh apo qan, që detyrohet të qeshë ngaqë nuk mund të qajë) në Shqipëri, spektatori qëndron indiferent ndaj asaj që ndodh në skenë dhe për pasojë e gjithë ngarkesa emocionale shkarkohet mbi personazhin. Kjo ishte dikur dhe vijon të jetë; është personazhi i djeshëm, i ndjekur hap pas hapi nga vështrimi i spiunëve, që sot ndiqet nga patronazhistët; apoteoza e komplotit më banal. "Korridoret e Sfinksit" mund edhe të klasifikohet si një subjekt me simbioza të "Pallatit të ëndrrave" apo të "1984". Por ,nuk është si "Pallati i ëndrrave"; nuk ka poetikën klasike dhe nuk kërkon të jetë poetikisht i lidhur pas fiksonit të një komplotizmi imtësisht e studiuar, jo për gjë, por realiteti nga i cili ka lindur nuk kishte lidhje as me poetikën dhe as me studimet e imtësishtme. Nuk është as si "1984"; romani i Orwell është ambientuar në mes të tragjedisë, ndërsa "Korridoret e Sfinksit" në fund të tragjikomedisë. Për nga rrjedha historike e kombit të vet, Orwell zotëron thelbin e tragjedisë, ndërsa Met Dervishi nuk mund të shkruajë përpos se tragjikomikisht. Kjo është e natyrshmeja e tij, ndoshta edhe e jona. Vetëm se krijues si Met Dervishi e kanë pranuar këtë realitet dhe nuk e kanë frikë, ndërsa të tjerë, kanë akoma një luftë të dhunshme në inkonsho. Të tjerët janë ende në kërkim të ekzotikes, qoftë edhe në banalitet.

Shqyrtime

PARALELE KRIJUESE MES HAJRIH HAJNE DHE ALI ASLLANIT

(Mbi poezitë "Zonja Lu" dhe "Një femër")

Majlinda Nana RAMA

Si një pasuri letrare, në lëndinën e erotikës, vijnë si afeksion vargje të cilat, në shumë raste, kanë ngarkesa humorit e konotacion satirik. Por tharmi dhe forma krijuese, stili i mrekullueshëm, ritmi tërheqës dhe, më së shumti, ideja që ato përcjellin, i klasifikojnë ndër më universale. Tematika, si performancë artistike dhe shenjimi njerëzor, formon një shtrat estetiko-letrar që nuk ka se si të mbetet jashtë vëmendjes së çdo lexuesi. Dhe, kësaj, ato bëhen frymëzime, edhe pse janë vargje të shkruara në kohë, botë e rrethana të ndryshme. Ndalea ime shqyrtimore e radhës, do të ishin këto vargje, të shkëputura nga poezia "Zonja Lu" e Ali Asllanit:

*Sa të thahet varr' i burrit,
doemos do rrijë e ve,
meqë varri është i freskët,
është i njomë e është i ri,
që të thahet shpejt e shpejt,
Zonja Lu i bën veri!*

Ali Asllani, njëri ndër personalitetet më të shquara të poezisë shqiptare, sidomos në vitet pas periudhës së Pavarësisë e në kohët e më vona, do të shquhej për origjinalitetin dhe autenticitetin e zërit të vet. Si një poeti veçantë, ai do të mbante lidhje të pandashme me gurrën popullore, këngët, vargjet e të cilave u bënë ndër futje fine mes vargjeve të tij, duke nxjerrë produksione poetike, me një muzikalitet të veçantë. "Zonja Lu" është njëra nga poezitë nektar të tij, e cila ka brenda saj një një korpus të gjerë ngjyrash, nuncash e deri diku edhe kulturash, nëse do t'i referohemi botëkuptimit. Në të, sillen së bashku: aspirata si shpresë, morali, zakonet, traditat, besimet, të gjitha të shprehura në formën më të mrekullueshme e më të bukur.

Ali Asllani i sjell këto vargje, me një staturë sa erotike e filozofike, aq edhe morale. Ai nuk paraqet vetëm një anë të jetës, por sjell po aq bukur pritje-përcjelljet, bashkëjetesën martesore si institucion (apo dhe konvencion), e depërton deri të gjendja psikologjike e personazheve kaq njerëzore, me ndjenja të thjeshta, si agim. E, natyrisht, influenca të tilla krijuese, përbëjnë rezultatën natyrore të një ndjenje po të natyrshme brenda një rrëfimi të rrjedhshëm. Por, përveç Ali Asllanit, të njëjtën bukuri të dhimbshme ka sjellë edhe pena e poetit gjerman Hajrih Hajne, me poezinë e tij "Një femër".

*Në orën gjashtë ai u var.
Në orën shtatë e kallën në varr.
Në orën tetë, ajo që e deshte,
pinte verë të kuqe dhe qeshte.*

Hajne, i lindur në vitin 1797, u nda nga jeta më 1856. Ai është një ndër poetët më të rëndësishëm gjermanë



dhe kësaj veprat e tij kanë gjetur një pritje të ngrohtë në shumë popuj të botës. Hajne është shquar si një ndër lirikët e mëdhenj të dashurisë. "Libri i këngëve" (1827), bëri që, për këtë poet, të hapeshin shtigje të reja inkorporuese me botën në tërësi. Ai ka sjellë modele interesante të krijimit, me poezi të gdhendura në memorien letrare, siç janë poezitë "Një femër" apo dhe "Lorelaja".

Megjithëse dy trajtesa krejtësisht të ndryshme, poezitë e Asllanit dhe Hajnes kanë një shtresëzim bazik të përbashkët a të ngjashëm. Ajo, femra, përgjohet për dashurinë e përjetshme, qan për vragat që ikja do t'i lërë në lëkurën e fatit të saj, por, në fakt, nga të dy autorët, na sillen një realitet tjetër, larg nga ai i historive me Romeozhulietët shekspirianë. Këto vargje të shkëputura nga dy poezitë e sipërcituara, vijnë mbi fytyrën e një modeli ligjërimit që rrallë haset në letërsi. Gjithsesi, përballë përluljes që u bëhet këtyre vargjeve si dëshmi artistike e letrare, problemi qëndron në faktin nëse duhen paragjykuar këto dy figura femrash, që vijnë nga soje të ndryshme e që përjetojnë ndjesi të reja, duke dalë mbi dramën e tyre. Në tërësi, në letërsi apo dhe jetën e përditshme, femrat përsillen koketa, të ëmbla, të zjarrta, mbushur plot me dëshira rinore e të ardhura në botën njerëzore

duke na bërë të qeshim, të qajmë, t'i përsërisim e t'u kthehemi sërish për t'u gjetur çelësin e për të rrokur kuptimin e tyre. Vallë, a do të zgjaste vërtetë kaq pak dhimbja e humbjes? Vallë, do të shuheshin kaq shpejt instinktet e ndjenjës? Po çfarë është dashuria, tek e fundit? A ka një fytyrë të sajën ajo dhe a lidhet me emrin si një dashuri e përjetshme apo...?

Gjithë këto pyetje retorike i shpërthejnë në kokë lexuesit, i cili e gjen veten mes dilemash, padyshim... A kemi një mesazh që duhet të nxjerrim nga këto vargje? Edhe pse këto poezi janë shkruar në dy realitete të ndryshme, nga dy autorë krejt të ndryshëm, mes tyre ka një lidhje kaq të ngushtë, gati-gati simetrike për nga ngarkesa emocionale. Në kontekst të kulturës, si art i shkruar, këto vargje befasojnë, ngjallin shqisa të reja për të nuhatur përtej, për të parë në thellësi të ngjarjeve, por edhe për të depërtuar në filozofinë e njeriut (femrës) si qenie e gjallë. Prandaj, ajo që duhet vënë në pah, është fakti që këta poetë i kapërcejnë mendimet stereotipe e herë-herë të ngjashme mes tyre, ku personazhet janë besnikë, të ndershëm e, në këtë mënyrë, propagandohet njeriu korrekt e i arsyeshëm. Asllani dhe Hajne përthejnë trajektoren e së zakonshmes në një rrafsh të ri, duke u kthyer në simbole, duke u socializuar e duke arritur konvenca të reja të modelit të një logjike të freskët, përballë asaj që quhet përbesim i përjetshëm dashuror dhe asaj që mbetet në anën tjetër...

Hajne, si parashenj, jep jetën, botën e mendjen e hapur të të rinjve që vijnë nga shtresa të ndryshme, nëse do të shprehemi kështu (Çapënia dhe Kusari), por që dashurojnë me të njëjtën gjuhë. Kjo mënyrë të funksionuarit, i jep poezisë së tij një definim më të besuar. Por, edhe këtu, ka një tjetër paradoks njerëzor, nëse e veja e poetit, tek Ali Asllani, qan e masakrohet nga dhimbja: "Ç'më gjet mua, ç'më gjet mua/ ulurin e zeza grua/ u plagos, u shkatërrua/ u plagos e u gjakos/ me biçakun e fildishtë/ fije-fije bëri flokët/ copë-copë i bëri mishtë", dhe e bën zemrën gur, pret dy ditë për t'iu turrur varrit ta terë, mikja e kusarit të Hajnes, nuk pret kurrsesi as me vite, as me muaj, as me ditë, as me orë. Ajo as nuk qan, nuk dëshpërohet. Kronologjia e saj e dhimbjes, lind dhe mbyllet sapo përfundojnë procedurat e varrimit:

ai varet në orën gjashtë, ndërsa "... në orën tetë, ajo që e deshte,/ pinte verë të kuqe dhe qeshte". Merita dhe mjeshtëria e gjermanit Hajne qëndron te komunikimi i brendshëm i krijimit, duke servitur "Një femër", si një kryepoezi në suazën botërore poetike. Ai hulumton depërtueshëm në çdo varg. Poezia e tij ka të artë fjalën si interlidhje dhe kuptimin si interkomunikim. Nga ana tjetër, duke e vënë në kontekst të kohës, vargjet e Ali Asllanit tingëllojnë tepër emancipuese, çka, përveç vargëzimit të dëlirtë, sjellin

domethënie semantike në shkencën e poezisë dhe rolin social të autorit. Megjithë interpretimet, me apo pa paragjykim të "heroinave", këto dy poezi mbeten majat e klasifikimit, me dritë dhe vezullim gjithëkohor, të brishta si qershizat e shumëpjekura, kokëforte si ndërrimi i stinëve, të hajthme si shtat femre... Ato rrëfejnë pasuri krijuese me spunto të një bote me kulturologji të gjerë. Më poshtë po japim të plota dy poezitë:

Hajrih Hajne

NJË FEMËR

Ata u deshën me afsh e zjarr,
ajo çapkëne, ai kusar,
kur ai ndonjë mufke ia veshte,
ajo kërcente në shtrat dhe qeshte.

Ditëshkonin për bukuri,
natën ajo flinte mbi gjoksin e tij,
kur e futën në burg atë, ajo s'reshte
në dritare qëndronte dhe qeshte.

Ai i fliste: "O, eja këtu
se më merr malli kaq fort për ty!
Ty të thërres se do vdes!", i theshte,
ajo tundte kokën dhe qeshte.

Në orën gjashtë ai u var.
Në orën shtatë e kallën në varr.
Në orën tetë, ajo që e deshte,
pinte verë të kuqe dhe qeshte.

Ali Asllani

ZONJA LU

Një ditë dola për shëtitje,
afër udhës në varreza
pashë një zonjë me shumë habitje
veshur krejt me rrob' të bardhë,
duke i bërë veri një varri,
që ti bësh veri një varri
është punë e një të marri.
Iu afrova... një flori
mrekulli, një bukuri...
Dor' e saja vinte vinte
bën veri e bën veri!

E un' tepër i çuditur
i them zonjës të më falë



dhe si gjysmë ngushëllimi,
pëshpërta dy-tre fjalë
dhe iu luta të më thoshte,
i kujt është ky varr i ri,
varr i freskët e i njomë...
E përse i bën veri?
Zonja kuqet e stërkuqet
bën të e thotë e nuk më thotë.
Nuk më thotë asnjë përgjigje.
Lutja ime vajti kot.

Rrobë e bardhë që kish veshur
më tregoi se mbante zi.
Sado heshti buzë e kuqe,
foli syri saj i zi!
Lëm të lutem... dhe vazhdoi
përsëri e përsëri...
Dorë e saj s'kish të lodhur
bën veri e bën veri...

Nuk më ikej nga merakun,
po kur shoh se aty afër
po ma bën me dorë një grua.
Ajo ish një plakë e varfër
e më thotë eja e di unë.
Të rrëfej se ç'janë ata,
atë varr e atë grua
në më jep disa para!

Edhe unë more zotëri
me këto paratë e tua
shkoj e blej një nuskë nga prifti
të më zgjatet jeta mua,
se në vendin ton' të dashur
me fuqirin e florinjve
edhe jeta blihet shitet,
rroftë magji e priftërinjve!

Tash ajo që pyesni ju
është zonjë e një poeti
edhe quhet zonja Lu.
Varri është i të shoqit
ish poet i madh i vendit
që peshohej këngë e tija,
me derheme të argjendit!
Burrë e grua mish e thua
çift i ëmbël, çift me shije
çift o çift që ska të dytë
si dy kokrra qershie.

Një ditë burri u sëmur,
dy plevite në një vend,
një sëmundje shumë e rëndë.
Zonja Lu u prish nga mendt'
dhe i thotë burrit të saj:
-Nëse mbyllet sytë e tu,
unë veten do ta vras

dhe bëj be që atë cast,
më ke pranë e më ke pas,
ti ma bëre shtratin tim,
kryefron të dashurisë
dhe unë varrin tënd do ta bëj
shtratin tim të nusërisë.

Jo, të lutem!- i thotë burri,
Shumë të lutem, mos e bëj!
-Mirë, atëherë, unë do mbetem
gjithë jetën një e ve!
Jo, të lutem, Luja ime,
mos e bëj dhe këtë be!
-Si pra unë të duroj,
në më zëntë kjo rrebe?
Pra, të paktën do të mbyllem
dhe do rreshkem disa vjet.
-Jo, të lutem Luja ime,
është e shkurtër jetë e shkretë.
Vetëm prit e ki durim
sa të thahet varri im!

Tash poeti ra e fjeti,
ra e fjet' për mot e jetë.
Gjëmë e madhe që e gjeti,
Zonja Lu thërret, bërtet.
Me oi e me oi,
për atë që bëhej fli,
një minutë e dy vili!
"Ç'më gjet mua, ç'më gjet mua!"
-ulërin e zeza grua.
U plagos, u shkatërrua,
u plagos e u gjakos,
me biçakun e fildishtë,
fije-fije bëri flokët,
copë- copë i bëri mishtë.

Pas dy ditëve vjen një djalë,
një djalosh një bukurosh,
e i thotë zonjës Lu:
"Ti shëndoshë e unë shëndoshë,
ti e unë një çift i ëmbël
çift i bukur, çift me shije
çift, o çift që s'ka të dytë,
si dy kokrra qershie".

Mirëpo zonja është besnike,
ka dhënë fjalën ka bërë be,
sa të thahet varri burrit,
doemos do rrijë e ve.
Meqë varri është i freskët
është i njomë e është i ri,
që të thahet shpejt e shpejt
Zonja Lu i bën veri!

Në shiritin e kohës

NOBELISTI ABSURD, SAMUEL BEKET

Më 1969 e lajmëruan se i kishin akorduar çmimin "Nobel" por ai nuk shkoi ta merrte. Fjalëpakë siç ishte, thjeshtësisht ar-riti të thotë: "Është një katastrofë"

Luan RAMA


Ndryshe nga shumë anglosaksonë që e bënë Parisin dhe Francën si një atdhe të tyre, Samuel Beket erdhi më shumë për të shpëtuar nga jeta monotone në familjen e tij në Dublin ku nëna dhe ati i tij ziheshin pareshtur dhe kjo i krijonte një gjendje të padurueshme. Dhe ai u largua nga ta. Atëherë, vendi më i parapëlqyer ishte Franca, Parisi me jetën libertine dhe komunitetin e madh anglosakson që jetonte tashmë që në fillim të shekullit. Dhe meqë ishte letrar nuk kishte vend më të mirë se Franca për të jetuar dhe krijuar. Kr erdhi në Paris menjëherë u takua me James Joyce dhe Silvia Beach në librarinë e saj "Shakespeare and Company", duke frekuentuar njëkohësisht rrethet letrare parisiane me një potpuri stileshe, shkollash, rrymash dhe individualitete nga me origjinalet. Atë kohë adhuronte Dante, Proust, Descartes... Në fillim do të jepte

gjuhën angleze si lektor në "Ecole Normale Supérieure". Më pas ai u kthye në Dublin dhe përsëri, disa vite më vonë, mori rrugën drejt Parisit, të cilin s'do ta braktiste më, duke u vendosur fillimisht në "Hôtel Liberia", në Rue Grande Chamière në Montparnasse. Ishte koha e shkrimeve të para kur i entuziazmuar nga Joyce, ai hyri në botën letrare. Eseja e parë që shkroi ishte "Dante... Bruno. Vico... Joyce". Në vitin 1938 ai u njoh me një amerikane të pasur, Peggy Guggenheim, e cila kishte një galeri arti në Londër dhe vinte shpesh në Paris. Në autobiografinë e saj "Out of This Centery" ajo shkruan për irlandezin Beket. "Ishte një irlandez thatim, rreth të tridhjetave, me sy jeshil që nuk të shikonin asnjëherë kur flisje. Kishte syze të errëta dhe dukej i zënë me diçka tjetër. Fliste pak, por gjithnjë gjëra me vend. Ishte mjaft i sjellshëm, por shumë i majtë në mendimet e tij. Vishej keq dhe me rroba të

vjetra franceze, duke mos pasur ndonjë ngasje fizike. Një shkrimtar i frustruar dhe një intelektual i vërtetë..." Në një darkë me një grup miqsh ata po pinin në vila "Scheffer". Kur kishin dalë ai i kishte thënë asaj ta përcillte deri në apartamentin e saj në Rue de Lille, ku ishte vendosur ato ditë. "Ne ngjitem shkallët. Ai nuk i tregonte qëllimet e tij, por papritmas më tha të shtrihesha pranë tij, mbi sofa... Por nuk vonuam që të gjendeshim të dy në shtrat ku qëndruam deri natën e ditës tjetër." Asaj i kujtohej se Beket i kishte thënë se shkrimtari më i mirë i letërsisë franceze ishte autori i librit "Udhëtim gjer në fund të natës" dhe kjo e kishte habitur atë. Ishte njeri me humor dhe Peggy-n kjo e kënaqte së tepërmi. "Ajo që më pëlqente më shumë në jetën tonë të përbashkët, ishte se nuk e dija asnjëherë se kur vinte dhe kur ikte, ditën apo natën. Ishte një njeri i paparashikueshëm dhe kjo gjë më eksitonte. Madje shpesh

vinte i dehur. Në atë kohë isha e zënë shumë me punët e mia të galerisë. Shpesh duhej të takohesha me Cocteau, me ekspozitën e të cilit do të inauguroja galerinë time në Londër. Oblomovit, siç e thërrisja atë, nuk i vinte mirë: ai donte të rrija në shtrat me të..." Në atë kohë Beket qëndronte në hotel "Duncan". Një natë, duke u kthyer me një çift miqsh në avenynë "Orleans", një proksenet prostitutash i quajtur Prudent i doli përpara dhe i kërkoi para. Beket menjëherë kishte bërë se nuk e kishte parë, por tjetri i ishte vënë pas. Pas pak ai e kapi për krahu dhe i propozoi që të shkonte me prostitutën që kishte në krah dhe t'i jepte para. Por, Beket kërkoi të largohej ndërkohë që ai iu afrua dhe e qëllloi me thikë në kraharor. Sigurisht; menjëherë e gjend në spitalin "Hôtel Broussais", ku dikur qëndronte poeti Verlaine, për të mjekuar plagën e thellë. Pikërisht një ditë atje i shfaqet një vajzë e quajtur Suzanë, një

grua e gjatë si ai, jo e bukur dhe shtatë vjet më e madhe se ai. Ishte një tip interesant dhe e pafjalë, çka Beketin e bëri për vete. Me të do të jetonte gjithë jetën e tij. Muajt kalonin dhe ndërkohe ai shkruan parathënien e ekspozitës së Cocteau-së në galerinë e Londrës. Në vijim botoi 12 poezi në revistën e njohur të asaj kohe "Les Temps Modernes". Po në këtë kohë më së fundi u vendos në një apartament me qira në Rue des Favorites, vend ku do të qëndrojë për një kohë të gjatë. Një ditë, kur u takua me Peggy-n, i tha më së fundi se kishte njohur një franceze që quhej Suzanë dhe se historia e tyre e përbashkët kishte mbaruar. "Oblomovi më tha se kishte tashmë një të dashur dhe nëse unë kisha ndonjë kundërshtim. Sigurisht që jo, i thashë. Por ajo ishte më tepër si nëna e tij sesa si dashnore. Ishte ajo që i kishte gjetur atë apartament. Por ai nuk ishte i dashuruar pas saj. Suzana nuk i bënte skena si puna ime dhe unë s'kisha qenë xheloz. Nuk ishte e bukur. Kishte pothuaj të njëjtën moshë si unë, pra që të dyja më të moshuara se Oblomovi." Ishte koha kur bashkë me Suzanën ai u vendos në një apartament të vogël, në katin e shtatë, në 6 Rue des Favorites, ku në një nga dhomat ai kishte vendosur makinën e shkrimit dhe shkruante, përkthente. Pikërisht këtu do të shkruante dhe romanin "Molloy" apo "Molloy vdes"... Pas një vizite në Dublin, ku duhej të shikonte nënën e tij, ai u kthye shpejt në Paris. Miku i tij Marcel Duchamp me të cilin sapo ishte njohur kërkoi të ikte nga Parisi. Lufta po afrohej. Ndërkohë në dhomën e tij ai përkthente romanin "Murphy" në frëngjisht. Ndërkohë Xhois u kthye në Paris dhe u vendos në "Hotel Lutece". Ishte i sëmurë me ulcerë dhe atij i vinte shumë keq për mikun e tij të vjetër. Madje e ndihmoi, por shpirti i Xhoisit ishte i plagosur me historinë e tij familjare dhe vajzën e tij të çmendur. Në 9 qershor, në Francë filloi episodi i madh i njerëzve që zbriste nga veriu drejt Parisit dhe ushtria gjermane kapërcen kufirin duke marshuar drejt kryeqytetit francez. Të gjithë zbrisnin drejt Vishisë. Po kështu dhe Xhois. Bashkë me Suzanë Deshëvo (Suzanne Deschevaux-Dumesnil) ata menduan të largohen menjëherë nga Parisi dhe pa zhuurmë zbritën drejt jugut, Tuluzës, prej nga ku donin të iknin drejt Portugalisë dhe që andej për në Angli. Por kjo është e pamundur. Askush nuk pranoi t'i merrte me anije. Pikërisht duke qëndruar në atë zonë, një jetë e re filloi për Beketin, duke u përpjekur të lidhej me Rezistencën Franceze. "Nazistët dhe veçanërisht trajtimi i keq ndaj hebrenjve më indinjuan së tepërmi, - do të shkruante Beket për atë kohë, - dhe kështu unë s'mund të rrija me duar të kryqëzuara... I luftova nazistët që e kishin kthyer në



ferr jetën e miqve të mi. Nuk është se luftoja për kombin francez... "Ishte tetori i vitit 1940. Çuditërisht, Beket mendoi se do të ishte më mirë që të ktheheshin në Paris në apartamentin e tyre në Rue des Favorites. Dhe ata u kthyen. Ishte miku i tij francezi Péron që e futi në grupin e Rezistencës. Në atë grup ai u njoh me Zhaninën, vajzën e piktorit Francis Picabia. Fillimisht merret me mbledhjen dhe përkthimin e informacioneve rreth gjermanëve të instaluar në Paris veçanërisht lëvizjen e trenave, në mënyrë që anglezët të mund të bombardonin forcat e Rajhut. Grupi i tyre quhej "Gloria SMH" dhe ai kishte pseudonimet "Sam" apo "Irlanëzi". Në mes të janarit mori vesh vdekjen e mikut të tij të dashur Xhois në Zyrih çka e trishtoi shumë. Jeta në ilegalitet ishte e shumë e rrezikshme, pasi dhe ata që ishin anglezë rrezikonin të arrestoheshin. E vështirë të shkruaje në atë kohë. Në një nga ato ditë, në shtëpinë e tyre ia mbërriti milicia franceze. Lumturisht ai nuk ishte aty. Suzana ishte e habitur nga ardhja e tyre e papritur por mbi tavolinë i zuri syri librin e Hitlerit "Mein Kampf", të cilin Beket po e lexonte dhe merrte shënime lidhur me ideologjinë naziste. Në çast ua tregoi, si një dëshmi e simpatisë për ta dhe milicët menduan se s'kishin të bënin me njerëz armiq meqë ata lexonin veprën e famshme të Hitlerit. Kështu ata u larguan. Në fakt dikush nga rrjeti i Rezistencës kishte spiunuar, pasi shefi i grupit Alfred Péron, të cilin ai e kishte njohur që student në "Trinity College" në Dublin ishte arrestuar nga Gestapo dhe më pas do dërgohej në kampet e shfarosjes në Gjermani. Ata s'do ta shihnin më mikun e tyre. Pak orë më vonë, Beket dhe Suzana vendosën të largohen menjëherë pa ardhur Gestapo tashmë. Dhe vërtet, pas ikjes se tyre Gestapo ia mbërriti ti kërkoi, por tashmë ata e kishin lënë Parisin me pasaporta

fallco. Në fillim ishin strehuar fshehurazi në shtëpinë e shkrimtares Nathalie Sarraute e pastaj kishin nxituar në drejtim të Lyon-Tulon. Gjatë kësaj ikje të jashtëzakonshme jeta e tyre kaloi peripeci të të paimagjinueshme për një letrar si Beket. Duke iu afruar Rousillon, ata udhëtojnë gjithnjë larg rrugëve automobilistike që të mos binin në sy të gjermanëve dhe milicëve francezë. Ecnin me ditë të tëra në pyje, flinin aty gjatë natës, ndërkohe që Beket kishte probleme me këmbët. Dimri ishte i ashpër dhe shpesh kishte ngrica. Pikërisht atje Beket u lidh me grupin lokal të Rezistencës Franceze. I izoluar në një fshat në jugun e Francës, në "Rousillon dans les Vaucluse", në një lloj ferme ku jo rrallë vinin ushtarë të Wermahitit, Beket merrej me bujqësi, mbillte zarzavate dhe ndërkohe vazhonte të shkruante librat e tij, siç ishte romani "Watt". Megjithatë duhet të përballojë probleme të shumta shëndetësore dhe së pari ato psikike. Gjendja e tij sa vinte dhe rëndohej. Dhe kjo sëmundje e tmerrshme që mudohej ta zotëronte do të ishte për të një lëngatë e gjatë. Në fundin e luftës, ushtria gjermane la jugun e Francës dhe bashkë me Suzanën, më së fundi ai u nis drejt Parisit. Parisi kishte kohë që ishte çliruar. Banorët e dikurshëm riktheheshin në apartamentin e tyre në Rue des Favorites. Një epokë e re fillon për Beket dhe letërsinë e tij. Për kontributin e tij në Rezistencën franceze, ai u dekorua me "Kryqin e Luftës" (Croix de Guerre) me shënimin si "Njeri me kurajo te madhe që gjatë dy viteve provoi aftësi në rrjetin e rezistencës, ku i denoncuar nga gjermanët u detyrua të jetojë me vështirësi të mëdha në klandestinitet duke filluar nga viti 1943". Në vitet e para të pasluftës ai filloi të jepte mësim në gjuhën angleze që të mund të jetonte dhe shërbeu së pari si interpret në veri të Francës në Saint-Lô e më

pas në Paris. Madje vuri dhe kandidaturën për të punuar në departamentet e Unesco-s por kandidatura e tij nuk u pranua. Ndërkohë shkruan novela dhe tekste të tjera. Meqë kishte njohur Sartrin që në vitin 1924, ai i dërgoi shkrime për revistën që drejtonte "Les Temps Modernes" Ditën flinte, natën shkruante dhe të ardhurat e tyre ishin gjithnjë të pakta. Ishte Suzana që e mbante me të holla. Në këtë kohë shkruante romanin "Mercier dhe Camier" si dhe "Molloy" i frymëzuar nga jeta e tij personale. Në 9 tetor të vitit 1948 nis të shkruajë "Duke pritur Godonë", që e mbaroi pas katër muajsh, në 29 janar të vitit 1949. Kur mbaroi "Duke pritur Godonë", askush nuk donte ta botonte. Shumë shtëpi botuese nuk tregonin interes për të. Kjo gjë, Beketin e trishtonte shumë. Megjithatë, Suzana i jepte gjithnjë kurajo. Ishte ajo që këmbënguli që drama së pari të vihej në skenë, çka do të tërhiqte dhe botuesit. Kështu, me dorëshkrimin e tij në dorë, Suzana shkante takonte regjisorë të ndryshëm dhe drejtorë teatrorsh duke u propozuar dramën e Beketit. Madje dhe Beket u detyrua të shkante në Irlandë që t'ua propozonte teatrotro të ndryshme por dy teatro që kishte kontaktuar e refuzuan kërkesën e tij. Edhe botuesit anglezë refuzuan të botojnë dhe romanin "Watt", çka Beketin po e dëshpëronte shumë. Ishte një kalvar i gjatë deri sa më në fund, regjisor Roger Blin, i cili atë kohë po vinte në skenë pjesën "Eleutheria", pranoi të angazhohej me këtë dramë e cila iu duk moderne por dhe e veçantë për një publik si ai i Parisit. Vallë do të kishte sukses? Sidoqoftë dhe nga ana e Blin ishte një ndërmarrje e guximshme. Sidoqoftë, Beket nuk e kishte menduar se "Duke pritur Godonë" do t'i hapte rrugët për të gjitha botimet e mëpasme, pasi ajo veprë e absurdit, me personazhet si Vladimir dhe Estragon që më kot, presin Godonë e mistershëm në një vend të shkretuar e pa njerëz, u bë pjesa teatrale më e interpretuar në botë dhe në gjuhë të shumta. Në ato kohë ai kishte rregulluar një shtëpi të vogël larg Parisit në peizazhet e blerta të Ussy, ku qëndronte shpesh dhe shkroi veprat e mëpasme të cilat do të hynin në historinë e letërsisë botërore. Më 1969 e lajmëruan se i kishin akorduar çmimin "Nobel" por ai nuk shkoi ta merrte. Fjalëpakë siç ishte, thjeshtësisht arriti të thotë: "Është një katastrofë". Të gjithë u habitën atëherë me shprehjen e tij. Ishte koha që irlandezi filloi të pinte edhe pse në publik ishte gjithnjë i rezervuar, i ftohtë, por me një mirësi e mirësjellje të jashtëzakonshme. Gjer në vdekje, ky letrar i fisëm dhe i lavdishëm mbeti i dashuruar me vendin e frankëve... gjer në varrin e tij të thjeshtë, në Montparnasse, pranë gruas së tij, Suzanës.

Profile: Kahlil GIBRAN

SI SHIPRESA FITON MBI PAMUNDËSINË

Kishte lindur mes varfërisë së plotë në Liban, më 6 janar 1883. Tre gjëra përbënin besimin e tij: dashuria, paqja dhe mirëkuptimi mes njerëzve

Grigor JOVANI

Kur mbërriti në Amerikë, e sistemuan në konviktin provizor të një shkollë të posaçme për emigrantë. Me zor artikulonte disa fjalë anglisht. E thërrisnin "I ndyri", ngaqë fytyra e tij ishte shumë e errët, sikur nuk e

kishte larë kurrë. Veçse ra në sy tek mësuesit e tij për diçka tjetër: panë diçka krejt të veçantë te mënyra si shprehte mendimet e veta te hartimet dhe vizatimet e para, te mendimet që kishte për botën. Më vonë, kur e kishte mësuar mirë gjuhën e vendit ku kishte emigruar, u pa qartë se ky

djalosh kishte një dhunti të madhe, të padiskutueshme, talentin letrar. Edhe ca dhe ky talent do të mrekullonte vendin e çudirave, Amerikën. Do të kapërcente në botën tej, për të mrekulluar edhe planetin.

Ishte vendosur fillimisht, bashkë me

nënë dhe dy motrat më të vogla dhe një vëlla nga martesë e dytë e së ëmës, në South End të Bostonit. U përfshi në jetën e mërgatës së dytë më të madhe të siro-libanezëve në Amerikë. Gjatë betejave të para të mbijetesës në vendin ku u ngulën familjarisht, humbi njërin nga motrat dhe vëllain e vogël, nga

tuberkulozi. Ca më vonë u amëshua dhe e ëma, goditur prej kancerit. Jeta e mësoi djaloshin të shkruante aso kohe: "Prej mundimeve janë ndërtuar shpirtat më të fortë, karakteret më të shumtë janë të përzhitur prej plagëve."

Kishte lindur mes varfërisë së plotë në Liban, më 6 janar 1883. Tre gjëra përbënin besimin e tij: dashuria, paqja dhe mirëkuptimi mes njerëzve. Iu mohuan fillimisht të tria. E shoqëroi kudo emri i tij: Kahlil Gibran, i cili u bë i njohur botërisht kryesisht pas botimit të librit "Profeti". Pas botimit të parë të vitit 1923 do të shiste dhjetëra miliona kopje, duke e bërë poetin e tretë të të gjitha kohërave me shitjet më të mëdha, pas Shekspirit të famshëm dhe Laozit, poetit mitik kinez. U përkthye në 108 gjuhë të botës dhe u himnizua nga personalitete të tilla si John F. Kennedy, Indira Gandhi, Elvis Presley, John Lennon dhe David Bowie.

Ç'e bëri kaq të famshëm këtë libër? Padyshim, sinqeriteti, lufta pa kompromis me hipokrizinë dhe korrupsionin. Errësirës nuk mund t'i pëlqente kjo gjë. Librat e tij u dogjën publikisht në Bejrut, ndërsa kërcënimet me vdekje në Amerikë, prej qarqeve të obskurantizmit, u vunë sistematikisht në rend të ditës.

Ishte i vetmi nga fëmijët e familjes që kishte fatin të merrte edukim të rregullt arsimor. Motrat ishin të ndaluara të shkonin në shkollë - zakonet e Lindjes së Mesme nuk iu ndanë as në Amerikë. Edhe vështirësitë ekonomike luajtën rolin e tyre. Të pashkolla femrat e familjes, por e frymëzuan me vullnetin e tyre, veçanërisht e ëma. Fati e donte që t'i mbetej në jetë vetëm njëra, motra Marianë, e cila iu bë mbështetësja më e madhe. Punoi në një dyqan mode si qëndistare dhe bëri çmos të mos i mungonte gjë vëllait të saj. Por ajo që i ishte ravijëzuar më tepër në shpirtin e tij të vuajtur ishte e ëma. Do



të shkruante për të: "Fjala më e bukur në buzët e njerëzimit është "Nëna" dhe ftesa më e bukur shpirtërore është ajo e sime ëme. Është një fjalë e mbushur plot dashuri dhe shpresë, një fjalë e ëmbël dhe fisnike, që del nga thellësia e shpirtit. Nëna është gjithçka - ngushëllimi ynë gjatë dëshpërimit, shpresa brenda mizerjes, forca jonë përpara dobësisë. Është burimi i dashurisë, i mëshirës, i simpatisë dhe i faljes."

Më 1928-ën shëndeti filloi t'i rëndohej. Iu akumuluan shpejt mundimet dhe

peripeçitë e një jete tejet të vështirë. Mundimet e shpirtit ishte mësuar t'i duronte, ato të trupit jo. Tha se mund t'i fshihte pas alkoolit, ndonëse feja e të parëve ia ndalonte, por kur kishte pyetur ai për këto (!) Edhe në kohën e ndalimit të rreptë të pijeve në Amerikë, iu përkushtua pikërisht atyre.

Nëntorit të atij viti botoi librin tjetër të famshëm, "Jezui, biri i Njeriut". Një vit më vonë e shtroi në krevat sëmundja e mëlçisë, mbase prej përdorimit të tepër të pijes së Djallit - alkoolit. Injoroi krejtësisht ndihmën e mjekëve. Ndoshta e kuptonte që nuk kishte

kthim. U mundua të merrej prapë me letërsi, duke redaktuar krijime të vjetra. Përpjekje të dëshpëruara, që morën fund më 10 prill 1931. Ishte vetëm 48 vjeç.

Është sot një simbol i Amerikës. Se si shpresa fiton mbi pamundësinë, si e mira mposht të keqen. Si triumfon më në fund liria e njeriut. Si e mira mund të pushtojë botën. Jo si utopi, por si realitet i mundshëm.

Tek një poezi kushtuar emigrantëve të rinj, do të shkruajë:

"Mendoj se mund t'u thoni themeluesve të këtij kombi fisnik: Këtu jam! Një riosh. Një pemë e njomë. Rrënjët e së cilës u ç'rrenjosën kodrave të Libanit. Ndërkaq kam rrënjosur thellë këtu. Dhe do jem pemë pjellore..."

Do të shkruante, gjithashtu, tek "Profeti", kryevepra që shëtit dhe mahnitë botën:

"Le të ekzistojnë hapësirat midis jush. Dhe le të vallëzojnë aty erërat e qiejve. Dashuroni njeri-tjetrin, por mos vini pranga dashurie: Le të jetë dashuria një det lëvizës midis brigjeve dhe shpirttrave tuaj. Mbushni filxhanët e njeri-tjetrit, por jo të pini nga i njëjti filxhan. Ndani bukën midis jush, por mos i jepni tjetrit gjithë simiten tuaj. Vallëzoni e këndonni bashkë, gëzoni, por i jepni lirinë vetvetes të jetë vetëm. Edhe kur tingujt e një lahute drithërohen nga e njëjta muzikë. Jepini zemrat tuaja, por jo njeri-tjetrit. Sepse vetëm dora e Jetës mund të nxehtë zemrat tuaja. Dhe qëndroni bashkë, por jo shumë pranë midis jush. Sepse kolonat e kulteve lartohen vaças. Dhe lisi me selvinë nuk rriten në hijen e njeri-tjetrit."

Nuk mund t'i shtoj gjë tjetër kësaj mrekullie, as të bëj komente. I ka thënë të gjitha, me mënyrën e tij hyjnore, "Profeti" vetë. Dhe "profet mbi profetin", siç thotë populli, nuk mund të ketë.

Tregim: Besa KALAJA

MACJA QË NDRYSHOI NGJYRË TË DIELËN

Me duar mbajtur për krevati, u çova. Rakia e mbrëmshme ma kishte marrë tërë energjinë e trupit. Po laja dhëmbët kur koka filloi të më kruhej keq, hyra dhe bëra një dush. Gjatë dushit e krova dhe e krova aq shumë kokën sa po më rridhte gjak. Mu desh që ta laja disa, por në disa fije floku më kishte mbetur e madje edhe tharë gjaku. Me gjasë e kisha kruar fort edhe natën. Nuk e ngacmova më pasi duart po më dridheshin nga inati. Që ta merrja veten me të mirë apo ndoshta edhe që ta ndëshkoja keq, shkova në kuzhinë dhe bëra një kafe të hidhët e të rëndë. Pa qenë fort i vëmendshëm po shikoja nga dritarja një mace që po ngjitej e zbriste në pemë. Aq zhdërvjelltë dhe aq shpejt sa nuk po arrija ta përcillja dot më me sy. Mbërriti një pikë kur nuk e dija më se a ishin lëvizjet e shpejta të maces apo mua po më merreshin mendtë. Zhdërvjelltësia e saj u bë një me marramendjen time. Hapa dritaren dhe i bërtita maces apo asaj që unë para pak çastesh besoja se ishte mace.

-Hej ti, i thashë, mos luaj me mua sepse po të zura do të të mbys me gurë. Nuk u ndal, bile me bëhej se ajo po ngjitej e zbriste edhe më shpejt. Nuk mu durua, mbylla dritaren me vrull, xhami

u thye, po vrapoja drejt derës. Në hyrje të shtëpisë nuk pashë asnjë gur me të cilin do të mund ta gjuaja. Për më keq, ajo u bë edhe më e shpejtë. Nuk ia dalloja më dot as ngjyrën... Sa isha brenda më dukej e bardhë, tani dukej krejt e hintë. Nuk ishte koha të mendoja për ngjyrën e saj, më duhej ta largoja sa më shpejt që të ishte e mundur, sa ende nuk më kishin lënë mendtë.

Shkova te fqinji, trokita fort në derë, ai doli i përgjumur.

-Çfarë ka ndodhur?, më pyeti krejt i shkujdesur. E pashë drejt e në fytyrë, në atë fytyrë që nuk më thoshte asgjë, as e njohur nuk më dukej madje dhe pothuaj u bëra gati ta pyes: po ju kush jeni? Ndoshta edhe do ta kisha bërë, por nuk arrita ta pyes, sepse ai me një shkujdesje të çuditshme më rroku nga krahu dhe më tha që kishte përgatitur kafe dhe sandviç dhe unë pa telashe mund të haja me të. As gruan nuk e kam këtu më tha, duke ma bërë me sy. U shtanga në çast, nuk reagoja, thjesht iu nënshtrova i tëri atij. Më shërbeu kafën në një filxhan të bukur dhe sandviçët më tha që i ka bërë vetëm me perime sepse kohëve të fundit, i ishte tekur që të ushqehet shëndetshëm. Më tha edhe se në frigorifer kishte lloj-



lloj ushqimesh, si p.sh mishra e këso gjërash, që mund t'ua jepte të tjerëve, pasi nuk i hante më. Gjithë ky kujdes tha se i vinte, pasi kohëve të fundit po lexonte artikuj e artikuj mbi shëndetin. Mua sikur po më rrotullohej diçka në bark dhe nuk kisha as nevojën më të vogël që ta dëgjoja, përkundër faktit që nuk më shpëtonte as edhe një detaj pa mu ngulitur në kokë.

Sa fillova ta marr veten dhe të kujtohesha për çka kisha shkuar tek ai, më bëri një pyetje të pavend.

- Ka goxha kohë që ajo më nuk po vjen te ti, pse?

Desha ta pyes cila është ajo, po koka nuk po më punonte.

- Ahaaa ajo. Ka gjetur një vend pune jashtë qytetit, i thashë. Sapo mendova se e nxora veten nga kjo situatë, ai më vuri dorën në krah dhe po më ngushëllonte. Dorën e kishte të fortë, të rëndë dhe me muskuj, mbuluar të tërën me tatuazhe. S'mund të ketë një njeri të

dytë si unë që është mëshiruar nga një dorë kaq e vrazhdë.

Ha! Mos më shiko ashtu, më bërtiti sikur të donte të ma mbushte boshllëkun me sandviç. Nuk mundem i thashë me mundim, shumë gjëra edhe ato më të përditshmet po më ecin ters, më pështjellohen, ja si kjo macja sot. Më pyeti se çfarë kisha me macen, ma bëri me dije edhe se ajo e ka rrugën e saj e unë timen, madje më tha edhe se nuk e kuptonte se ku na bashkoheshin rrugët mua dhe asaj.

Prapë më shkeli syrin kur më tha kap gjeje një grua të bukur, se nuk e paskam vërejtur më parë që ti qenke edhe i hijshëm. Këtë pjesë nuk e kuptova a e tha me shaka, sepse s'më kujtohej kur për herë të fundit isha parë në pasqyrë për bukurinë time. Aty këqyresha vetëm kur frikësohesha se mos flokët më ishin çaraveshur apo kur më dilte ndonjë puçërr në fytyrë dhe nuk mund ta duroja apo edhe atëherë kur pasqyra

qëllonte të ishte varur në ndonjë kënd që nuk mund ta shmangia, por e parakaloja me shpërfillje të plotë. E pashë drejt në sy, po zgërdhihej. Në një situatë të tillë, njeriu nuk mund ta dijë nëse tjetri e ka më të vërtetë apo po bën shaka me ty.

-Ja kështu, i thashë, sa për gruan mbeta, jo sot po nesër, ta shohim si do të shkojë puna me macen, pastaj i vjen radha edhe asaj pune, të premtoj se në baza ditore do të merrem me të.

Fytyra nga e qeshur iu vrenjt menjëherë, aq sa pata frikë prej tij.

-Unë e pata me qëllim të mirë, më tha, nuk kemi nevojë të bëjmë shaka me këto gjëra. Edhe pyetjen që ma kishte bërë pak më parë për atë gruan, më tha se ma kishte bërë shumë seriozisht, pasi ajo i kishte pëlqyer vërtet. Më tregoi edhe një gjë që mua nuk më pëlqeu aspak, për herë të parë mu duk se u bëra i vetëdijshëm për bukurinë e gruas që vinte te unë të shtunave

mbrëma. Ai ma tha se e dinte orën e saktë dhe ditën kur ajo vinte dhe se asnjëherë nuk e humbi shansin që ta përcillte nga dritarja.

-Edhe dje ishte e shtunë. Prita në dritare, por ajo nuk erdhi. E lëshoi kokën në krahun tim, ma përkujtoi se nëse ndihesha keq mund të shkoja tek ai dhe se vetëm ai e dinte se çfarë mund të përjetonte një burrë kur humbet të shtunat e papërsëritshme. U mundova ta largoja nga vetja duke i thënë se unë nuk ndihesha keq dhe se ishte ai që tani ma përkujtoi që tek unë çdo të shtunë mbrëma vinte një grua.

E pyeta se mos kishte gurë në oborrin e tij. Qeshi si i marrë. Më pyeti për çfarë më duhen. I thashë se doja të trembja macen që po endej në pemë.

Pema ra në tokë, pas aq shumë herësh që i kisha rënë me sëpatë. Macja m'i nguli thonjtë në fytyrë.

Poezi: Armenida Qyqja

PSALM I NETËVE TË MIA

Në terrin e natës llamburin një mendim,
Sa herë e trembur, hap sytë,
Të përgjumura, të thërrasin ty buzët,
Si një psalm, sërish e sërish...

Shkëndijat ndezin ajrin e fjetur,
Emrin tënd, e bëjnë qiri,
Nën flakën e kujtesës, sytë e etur,
Pranë vetes të shohin, përsëri...

Është ora dy dhe e di që duhet të flë,
Një ditë tjetër përgjon pas xhamave,
Dritën e ngrohtë dhe buzët e tua,
I lë të m'i mbyllin, sërish qepallat...

Shtator 2023

AQ SHUMË!

Në korridoret e kujtesës kundërmojnë
Parfumi yt dhe dëshirat e mia,
Që bëjnë sikur u binden frerëve,
Tek flirtojnë me gjendjen statike të ajrit,
Elektrizimin e pashmangshëm të trupave...

Kujtesa, kujtesa luajn me ndjenjën
Dhe e kalon në nivelin e dytë lojën,
Duke zgjuar frymëmarrjen e rënduar,
Urinë e fshehur nën lëkurë...

Pré e saj, kam rënë tashmë,
Dhe ajo s'ka më nevojë,
Më lart se kaq ta ngrëjë lojën...
Më mungon shumë, aq shumë,
Sa s'dua t'i thërras më botës racionale...

Prill 2024

MË I BUKURI MOTIV

Kafetë vazhdojnë misionin e tyre
Të ngritjes së presionit të gjakut
Ndërsa ai hiqet zvarrë, padëshirë,
Dhomave të pagjuma të kujtesës...

Symbyllur rri në shtrat dhe mendon ty,
Ndërgjegjja dhe zëri yt i thonë të lëvizë
E të vazhdojë rrugëtimin,
Të bëjë punët e pabëra...

Po e mbledh veten dhe po ngrihem,
Kokrrat e grurit dhe maja e piramidës
Shohin nga unë dhe unë nga ty,
"Kur bashkë të jemi një ditë aty"...

Korrik 2024

ME ERËN E MALLIT

Mungesat e tua mbledh e zbrës heshtja,
Zemra me zero i shumëzën, përherë...
Erën e mallit tim po të nis, me të eja!
Botës nuk i duhet dhe një tjetër Saharë...

"Non grata" shpalli të tëra arsyet,
Që të vish tek unë s'të lënë!
Iluzionet mjerane janë muret,
Që ndarë kërkojnë t'na mbajnë...

I shtriva krahët sërish në pritje,
Me sytë mbyllur, shtrirë në përrallë,
Me erën e mallit, sillma një puthje,
Vesën e syve, lëshoma mbi ballë...

Gusht 2021

PËR TY DHE VETEN

Po arratisem, në një guvë vetmie,
Në kërkim të vetvetes,
Ti di si t'më gjeshe dhe tërë fjalëkalimet
Që çelin shtigjet...

Kur të vish, erë t'u marrësh
Tërë dashuri flokëve të mi,
Do të jetë vetëm aroma e tyre,
Asgjë e turmët, asgjë e mishmashtë...

Po iki, po shkoj tani,
Që të mund të të jap përsëri
Gruan që ti do dhe vetëm atë!
Jepmë pak kohë,
Nga vetja t'i zhvesh të tëra...

Korrik 2024

NGA DASHURIA

Ka çaste e orë që humb
Në vorbulla ndjesish të vogla,
Ushqim piranjash bëhem e pakuptuar,
Piranjash, që nga brenda-jashtë hanë...

Derisa vjen ti dhe më shkund
Me zërin tënd të butë,
Vështrimin që tret çdo zemratë
Dhe e zvogëlon botën, fëmijën e praptë...

Ti bën sikur s'e kupton
Nxitimin tim për të restauruar
Imazhin, pjesët e ngrëna të zemrës,
Një vetvete më të mirë të të vë në altar...

Qershor 2024



Analizë

MORALI HIPOKRIT

(Gi De Mopasan: "Topi me dhjamë")

Mimoza KOKA

Tregimin "Topi me dhjamë" Mopasani e botoi në vitin 1880. Ai u konsiderua një kryevepër dhe e bëri autorin tepër të njohur. U përfshi gjithashtu në një përmbledhje tregimesh të shkurtra me temë luftën franko-prusiane. Në të kishte shumë autorë të tjerë si Zola, Serard, Hisman, Henik, Aleksis, por kjo vepër e Mopasani u cilësua si më e mira. Në këtë tregim autori përshkruan gjendjen kaotike të Francës së pushtuar nga prusianët, duke stigmatizuar francezët e lavdishëm, që në këtë rast ishin mundur dhe e kishin humbur lavdinë e tyre. Ngjarjet zhvillohen në Ruan, qytet i pushtuar plotësisht prej prusianëve. Disa prej banorëve të rëndësishëm të Ruanit ishin të lidhur me interesa financiare me Havren, e cila ndodhej akoma në duart e francezëve. Këta morën një leje nga autoritetet e larta gjermane për t'u nisur në Havren. Karroca u nis herët në mëngjes. Në fund të karrocës ishin ulur zoti Luazo, një tregtar verërash, me të shoqen. Ai njihej si batakçi dhe mashtrues i lindur. E shoqja, shtatmadhe dhe e fuqishme, kishte një karakter të fortë, dhe i merrte vendimet aty për aty. Pranë tyre ishte ulur zoti Kare-Lamadon, me një pamje më hijerëndë, sepse ishte i një kaste më të lartë. Ai ishte pronari më i madh në industrinë e pambukut dhe oficer i Legjionit të Nderit. E shoqja ishte shumë më e re, e imët, plot gaz dhe e mbështjellë me një peliçe të shtrenjtë. Në krah të tyre qëndronte konti dhe kontesha Yber de Brevil, ndër emrat më të vjetër dhe me të fisëm të Normandisë. Këta gjashtë persona formonin elitën e karrocës, pra ishin të pasur dhe kishin status social, pra, për rrjedhojë siç thotë Mopasani kishin besë, fe, moral dhe parime. Në krah të kontesha ndodheshin dy murgesha të heshtura dhe përballë tyre një burrë dhe një grua që tërhiqnin vëmendjen e të gjithëve. Burri, tepër i njohur, i quajtur Kornye ishte i vetmi prej tyre që kishte luftuar me prusianët. Ai po nisej për në Havren, sepse mendonte se tani duhej të luftonte atje. Personazhi i fundit në karrocë ishte një grua, e cila sipas moralit hijerëndë të qytetit konsiderohej e "përdalë". Ajo ishte e bukur, me një ngjallje të parakohshme. E vogël, e mbushur, e mbuluar nga dhjami, me një lëkurë të ndritshme dhe tejet të tendosur dhe me dy sy të ndritshëm e të mrekullueshëm. Për arsye të formave të saj të kolme, në qytet njihej me nofkën "Topi me dhjamë". Sapo gratë e ndershme e njohën, me një solidaritet të shpejtë u afruan tek njëra - tjetra që të mbroheshin nga e përdala, dhe pëshpëritën fjalët "prostitutë" dhe "turp publik". Pëshpërimat e tyre ndalën sapo gruaja e re u hodhi një vështrim tejet të guximshëm. Pas një rruge të gjatë, nga pasditja të gjithë filluan të ndjenin uri. Asnjë nga gratë e ndershme dhe të kultivuara nuk ishte kujtuar të merrte ushqim me vete. Luazoi, njeri tepër koprrac, tha se do të paguante 1000 franga për një copë proshutë. Ndërkohë gruaja e "përdalë", ose "topi me dhjamë", nxori që poshtë stolit të saj një shportë të madhe me ushqime nga më të mirat. Luazoi tha: "Ja kështu duhet, zonja u tregua me e kujdesshme se ne". Ndërkohe gruaja e re u drejtua atij dhe e pyeti nëse dëshironte diçka për të ngrënë. Luazoi pranoi menjëherë, pas tij pranuan murgeshat dhe pas



pak të gjithë iu vërsulën ushqimeve që kishte përgatitur gruaja e "përdalë". Shporta u boshatis menjëherë. Por, nuk mund të hanin ushqimet e saj, pa i folur dhe kështu filluan bisedën disi të përmbajtur. Zonjat e nderuara tregonin një mirësjellje mjaft të rafinuar ndaj saj, për të treguar se ato nuk ndoteshin nga kontakti me të. Në këtë bisedë ata mësuuan se gruaja i urrente shumë prusianët, dhe kjo gjë bëri që ajo të rritej në sytë e tyre. Biseda vazhdoi dhe ca, por pak më e ftohtë pasi shporta ishte boshatisur. Më në fund karroca mbërriti në Havren, por, papritur udhëtarët panë se dhe ky qytet ishte i pushtuar nga gjermanët. Atje i prit një oficer gjerman, i hollë, flokëverdhe dhe arrogant si të gjithë njerëzit e pushtetshëm. Pasi i paraqitën lejen, udhëtarët u nisën për në hotel për të porositur darkën. Sapo ishin ulur në tryezë, ia behu i zoti i hotelit. Ai pyeti: "Kush është zonja Elizabet Ruse?" Gruaja e re u drodh, dhe u përgjigj: "Unë jam!" I zoti i hotelit tha: "Zonjushë oficeri prusian dëshiron të flasë menjëherë me ju". Ajo u nis për tek oficeri gjerman, dhe pas pak minutash u kthye duke ulëritur: "I poshtri, i poshtri!" Megjithëse njerëzit e nderuar të karrocës i kërkuar të shpjegohej, ajo iu përgjigj: "Kjo nuk ka të bëjë me ju, nuk mund të flas". Të nesërmen në mëngjes të gjithë ishin bërë gati të vazhdonin udhëtimin, por me urdhër të komandantit gjerman karrocën e ndaluan të nisej. Konti, fabrikanti dhe Luazoi e pyetën komandantin gjerman se pse e ndalonte nisjen e karrocës, por oficeri gjerman ishte i prerë lidhur me këtë. Askush nuk

e kuptonte këtë trill të tij. E tërë dita që e trishtueshme, të gjithë qëndruan në kuzhinë duke hamendësuar shkaqe nga më të çuditshmet. Pasdite erdhi i dërguari i oficerit gjerman dhe pyeti nëse zonja Elizabet Ruse kishte ndërruar mendim. "Topi me dhjamë" u skuq u bë flakë, pastaj u zverdh dhe më në fund shpërtheu: "I thoni asaj kërme prusiane se unë nuk do të pranoj kurrë, kurrë!" I dërguari iku, dhe të gjithë e rrethuan gruan dhe e pyetën sesi ishte puna. Në fillim ajo rezistoi, pastaj u dorëzua, duke u treguar: "Ai kërkoi të flerë me mua". Të gjithë u zemëruan dhe u revoltuan. Konti ishte shume i fyer, gratë po i shprehnin një solidaritet të përbashkët. Kornyeja shpërtheu duke thënë se sjellja e komandantit gjerman nuk ishte sjellja e një ushtaraku. Megjithatë, me kalimin e kohës vrulli i parë i zemërimit kaloi. Mëngjesi ishte i trishtuar, komandanti gjerman nuk tërhiqej nga kushti i tij. Kështu, po vërehej një largim, një ftohje ndaj gruas; ajo po shihej si shkak që ata nuk po niseshin. Dalëngadalë ftohja po kthehej në mëri, të gjithë mendonin të njëjtën gjë: "Pse kjo vajzë nuk ishte takuar në fshehtësi me oficerin gjerman dhe t'u bënte një të papritur të këndshme të gjithëve?" Tani mëria po kthehej në tërbim, gratë ecnin përpara dhe burrat pas tyre duke diskutuar. Luazoi pyeti se pse kjo grua e "përdalë" i detyronte të qëndronin në atë vend të tmerrshëm? Po kështu natyra harbute e zonjës Luaze shpërtheu: "Nuk kemi ndërmend të plakemi këtu; ajo delenxheshë e ka zanat të shkojë me të gjithë burrat, ç'do të ndodhë nëse do

të shkojë dhe me një tjetër?" Njerëzit u mblodhën për të gjetur një zgjidhje, vetëm Kornyeja rrinte mënjanë. Sapo u ulën në tavolinë filloi mësymja ndaj gruas, duke e poshtëruar; nderimi që ajo kishte fituar, tashmë kishte avulluar. U vendos që konti duhej të bënte një bisedë me të. Ai e tërhoqi mënjanë duke i folur me ton prindëror, pak përçmues, ton me të cilin burrat e rëndë dhe të nderuar u flasin vajzave publike, duke e trajtuar nga lartësia e pozitës së tij shoqërore. Konti e pyeti: "Pra, ju doni të na lini këtu, nën kërcënimin e ushtrisë prusiane?" Pastaj, ai i foli për mirënjohjen e tyre dhe shkruarjen e saj me komandantin gjerman gati po e quante një gjest patriotik, sepse gjermani asnjëherë nuk kishte dëshiruar një vajzë kaq të bukur në vëndin e tij. Ajo pranoi dhe u nis për tek godina ku ndodhej komandanti gjerman. Gjatë pasdites grupi i nderuar po pinte dhe bënte shaka të ndyra në kurriz të gruas së "përdalë". Vetëm Kornyeja qëndronte mënjanë, dhe më në fund ju drejtua grupit: "A e dini se po bëni një poshtërsi!" Fjalët e tij u shoqëruan me të qeshura. Më në fund leja u dha, karroca do të nisej, pritej vetëm të vinte gruaja. Ajo erdhi, por dukej e turbulluar, ecte si me turp dhe me druajtje për tek udhëtarët. Kur u afrua të gjithë i kthyen kurrizin. Konti hijerëndë kapi për krahu gruan dhe e largoi prej saj, si nga një kontakt i papastër. Të gjithë bënë sikur nuk e kishin parë, sikur nuk e njihnin; ndërkohë gruaja e Luazoi i tha të shoqit se sa me fat ishte që nuk ishte ulur pranë saj. Të tërë bisedonin, vetëm Kornyeja rrinte i heshtur. Pas pak ata ndjenë uri dhe hapën shportat me ushqime të shijshme që kishin marrë. Gruaja e re nga nxitimi dhe hutimi nuk kishte marrë asgjë. Asnjë nga ata nuk i ofroi diçka për të ngrënë, megjithëse ajo i kishte ushqyer të gjithë gjatë udhëtimit. Ajo tani vështronte e tërbuar dhe ziente nga inati. Një zemërim i papërmbytur e pushtoi, i mbërtheu grykën dhe po e mbyste. Askush nuk po kujtohej për të. Gruaja bëri përpjekje të pashoqe që të përmbante lotët, por ishte e pamundur: dy lot të mëdhenj u shkëputen nga sytë dhe qerpikët e saj të gjatë dhe u pasuan nga lot të tjerë që shkëputeshin me shpejtësi, tamam si pikat e ujit kur kullojnë nga një shkëmb. Zonja Luazo me një buzëqeshje ngazëllimi tha: "Ajo po qan për turpin e bërë!" Ndërkohë, Kornyeja nisi të vërshëllente "Marsejezen". Të gjithë u nxinë; kjo këngë e popullit nuk po u pëlqente aspak, ata ishin gati të ulërinin tamam si qentë kur dëgjojnë një organo në rrugë. Por Kornyeja vazhdonte të vërshëllente: At dhe i shenjt, at dhe i dashur/Hakmarjen ton' na e drejto/ Liri, Liri, në luftë përflakur/ Me mbrojtësit e tu përkrah lufto. Kështu vazhdoi ky udhëtim deri në fund, me vargjet e Marsejezës dhe me lotët e "Topit me dhjamë", që shoqëroheshin herë pas here me ndonjë ngashërim... E solla në vëmendje këtë tregim, sepse në jetë, në jo pak raste kemi takuar njerëz të nderuar dhe me status social, pra me fe, besë, moral dhe parime, të cilët po "t'i gërvishësh" sadopak do të zbulosh tek ta vese jo të pakta. Ndërkohë, ndodh që tek njerëz të përjashtuar apo të dënuar nga shoqëria të gjes vlera që të habisin. Kufiri nuk është i qartë, ai edhe mund të zhvendoset, ashtu si tek "Topi me dhjamë".


Fjala e shkrimtarit

REALITETI DHE MITI, MITI DHE FJALA

Në jetën e përditshme ne e perceptojmë fjalën si hije të realitetit, si reflektim të tij. Më i drejtë do të qe pohimi i kundërt: realiteti është hije e fjalës. Filozofia, në thelb, është filologji e thellë, studim krijues i fjalës

Bruno SZULC

Thelbi i realitetit është kuptimi. Atë që nuk ka kuptim e quajmë të pavërtetë. Çdo fragment realiteti jeton falë asaj, që merr pjesë në njëfarë kuptimi universal. Në kozmogoninë e lashta kjo shprehej me sentencën se në fillim ishte fjala. E paemëruara për ne nuk ekziston. Të quash (emërzosh, pagëzosh) diçka, do të thotë ta përfshish këtë diçka në njëfarë kuptimi universal. Fjala e izoluar, mozaike - është produkt i vonë, rezultat i teknikës. Fjala zanafillore ka qenë një vagulli e turbullt providenciale, që rrotullohej qark kuptimit të dritës e shkëlqimit, ka qenë një tërësi e madhërishtme universale. Në kuptimin e rëndomtë të së tashmes, fjala është veçse fragment, rudiment i njëfarë mitologjie të lashtë integrale gjithëvëllimore. Prandaj ekziston në të gjakimi drejt vegjetimit, drejt përmbushjes gjer në plotësinë e kuptimit. Jeta e fjalës ka për natyrë të suspendojë, të tendoset për mijëra lidhje, si trupi i copëtuar i gjarprit të legjendës, copat e të cilit kërkojnë njëra-tjetrën në terr. Organizmi mijëra copash dhe integral i fjalës, rezultoi i shqyer në shprehje të veçanta, tinguj të ligjëratës së zakonshme dhe tashmë në këtë formë të re, e aftësuar për kërkesat praktike, kaloi te ne si organ i të kuptuarit të ndërsjellët. Jeta e fjalës, zhvillimet e saj kanë qenë zhvendosur në binarë të rinj, binarët e jetës praktike, të nënshtruara ndaj ligjësisë të reja. Por sapo kërkesa praktike në njëfarë mënyre i dobëson rregullat e saj të ngurta, sapo që fjala, e çliruar nga ky detyrim me pahir, gjendet ballas tëte-a-tët me veten e vet dhe kthen te ligjësitë e veta, lind një rrjedhë e kundërt, fjala gjakon drejt lidhjeve të lashta, drejt burimit stërgjyshor - eshkun e saj të kthimit te malli për atdheun e parë preletrar ne e quajmë poezi. Poezia është qarku i shkurtër i kuptimit ndërmjet fjalëve, regjenerimi i beftë i riteve primitive. Duke operuar me fjalën e zakonshme, ne harrojmë që këto janë fragmente historik të lashta e të përditshme, që mu si barbarët ne i ndërtojmë shtëpitë tona prej copëra skulpturash dhe prej buste hyjsh. Ndër idetë tona nuk gjen as edhe një pjesëzë të vockël, e cila të mos ketë rrjedhur prej mitologjisë - që të mos ketë qenë e transformuar, deformuar,



transfiguruar prej mitologjisë. elementët që shfrytëzon ajo për funksioni parësor i Frymës të është ndërtim, kanë qenë të shfrytëzuara të rrefejë përralla, të krijojë "histori". më përpara, ato rrjedhin prej Forca lëvizëse e shkencës njerëzore "historive" të stërharruara dhe të është njëmendësia, që në fund të kuptime të bëra fir, i kthen fjalës gjurmimit ajo rreh ta gjejë kuptimin vendin e saj, i kombinon ato në përfundimtar të botës. Dhe ajo e bashkëpërkim me kuptimet e kërkon këtë kuptim në ndërtimet e saj artificiale dhe ndër pyje. Por qëmotshme. Për poetin fjala, si të

thuash, ndërmerret, kujton kuptimin e së vërtetës burimore, lulon dhe me një spontanitet të vetvetishëm zhvillohet, sikundër ia diktojnë asaj ligjet e veta, sërishmi përfton tërësinë e vet. Prandaj çdo lloj poezie është mitologjizim, ajo gjakon në rikrijimin e mitit për mitin. Mitologjizimi i botës nuk është kryer. Ky proces veçse qe ndalur nga zhvillimi i shkencës, qe shmangur në një shtrat tjetër diku përbri, ku gjallon, pa qenë i vetëdijshëm për kuptimin e tij të vërtetë. Por edhe shkenca s'është tjetër gjë, pos ngrëhinë miti për mitin, sepse miti tashmë është i ndërkalur në elementët më parësorë dhe se përtej sinoreve të mitit ne, sikur të plasim, nuk dalim dot. Poezia mbërrin gjer te kuptimi me anë të parandjesisë profetike, deduktueshëm, në bazë të shkurtimeve të mëdha kurajoze dhe përfrimit. Shkenca gjakon po të njëjtën gjë në mënyrë induktive, metodologjikisht, duke përlllogaritur gjithë materialin e studimit. Për nga thelbi i çështjes, dhe njëra, dhe tjetra, synojnë drejt së njëjtës gjë. Shpirti njerëzor është i paepshëm në interpretacionin e jetës me ndihmën e miteve, në nxjerrjen e kuptimit të realitetit. Fjala e evidentuar për vetveten gjakon, graviton drejt kuptimit. Kuptimi është po ai element, i cili e tondon njerëzimin në procesin e realitetit. Ai është e dhëna absolute. Atë është e pamundur ta nxjerrësh prej të dhënash të tjera, e pamundur ta shpjegosh se pse diçka paraqitet me kuptim. Procesi i kuptimësimit të botës është i lidhur ngushtë me fjalën. Ligjërimi është organi metafizik i njeriut. Megjithëkëtë, në rrjedhën e kohës, fjala gangullizohet, ngrin, pushon së qeni përcjellëse e kuptimeve të reja. Pra, ajo ia kthen fjalës përcjellshmërinë falë qarqeve (cirkuiteve) të reja, të cilat lindin nga kombinimet e tyre. Simbolet matematike janë thelbi i zgjerimit të fjalëve drejt kufijve të rinj. Piktura (tabloja) është gjithaq reproduksion i fjalës primitive, e cila nuk ishte ende shenjë, por mit, histori, kuptim. Në jetën e përditshme ne e perceptojmë fjalën si hije të realitetit, si reflektim të tij. Më i drejtë do të qe pohimi i kundërt: realiteti është hije e fjalës. Filozofia, në thelb, është filologji e thellë, studim krijues i fjalës.

Reflekse

FRANZ KAFKA, NJË BRUMBULL SUI GENERIS

Njerëzit për Kafkën, njëlloj si dhe sendet, janë forma dhe jo substanca e kjo vihet re sidomos tek Metamorfoza, Fqinji, Ura etj



Dr. Iris HALILI

Thonë se me Kafkën, letërsia rresht se qeni roman me histori. Ai krijoi një univers më vete, me apo pa të në qendër, s'ka rëndësi. Qysh atëherë, edhe universi ynë punon ndryshe. Ai ishte hebre me origjinë, por kultura e tij mbetet ajo çeko - gjermane. Mbahet të jetë një ndër shkrimtarët më të mëdhenj të shekullit të XX-të. Njihet si përfaqësues i modernizmit, një ndër eksperimentalistët më të mëdhenj, përfaqësues i avant-garde-ës, profeti i të sotmes dhe i të ardhmes. Në mes gjithë "izmave", mbeti sui generis. Kuptohet që, si të gjithë gjenitë, edhe Kafka nuk lindi ex-nihilo. Rrënjët e tij të ndërthurura e të koklavitura, mund t'i gjejmë tek dy klasikët e mëdhenj rusë, Gogol' dhe Dostoevskij. Këtu le të kujtojmë studiuesin Maurice Blanchot (1907-2003), i cili përcajton Gogol'-in

si pikën mbështetëse "të levës" së Dostoevskij-t. Sipas kësaj lidhjeje zinxhir, eci modernizimi duke ardhur nga shekulli i XIX-të tek ai i XX-të. Në gjysmën e parë të shekullit, trekëndëshi mund të formohet sipas skemës: Kafka, Proust dhe Joyce. Ndoshta, është momenti të shënojmë se format më origjinale të shekullit XX-të, si dhe më tipiket për të, i gjejmë në katër dekadat e para. Këtu kemi, pothuaj të formësuar, gjithçka që do të vinte më pas.

Si ndër përfaqësuesit më të shquar të botës letrare të shekullit, Kafkën e kanë studiuar dhe s'e kanë kuptuar deri në fund, e kanë kuptuar dhe sërish janë befasuar. Atë e kanë cilësuar si strukturalist, nisur nga ideja e shpallur në veprën e tij sipas së cilës rëndësi nuk ka qenia, por relacioni, jo subjekti, por struktura. Njerëzit për Kafkën, njëlloj si dhe sendet, janë forma dhe jo

substanca e kjo vihet re sidomos tek Metamorfoza, Fqinji, Ura etj.

Kafka si religjionist

Njëkohësisht, është cilësuar si religjionist. Parimi kafkian është: nuk ka Zot, por duhet të ketë. Në disa fiction të tij, Kafka duket se ka qenë jo pak i lidhur me teorinë e Z. Freud-it. Kështu, tek pjesëzat: Qeni, Urithi gjigand, Strofka etj, vihet re, pak a shumë, një përpjekje mekanike për të bërë një formulë letrare, me tendencën e lidhjes së psikoanalizës me fenë. Kafka është etiketuar nga kritika edhe si ekspresionist. Kjo, ndoshta, sepse vepra e tij shfaqet si një shprehje e plotë e botës subjektive të shkrimtarit. Të krijohet përshtypja se shkrimtari imiton ëndrrat e këqija, në të cilat njeriu gjendet para situatave më absurde.

Pothuaj të gjithë studiuesit i bashkon

mendimi se Kafka është natyralist dhe mban të gjitha tiparet e këtij drejtimi. Vepra kafkiane mbron parimin darvinian, sipas të cilit tek njeriu, ana fiziologjike është më e rëndësishme se ndikimi social, tipar që e gjejmë të plotë tek natyralisti më i madh i të gjitha kohërave, Émil Zola. E gjitha kjo, e gjen veten brenda një arti, ku pasqyrohet bota e brendshme, intime dhe fiziologjike e njeriut. Tipik këtu paraqitet Shartimi. Të lexosh Kafkën dhe të mos e njohësh atë si paraekzistencialist, do të qe e pamundur. Kjo bindje rritet, po të kihet parasysh se shkrimtarin e madh mendohet ta ketë tërhequr vepra e paraekzistencialistit Kierkegaard. Shembull tipik, janë: Një relacion akademik, Ura, Porta e ligjit, Hiq dorë etj. Gjithsesi, akoma sot, studiuesit nuk kanë mundur të japin përfundimet e plota për modernistin - avant-garde-istin Kafka, sikurse

mbeten të pashpjegueshme deri në fund analizat për Proust-in dhe Joyce-in. Duke marrë shkas nga terminologjia e semiologut të madh Roland Barthes (1915-1980), kujtojmë se pikërisht, me këta modernistë të mëdhenj lind letërsia "e shkrueshme", që i zë vendin traditës së letërsisë "të lexueshme". Zbërthimi i kësaj teze, do të thotë se letërsia që kemi në dorë është një letërsi, e cila jo gjithmonë kuptohet njësoj nga receptues të ndryshëm. Pikërisht, për këtë ajo quhet "e shkrueshme". Rrjedhimisht, kjo të çon tek ideja e tekstit të hapur, ku receptuesi vihet në rolin e rikrijuesit.

Një krahasim midis Metamorfozës dhe një relacion akademik

Metamorfoza e F. Kafkës u botua, për herë të parë shqip në revistën Bota Letrare. Receptuesit shqiptarë kur e lexuan, u habitën e nuk kuptuan asgjë nga kjo letërsi. Ata shkuan më tej: menduan se përkthimi ishte i dobët. Tentuan të injoronin vlerat e shkrimtarit. Të gjithë i kishin sytë nga klasikja, në fund të fundit, letërsi e mirë është ajo që njihet dhe kapërdihet nga shumica. Pse ndodhi kështu?! T'i përgjigjesh kësaj pyetjeje do të thotë t'i jesh përgjigjur një tjetre më parë: "Përse Kafka mbetet enigmatik për receptuesin hipotetik të të gjitha kohërave? Përgjigja, sidomos sot, është e thjeshtë. Kafka u shfaq dhe do të shfaqet për shumë kohë e breza, si shkrimtar avant-garde. I tillë, u paraqit që me botimet e para, i tillë vazhdoi të mbetej edhe më vonë, kur studiuesit filluan ta qëmtonin seriozisht veprën e tij. Ndoshta, Kafka e kishte parandjerë një gjë të tillë, ndaj dhe i që lutur mikut të tij Max Brod-i, t'i digjte veprën. Por Brod-i e tradhtoi dhe bota kështu fitoi një gjeni dhe një letërsi më shumë. Jo gjithmonë tradhtitë vijnë për të na bërë keq. Me sa duket paska edhe tradhti që na shërbekan. Receptuesi shqiptar, i sapodalë nga një traditë censure, do ta kishte të vështirë të përshtatej. Në studimet receptive kjo duket se ka një vend të veçantë, pasi në mënyrë "biologjike" lidhet me pritjen që i bën publiku një veprë. Kuptohet që pritja ka lidhje me një shije të caktuar, që gjithsesi, publiku e ka. "Biologjikisht" publiku është thirrur të gjykojë veprën, sipas përshtatjes me këtë shije. Duke hequr paralele, le të kujtojmë se, kur Kafka iu prezantua publikut evropian, ai ishte përshtatur me shijen e klasikëve të mëdhenj si: Tolstoj, Balzac, Dickens, por edhe me Gogol'-in dhe Dostoevskij-n. Kafka sigurisht, kishte shkelur normat, kishte shpërfillur pritjen e publikut, kishte injoruar tregun, domethënë, kishte shmangur plotësisht, horizontin e pritjes, duke na ofruar një letërsi kryevepër dhe largpamëse. Paralelja me receptuesin shqiptar të 1991-shit dhe atë hipotetik, le të themi, të 1926-ës, është afërsisht e pranueshme. Kjo pasi edhe censura komuniste kishte lejuar tregun e romaneve klasike, gjë që kishte sjellë kultivimin dhe, rrjedhimisht, përshtatjen me një shije pak a shumë të përcaktuar. Por të mos harrojmë se pak më parë thamë që paralelen mund ta heqim vetëm për afërsisht dhe kjo pasi lexuesi hipotetik i '26-ës vërtet u habit nga Kafka, por ai ishte i përshtatur me këto habi, po të kujtojmë se ai njihet Baudelair-in dhe, bashkë me të gjithë, simbolizmin e famshëm të shekullit të shkuar, si dhe jetonte në një kohë të çuditshme,



domethënë në një kohë kur shumë drejtime letrare skandalizonin publikun. Ndërsa lexuesi shqiptar, megjithëse jetonte në 1991-shin, nuk i njihje këto rryma që dehnin turmat me modernizëm. Fatkeqësisht, ai nuk njihje as klasikët e përmasave të Dostoevskij-t etj. Kjo na çon në mendimin se edhe kultivimi i shijes letrare të receptuesve shqiptarë, lë shumë më tepër për të dëshiruar, se ai i lexuesit hipotetik të '26-ës në Evropë. Rrjedhimisht, horizonti i zymtë i pritjes së lexuesit të 1991-shit në Shqipëri, do të qe më i ngushtë se sa i lexuesit të hamendësuar të 1926-ës në Evropë. Mund ta heqim këtë paralele të thjeshtë, në të dyja rastet është mëse e kuptueshme. Kafka mbetet i vështirë në receptim, i pakapshëm në përfundime dhe paraprijës në pritje, cilado qoftë koha dhe receptuesi i çfarëdoshëm që njihet me të. A do ta kemi këtë fenomen më 2026?! Le të guxojmë të sygjerojmë se ndoshta po. Sipas gjasave të deritanishme, mund të themi se Kafka rri e pret aty, në vendin e vet, i qetë si asnjëherë në jetë.

Metamorfoza dhe metamorfozat

"Kur një mëngjes Gregor Zamza u zgjua pas ëndrrash të trazuar, vuri re se në krevat qe shndërruar në një kandërr të përbindshme". Kështu fillon Metamorfoza, një ndër kryeveprat e letërsisë së shekullit të XX-të. Protagonisti është kthyer në kandërr. Çdo receptues e kupton se ai nuk ka më pamje njerëzore.

Përqipemi t'i vendosim një emër të përafërt kafshë, por ndiejmë neveri se e dimë që s'është kafshë e bukur. Kjo mund të të çojë tek ideja se autori na ofron një tekst të mbyllur, ku, rrjedhimisht, ne si receptues, vihemi në pozicionin e një bashkëpunëtori. Qenia e pështrirë ngacmon trurin e receptuesit, pasi autori, megjithëse s'e përcakton përfundimisht ç'lloj qenieje është, shënjon hollësisht të mjaftueshme të na bindë për tiparet e saj të çuditshme. Ne njohim, rresht pas rreshti, reagimet dhe arsyetimet e saj, rresht pas rreshti ne bindemi se brenda qenies është njeriu. Hap pas hapi, shikojmë se, më shumë se Gregori - qenie, të tjerët kanë filluar të pësojnë shndërrime. Dhe ata, fatkeqësisht, janë pjesëtarët e familjes. Ata në fillim e trajtojnë si një kafshë shtëpie, që ekziston, ndërsa më vonë e braktisin. E konsiderojnë si kafshë vrimash, që sjell papastërti, pisllek. Dhomën ku jeton, e kthejnë në kosh plehrash, ndërsa ushqimin fillojnë t'ia pakësojnë. Rresht pas rreshti, receptuesi shikon si çnatyrohen me rradhë: motra, babai, nëna e Gregorit. Mëshira e fillimit kthehet përfundimisht në bezdi. Ndërkohë, receptuesi, kupton qartë se metamorfoza e shëmtuar fizike e Gregorit, ka shërbyer për të formësuar metamorfozat e tmerrshme të familjes së tij prej gjaku. Përpëlitemi me dhembje se ata janë më të shëmtuar se vetë Zamza. Sipas një niveli të parë leximi, përfundimet mund të jenë sa filozofike, aq edhe moralizuese. Duket sikur filozofia kafkiane, kërkon të prekë gjenetikën

e marrëdhënieve njerëzore. Ai e sheh njeriun si një qenie të ndërruar interesash. E sheh si një ekzistencë që s'mund të jetojë pa pjesëmarrjen aktive të frymëve të tjera njerëzore. Ndryshe, ai do të jetë një kafshë apo një vegjetim i pashpresë. Mes një pesimizmi karakteristik, Kafka e mbyll tekstin me një formë optimiste të vetvetishme. Kjo të çon tek ideja se, nëpërmjet një konstatimi pesimist për ekzistencën, ai të ofron rrugët e lumtura të një ekzistence optimiste. Këtë e gjen tek marrëdhëniet reciproke e të pashmangshme midis qenieve njerëzore. "Dhe si për të përforcuar ëndrrat e tyre të reja dhe synimet e tyre të mira, në fund të udhëtimit e bija u ngrit e para duke shtrirë trupin e sa të ri". Motra, dhe pjesëtarët e tjerë të familjes, rijetojnë jetën edhe pas vdekjes së Grigorit. Të tre së bashku, ata shpësojnë. Sipas këtij niveli të parë të leximit, ne rendim drejt idesë, se të gjitha marrëdhëniet njerëzore, janë marrëdhënie interesash. Kjo nuk duhet kuptuar vetëm me ngjyrimet negative, por me të gjitha emocionet që mbart si fjalë. Tjetri vlen për mua, për aq kohë sa më shërben mua. Kjo do të thotë se unë dua praninë e një njeriu, për aq kohë sa ai më jep mundësinë ta dua si djalë, vëlla, partner, vartës etj. Pikërisht në momentin që ai nuk i shërben shpirtit tim, punës time, domethënë, interesave të mia, ai pushon së ekzistuari. Duke dashur ta lexojmë ndryshe Metamorfozën, le t'i rikthehemi paksa kritikës marksiste. Përse ajo e censuroi Kafkën edhe këtë libër? Sipas një interpretimi tjetër, kjo vepër mund të karakterizohet si deformimi i personalitetit njerëzor në kapitalizëm, pasi kemi kthimin e njeriut në kafshë dhe jetën e tij si mjet fitimi. Druajmë se vetë kritika marksiste e kuptonte se, edhe nëse një nivel leximi do të na shpinte tek kjo ide, disa nivele të tjera, shumë shpejt, do ta përmbysin këtë arsyetim dhe do të shpinin ujë atje ku marksizmi s'do të kishte dashur. Së pari, vepra nuk jep shpjegime në ç'rend shoqëror jemi. Aq më tepër aludimet që bën Kafka për problemet e lirisë, do t'i bënte teoricienët marksistë të ndjeheshin ngushtë, pasi teza e tij për lirinë e njeriut (me fitoren e komunizmit), përjashtohet nga koncepti që ka Kafka, i cili lirinë e sheh si mallkim gjenetik i racës njerëzore. Një tjetër argument, që do t'i frenonte marksistët, do të ishte fakti se Kafka nuk jep qoftë edhe një shënues të vetëm, që të na bind se Gregorin e ktheu në kandërr një arsye e jashtme, që do të ishte më e pranueshme për marksistët. Na çudit fakti se më rehat se kudo, kritikët marksistë ndiheshin kur e kritikonin dhe shtrembëronin veprën e gjenit. Por më mirë le t'i lëmë ata në mllefet e tyre, dhe të kthehemi tek letërsia e madhe, tek Kafka.

NUMRI I ARDHSHËM MË 15 GUSHT

HEJZA

1 Gusht, 2024

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**

Faqosjen dhe dizajnin:
Drian Shala - Shala & Rexhepi

Rruga e Kaçanikut nr.208, Shkup, 1000